Rruga e Arbërit

SKËNDERBEUT - 2018 - VITI MBARËKOMBËTAR I GJERGJ KASTRIOTIT

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 7 / 2018. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

Profil

Dali Horeshka, miku i madh i fermerëve të Dibrës

Nga **OSMAN XHILI**


12

in memoriam

Studiuesi Moisi Murra, një mik i vyer dhe i paharruar


14

Kulturë

Një jetë në skenë me trofe e tituj të lartë

Nga **ESAT RUKA**


16

KONCENSIONI NË PYJET E BULQIZËS

Një histori dyshimi për korrupsion dhe abuzime

Nga **HYSEN LIKDISHA** - FAQE 4,5



NË BRENDËSI:

- Kryeministri njofton pa bujë nisjen e punimeve në Tunelin e Murrizit
- Bashkitë e qarkut të Dibrës, jo transparente në publikimin e vendimeve të Këshillit Bashkiak
- Llixhat, një thesar apo një pengesë për bashkinë e Dibrës?
- Discover Albania: Korabin e ngjisim më 11-12 gusht
- "Zëri i qytetarëve të Bulqizës"
- Ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizmi fetar tek të rinjtë
- Shkolla pedagogjike Peshkopi, një nga shkollat më të mira të Republikës
- Pse të gjithë kërkojnë aronian e Dibrës?
- Michele Mëziu, muhrraku në origjinë, talenti në shkëlqim
- KALENDAR HISTORIK shek. V p.e.s. - qershor 2009
- Batalioni partizan i Dibrës
- Gjurmë lashtësie në Çidhën
- Një libër për alienët, nga Arian Kadiu
- Hijet e tërbuara, cikël poetik nga Nuri Koleci
- Miti i vendlindjes dhe braktisja e dhimbshme
- Ndahet nga jeta intelektuali dibran Jashar Dema
- Luan Hajdaraga, qeveritari i vetëm nga trojet etnike

STUDIMI

HEC-et që po "minojnë" zonat e mbrojtura

Të 26 HEC-et tashmë në operim në zonat e mbrojtura dhe 123 HEC-et tjera që janë në ndërtim dhe të planifikuara kanë dëmtuar rëndë trashëgiminë natyrore. Një grup ekspertësh prej 20 vetash të atashuar nga PNUD inspektoi 71 HEC-et e vogla tashmë në punë dhe gjeti një "mal" me probleme. Kompanitë nuk kanë respektuar asnjë standard mjedisor, teksa autoritet kanë shkelur në mënyrë flagrante ligjet në fuqi dhe konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit. Në pellgun e lumit Drin, situata është më e rëndë në Parkun Natyror Korab-Koritnik, ku 12 HEC-e janë në operim dhe 6 të tjera janë planifikuar. Në Parkun Kombëtar Rrajcë-Shebenik 1 HEC është operativ, 3 janë në ndërtim dhe 28 të tjera janë planifikuar të ndërtohen.

Lexoni në faqet 6-7

PUSHIME MALORE
Ja disa shtëpi pritëse

Rekomandime për guidat dhe shtëpitë ku mund të shijoni natyrën dhe mikpritjen dibrane



Në foto: Liqeni i Dibrës së Madhe. Foto: FB/Ketumblidhendibranet

Faqe 2-3

BËJ NJË ABONIM ONLINE OSE NË PRINT.
Kushton vetëm 600 lekë në vit.
email: rrugaearberit@gmail.com

cyan magenta yelloë black 1

Gazeta “Rruga e Arbërit” është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 7 (147). Korrik 2018
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit qershor

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Korrespondentë të përhershëm:
Abdurahim ASHIKU
Osman XHILI
Alban TUFA
Hysen LIKDISHA / BIRN
Samet ZAGRADI
Defrim METHASANI
Grehans UKA
Arsim KOLARI

Kontribuan për këtë numër:
Viron KONA
Esat RUKA
Nuri KOLECI
Bashkim LLESHI
Demir OSMANI
Besnik ALKU
Sami CURRI
Selman MËZIU
Gjon FIERZA
Ali HOXHA
Blerina HOXHA
Besnik LAMI
Zabit LLESHI
Xhevat JELLA

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Llixhat, një thesar apo një pengesë për bashkinë e Dibrës?



Llixhat janë një nga burimet natyrore më të begata që ka ne territorin e Dibrës dhe të shfrytëzuara për vetitë kurative. Aktiviteti kurativ në ujërat termale të qytetit të Peshkopisë ka filluar që në vitet 1600, kur janë përdorur nga banorët e Peshkopisë dhe më gjerë në mënyrë të vazhdueshme për efektet kurative. Gojëdhënat janë transmetuar brez pas brezi për efektin e tyre kurativ, derisa rreth viteve 1870 filluan të përdoren dhe të mirëmbahen nga komuniteti i teqesë së Peshkopisë. Njerëz me dijeni në mjekimet popullore, i kanë rekomanduar për shërim të disa sëmundjeve. Rreth vitit 1928, u ndërtua i pari hauz me mbulesë, që filloi të përdoret me pagesë nga bashkia e qytetit. Në vitin 1953 fillon shfrytëzimi shkencor i tyre dhe ndërtohet i pari mjedis për larje me vaska, si dhe hoteli pranë tyre për të shtruarit. Ndërkohë që kompleksi me vaska dhe kabinete të terapive të veçanta u ndërtua në vitin 1989.

Rrugës për në Rabdisht, Bellovë nga Peshkopia shtrihet lugina e përroit, që quhet edhe “Lugina e Shërimit”. Në këtë zonë është kompleksi balnearë i Llixhave, që menaxhon burimin ujor termalë, i njohur për vetitë kurative të tij, ka një temperaturë rreth 40ºC, me një përmbajtje kripërash dhe gazrash të tretura në to. Aty ofrohen të gjitha shërbimet e nevojshme, duke filluar nga pishina, vaska, masazhi, balta dhe shërbimi mjekësor. Cilësia e ujit të llixhave të Peshkopisë është nga më të mirat në Evropë.

Sot, burimet termale të Llixhave të Peshkopisë shfrytëzohen me kapacitet të plotë. Në këto llixha pushojnë rreth 16,000 pushues në vit, të cilët vijnë nga të gjitha trevat e Shqipërisë, Kosova dhe Maqedonia. Turizmi kurativ është sezonal dhe frekuentohet kryesisht në vjeshtë periudha (shtator-nëntor) dhe në periudhën e pranverës, në sezonin (mars-qershor). Shumë biznese, hotele dhe shtëpi pritëse janë ndërtuar në lagjen e Llixhave që u shërbejnë pushuesve me paketë të plotë që nga akomodimi, ushqimi dhe deri tek terapia e banjës.

Llixhat janë thesari për Dibrën, por në të vërtetë kjo ka qenë vetëm thesar për pak njerëz që i menaxhojnë ato. Drejtori i ri i ndërmarrjes së Llixhave flet për një situatë jo të mira ekonomike të kësaj ndërmarrje të trashëguar nga paraardhësit. Një ndërmarrje me borxhe, me staf të fryrë, pa investime në kompleksin balnearë, me amortizim të pajisjeve dhe me një mjedis që çdo ditë po kërcënohet nga ndërtimet pa leje dhe nga shumë konflikte pronësie mbi truallin.

> Në kuadër të projektit të mbështetur nga programi PACT - Partnerë Kundër Korrupsionit, dhe të zbatuar nga shoqata Grupi Veprimit Lokal “Dibra Turistike”, është diskutuar me stafin e ndërrmarrjes, janë organizuar tryeza të rrumbullakta me biznesin dhe anëtarët e këshillit, si dhe me stafin e bashkisë. Nga ky proces, drejtori i Llixhave ka hartuar një raport financiarë për këshillin bashkiak, është bërë një interpelancë në këshill, është vendosur në funksion kasa fiskale, dhe është përcaktuar një praktikë raportimi në Bashkinë Dibër.

Në bashkia nuk arkëtohen të ardhura të mjaftueshme nga Llixhat, dhe ka një presion si nga organet e kontrollit për shkak se akoma nuk ka një definicion të qartë të profilit të kësaj ndërmarrje, dhe nga presioni menaxhimit apo administrimit të ndërmarrjes si nga politika dhe nga privati që kërkon ti privatizojë ato. Kështu që edhe drejtuesit e Bashkisë janë në një dilemë se çfarë zgjidhje të japin për këtë ndërmarrje. Ta privatizojnë, janë interesa dhe kërkon një procedurë të ndërlikuar për ta bërë një gjë të tillë dhe opinioni publik është kundër një veprimi të tillë. Nëse do e mbajnë kështu siç është, ka shumë fjalë dhe abuzim me të ardhurat që arkëtohen nga kjo ndërmarrje.

Gjatë kësaj periudhe, falë edhe presionit dhe avokimit të opinionit publik, te shoqërisë civile, biznesit në zonën e Llixhave dhe dëshirës së drejtorit të ri për të qenë më transparent, gjërat kanë filluar të lëvizin për më mirë. Kështu në kuadër të projektit të mbështetur nga programi PACT (Partnerë Kundër Korrupsionit) dhe të zbatuar nga shoqata Grupi Veprimit Lokal “Dibra Turistike”, është diskutuar me stafin e ndërrmarrjes, janë organizuar tryeza të rrumbullakta me biznesin dhe anëtarët e këshillit, si dhe me stafin e bashkisë. Nga ky proces, sot drejtori i Llixhave ka hartuar një raport financiarë për këshillin bashkiak, është bërë një interpelancë në këshill, është vendosur në funksion kasa fiskale, dhe është përcaktuar një praktikë raportimi në Bashkinë Dibër.

A mjafton vetëm kaq që Llixhat të kthehen në thesar për Dibrën? Mendojmë se jo, por se si duhet të ndryshohet situata duhet të diskutohen me komunitetin dhe një plan rregullimi për lagjen Llixha, dhe një plan strategjik për menaxhimin e ndërmarrjes së Llixhave do të ishin hapat e parë që do përmirësonte menaxhimin e kësaj ndërmarrje.

PACT
Partnerë së Bashku Kundër Korrupsionit

BUJTINA STEBLEVA, NJË SHTËPI PRITËSE PLOT NGROHTËSI

Vendndodhja është në Steblevë, në parkun Kombëtar “Shebenik – Jabllanicë”. Ofron ecje në këmbë, male dhe lugina mahnitëse. Shumë i qetë dhe i izoluar. Ka mjaft kafshë të egra. Ajri i freskët dhe mikpritje e ngrohtë. Ushqimi i bërë me përbërës të rritur në vend. Ofrohet guidë për të vizituar zonën me një tarifë të vogël. Shtretër shumë të rehatshëm, kuzhinë plotësisht funksionale. Kjo bujtinë është e mirë për çifte, aventurierë, familje (me fëmijë), grupe të mëdha dhe kafshë shtëpiake. Ky vend është i adhurueshëm në çdo kohë, por sidomos në mbrëmje pas një ecje të gjatë, ku mund të ngroheni në zjarrin me dru dhe të qetësoheni mbi një filxhan çaji të rritur në vend ose pak verë. Mikpritja dhe nikoqirllëku ka lindur në këtë fshat historik, në kufi me Maqedoninë, i cili tani është pothuajse i braktisur nga banorët e tij, të cilët kryesisht e përdorin atë si bazë pushimi. Historia e fshatit pretendon vendin e lindjes për gjyshërit e Qemal Ataturkut, sundimtarit të Turqisë moderne. Ajo gjithashtu ka rrënojat e manastireve, kishave në mbi 1800 m lartësi nga shumë njerëz dhe ushtritë që e kaluan atë gjatë historisë së saj shumë të gjatë; turqit, bullgarët, maqedonasit dhe serbët. Fshatarët flasin shqip dhe gjuhën bullgare të vjetër dhe kanë jetuar gjithmonë në harmoni midis dy feve kryesore; të krishterëve ortodoksë dhe myslimanëve.
Tel: 00355 695168173



turizëm

Kryeministri njofton pa bujë nisjen e punimeve në Tunelin e Murrizit

Kryeministri Edi Rama, më 18 korrik, përmes një video prej 3 minutash publikuar në faqen e tij zyrtare në FB, ka informuar për vazhdimin e punimeve në Rrugën e Arbërit përgjatë lumit në Zall Bastar, si dhe nisjen e punimeve në Tunelin e Murrizit, më i madhi dhe më i rëndësishmi në këtë aks rrugor. Tuneli i Murrizt,

Sipas tirtrave të shfaqura në video, Tuneli i Murrizit ka avancuar 20 metra, ndërsa dy tunelet e tjerë në fshatin Fshat në Klos kanë avancuar përkatësisht 90 dhe 281 metra, duke informuar kështu se punimet e kompanisë po ecin me shpejtësi.

Tuneli i Murrizit do të jetë i gjatë 3246 metra. Do të jetë me dy turbina me distancë aksiale 255 metra, njëra prej të cilave do të shërbejë për rastet e emergjencës. Të dy tunelet do të ndërtohen me të njëjtët parametra teknikë: Gjerësia e tunelit të trafikut përbëhet nga dy korsitë e trafikut më gjerësi 3.5m secila, dy kuneta anësore 0.35m të gjëra secila, dy trotuare: 2x0.85m, që kanë pjerrësi tërthore 2% në drejtim të kunetave përkatëse, pjerrësia tërthore e korsive është -2.5%, ndërsa lartësia e lirë për trafikun është 5.00m. Përmasat gabarite brenda për brenda tunelit të trafikut janë: baza 10.1m dhe lartësia 6.8m. Gjithashtu, do të ketë edhe 6 galeri për kalime tërthore, 4 për kalimet e këmbësorëve dhe 2 kalime të emergjencës për makinat.



Discover Albania: Korabin e ngjisim më 11-12 gusht

Ngjitja në Malin e Korabit mbetet një nga sfidat më të dëshiruara dhe më të vështira gjatë verës. Ashtu si edhe vitin e kaluar, Klubi Discover Albania do të organizojë më 11 dhe 12 gusht ngjitjen në Malin e Korabit. Vendet janë të limituara, vetëm 20 pjesëmarrës, kështu që ata që duan të shijojnë këtë udhëtim me këtë grup, duhet të kontaktojnë me organizatorët.


Mali i Korabit, 2764 metra i lartë, ndodhet edhe maja më e lartë në Shqipëri dhe në Maqedoni, duke qënë se është mal kufi-ndarës. Gjithashtu, Korabi,që renditet i katërti në të gjithë Ballkanin pas Rila (Bullgari), Olimpit (Greqi) dhe Pirini (Bullgari), është ndër malet qëtë ofron pamje fantastike të natyrës me peizazhe përrallore.

Guida njofton se nisja nga Tirana bëhet në mëngjësin e 11 gushtit dhe përfshin edhe vizita të shkurtëra në Peshkopi dhe Radomirë dhe vizitë në Liqenin e Zi. **REZERVONI:** Duke derguar email ne info@discoveralbania.al ose SMS ne nr 0696583870 me Text: Rezervoj "3" vend per tek Mali i Korabit - dhe Emrat Tuaj. Ose telefononi ne nr 0696583870



Guidë dhe shtëpi pritëse
UKA
GREHANS UKA
+ 355 69 32 14 210
+ 355 69 24 88 801
Grehans Uka
udhetomegresin@gmail.com
fletaxxi@gmail.com
Adresa: Peshkopi/Dibër/Albania


Harta e plote e shtigjeve turistike ne Diber, krijuar nga praktikanti i pare ne TIC, Fabion Zerja i cili ne pak kohe realizoi historine e tij te suksesit.



PUSHIME MALORE
Disa shtëpi pritëse në Dibër



Kullë mbi 200-vjeçare.
Lepurak, Fushë-Bulqizë.
Cel 0688373793



VLADIMIR MARKU
Telefon : +355 68 65 06 061 Facebook: Vladimir Marku
Email: markuvladimir@yahoo.com



REST HOUSE KORABI është investimi më i bukur i bërë nga vëllezërit Elezi në fshatin Bahute. Një shtëpi me gur të gdhendur, me oborr të gjelbert, me pajisje prej druri, me impiant ngrohje, si në Evropë. Pasioni i Fluturim Elezit ju mahnit me shërbimin dhe guidën në ballkonin e Peshkopisë dhe në parajsën e bjeshkës së Gramës. Nëse doni të largoheni nga vapa, në Bahute vetëm 15 min larg Peshkopisë ju mirepret:
Vizitoni në Facebook:
Rest House Korabi dhe Fluturim Elezi



Rruga e Arbërit nr. 147

aktualitet

"Me gjak do ta mbrojmë, pyllin nuk e lshojmë", i tha një grua Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi, në një takim të zhvilluar më 21 korrik në Kodër Dane.

Koncensioni në pyjet e Bulqizës, një histori dyshimi për **korrupsion** dhe **abuzime**



Nga **Hysen LIKDISHA**

Prej gati 4 vitesh vijon "beteja" mes koncensionarit - pushtetit lokal dhe banorëve për shfrytëzimin e masivit pyjor, në vendin e quajtur "Sheshe Bulqizë", në Malin e Bardhë. Banorëve të katër fshatrave: Dushaj, Koçaj, Kokërdhak dhe Kodra e Danit, të njësisë administrative Fushë-Bulqizë, janë ngritur në protesta për të mbrojtur këtë masiv pyjor, i vetmi i mbetur në zonën e Bulqizës. Protestuesve u bashkohen edhe kampionët e Kik-Boksit, vëllezërit Ismail e Gjetan Keta.

"Me gjak do ta mbrojmë, pyllin nuk e lshojmë", i tha një grua Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi, në një takim të zhvilluar më 21 korrik në Kodër Dane, njërin nga katër fshatrat që protestojnë për më shumë se katër vite, kundër shfrytëzimit të pyjeve në malet mbi fshatrat e tyre. Dhe nuk mund të kishte më shumë sinqeritet dhe revoltë bashkë në një thirrje të tillë. Përfshirja e grave në protestë, angazhimi i tyre për mbrojtjen e pyjeve, duket se ishte një akt që e detyroi ministrin Klosi të merrte rrugën e vështirë, plot kthesa e gropa për në Bulqizë, për të premtuar vetë marrjen e hapave ligjorë për anullimin e koncensionit për shfrytëzimin e pyjeve.

Historia e koncesionit dhe dritë-hijet e tij

Historia e koncesionit fillon në vitin 2015 kur Ministria e Mjedisit dha leje për shfrytëzimin e parcelave pyjore pranë katër fshatrave në njësinë administrative Fushë-Bulqizë, të bashkisë Bulqizë. Ashtu si në mjaft koncesione të tjera që kanë të bëjnë me burimet natyrore të zonës, banorët kundërshtuan, duke akuzuar se nuk ishin pyetur dhe se koncensioni prekte burimet e tyre jetësore. Megjithatë, kompanitë koncesionare "Almex-Ëood" dhe 'Lubima' shpk, tentuan të fillonin punën për ndërtimin e rrugës auto-pyjore, që do tu mundësonte shfrytëzimin e parcelave. Banorët kundërshtuan me forcë duke u përplasur me kompaninë dhe policinë e cila shoqëroi disa prej tyre. Pas protestave të banorëve, Partia Demokratike, akuzoi se përfituesit e koncensionit kishin lidhje fisnore me funksionarë të lartë të LSI-së, e cila në atë kohë kontrollonte Ministrinë e Mjedisit, e cila lëshoi lejen vetëm pak kohë para se të hynte në fuqi moratoriumi për pyjet. Përkundër protestave të banorëve, kompanitë koncensionare "Almex-Ëood" dhe 'Lubima' shpk, ritentuan herë pas here për ndërtimin e rrugës auto-pyjore, që do tu mundësonte shfrytëzimin e parcelave. Në çdo tentativë të kompanisë për fillimin e punës, banorët kundërshtuan me forcë duke u përplasur me kompaninë dhe policinë e cila shoqëroi disa prej tyre në polici, për protesta të paligjshme dhe të dhunshme. Banorët e katër fshatrave nënshkruan një peticion të firmosur nga 450 kryefamiljarë, ku konfirmojnë se nuk janë dakord me shfrytëzimin e pyjeve, me pretendimin se një gjë e tillë sjell për ta dëme të mëdha mjedisore, me pasoja për fshatrat e tyre, si furnizimi me ujë të pijshëm e vaditës, lëndë drusore, bimë mjekësore etj., të cilin ja nisin Prefekturës së Qarkut të Dibrës. Prefektura me shkresën nr. 5271/1, datë 23.10.2015, urdhëron pezullimin e punimeve për hapjen e rrugës auto-pyjore. Vendim ky që sipas koncensionarëve është konsideruar në kundërshtim të hapur me ligjin. Ata kanë përcjellë pretendimet për dëmet e shkaktuara nga protestat, që kapin vlerën e 100 mijë eurove nga djegia e "Varinskit", pranë institucioneve shtetërore si, Prefektura Dibër, Bashkia Bulqizë dhe Komisariati Policisë Bulqizë, Drejtorinë e Policisë Dibër etj. Ndërkohë, sipas banorëve (kryesisht të atyre që u shoqëruan në mjediset e komisariatit të policisë, për protesta të paligjshme), ndërhyrjet e policisë konsiderohen si presion ndaj tyre dhe të dhunshme, në mbrojtje të kompanive që kanë marrë lejen për shfrytëzimin e pyllit.

PËRPLASJA E INSTITUCIONEVE: "PRO" DHE "KUNDRA" PROTESTAVE

Me nisjen e protestave nga banorët, nisi edhe pozicionimi i institucioneve shtetërore, pro dhe kundër tyre. Kështu, Policia dhe Bashkia janë bërë palë me kompaninë për zbatimin e kontratës, duke shpërfillur kështu hapur, ankesat dhe kërkesat e banorëve. Protestat kundër koncesionit të dhënë në vitin 2015 u rigjallëruan, kur kompanitë koncesionare "Almex-Ëood" dhe "Lubima sh.p.k" filluan të hapin një rrugë të dytë auto-malore, në krahun tjetër të malit, duke e shmangur kalimin e saj nga 4 fshatrat protestues. Rezistenca e banorëve dhe një vendim i prefekturës së Dibrës në fund të vitit 2015, bllokuan ndërtimin e rrugës që do të shërbente për shfrytëzimin e pyllit, duke djegur afatet e lejes që kompania kishte për ndërtimin e saj. Pas një pauze gati dy vjeçare, koncensionari këmbëngul përsëri, për hapjen e rrugës auto-pyjore, kësaj here me ndihmën e Bashkisë Bulqizë, e cila dërgon në këshillin bashkiak një projekt-vendim për të zgjatur lejen e ndërtimit të rrugës auto-pyjore. Por edhe në këtë përpjekje, kryebashkiaku Melaim Damzi i LSI-së dështoi, kur këshilli bashkiak i Bulqizës hodhi poshtë një kërkesë të tillë, pasi një gjë e tillë nuk ishte kompetencë e tij.

Këshilltarët e bashkisë akuzuan se kryebashkiaku tentoi hapur t'i përdorte ata, për të favorizuar koncensionarin me marrjen e vendimeve të paligjshme

Ndërkohë, vetëm pas më shumë se një muaj nga kjo përpjekje, kompania koncensionare filloi punimet për hapjen e kësaj rruge edhe pse nuk dispononte asnjë lloj leje

"Zëri i qytetarëve të Bulqizës"

Një lëvizje qytetare që nuk kishte ndodh njëherë tjetër në rajonin e Dibrës. Banorët e fshatrave të Fushë Bulqizës për dy vite rresht ishin ngritur dhe protestonin kundër koncesionit që kishte marrë në shfrytëzim pyllin e tyre. Të gjithw banorët, i madh dhe i vogël, burra dhe gra, fermerë dhe mësues, hallexhinj dhe njerëz të suksesshëm të këtyre fshatrave ishin të një mendje që nuk do lejonin që pylli i tyre të merrej nga koncesionari, siç është bërë me shumë burime të tjera natyrore të kësaj zone. Muaji i fundit ishte koha e një revolte dhe proteste jo vetëm në tre fshatrat por në Bulqizë, në qendër të qytetit dhe po të ishte nevoja edhe në qendër të Tiranës apo Brukselit.

Ju bashkuan kësaj proteste të ndershme dhe të drejtë të gjithë banorët e Bulqizës, dhe nga e gjithë Shqipëria. Aleatë të fortë të banorëve të Fushë Bulqizës në protestë u bënë media lokale, media sociale, shoqëria civile dhe grupimi "Zëri i Bulqizës" që ishin lajmësit e së vërtetës për protestën. Ju bashkuan protestës edhe figurat e shquara të kësaj treve vëllezërit kampion boksi në botë Keta që u bënë imazhi i qëndresës së kësaj proteste. Federata e Pyjeve dhe Kullotave të rajonit të Dibrës, nëpërmjet projektit "Zëri i qytetarëve të Bulqizës" sensibilizoi dhe advokoi në nivel lokal me shoqatat e tjera të pyjeve dhe aleancën "Zëri i Bulqizës", në nivel kombëtarë nëpërmjet Federatës Kombëtare të Pyjeve dhe Kullotave, dhe në nivel më të gjerë nëpërmjet programit PACT (Partnerë Kundër Korrupsionit) të financuar nga fondet e Delegacionit Europian në Shqipëri. Protesta pati një mbështetje të gjerë edhe nga media kombëtare, nga programi mediatik investigativ BIRN, dhe nga deputetet e Dibrës, ku më avokatia e çështjes në nivel politik-bërje ishte deputetja Almira Xhembulla. Në sajë të kësaj qëndrese dhe këtij mobilizimi të të gjithë aktorëve dhe shpirtit të protestës për të mbrojtur të drejtën e tyre, u arrit që të organizohet një takim bisedues në Kodër Dane, me Ministrin e Mjedisit dhe Turizmit z. Bledi Klosi, prefektin e Dibrës z. Nexhbedin Shehu dhe deputeten znj.Almira Xhembulla. Nga ky takim mes palëve qeveritare dhe banorëve të fshatrave të Fushë Bulqizës u arrit që nga Ministri të premtohet prishja e marrëveshjes me koncesionarin, dhe ndjekja e veprimeve procedurale nga institucionet përkatëse.

Kjo ishte fitorja e parë e një lëvizje komunitare qytetare, për të mbrojtur të drejtën e tyre, për të mbrojtur pasuritë e tyre. Ky ishte një shembull i mirë se si banorët i dalin zot të drejtës së tyre, u dalin zot pasurive të tyre që nëpërkëmben nga autoritet e korruptuara qeveritare.

Sot banorët e Fushë Bulqizës do të kenë pyllin e tyre për ta shfrytëzuar për turizëm. Ky ishte një shembull i mirë se si duhet të veprojnë qytetarët dhe banorët e tjerë të Bulqizës e Dibrës në mbrojtje të pasurive natyrore të tyre, jo vetëm të pyjeve por edhe të kromit, ujërave dhe pasurive të tjera natyrore.

Është koha që "Zëri i qytetarëve të Bulqizës" të ngrihet dhe të dëgjohet.

Përgatiti: **Mirdash Alku**

PACT
Partnerë së Bashku Kundër Korrupsionit

Banorët, me protestat e herë pas hershme, janë po kaq të vendosur në mbrojtje të masivit pyjor, pasi siç thonë ata, pylli mbi fshatrat e tyre është e mbetet i vetmi burim jetese për ta.



Sipas banorëve, Bashkia e Bulqizës është bërë palë në këtë skandal, duke mbajtur një qëndrim klientelist, nën justifikimin e zbatimit të koncensionit, për "pastrimit të pyllit".

për hapjen e saj. Dhe përsëri janë banorët që të vendosur për ruajtjen e pyllit, hidhen në protestën e radhës, duke bërë që punimet për hapjen e rrugës të dështojnë. Sipas banorëve, Bashkia e Bulqizës është bërë palë në këtë skandal, duke mbajtur një qëndrim klientelist, nën justifikimin e zbatimit të koncensionit, për "pastrimit të pyllit". Banorët gjatë protestave të tyre, akuzojnë kryebashkiakun Damzi, se ndihmon që të pritet edhe i vetmi pyll shekullorë dhe e vetmja kurorë e gjelbër e Bulqizës, që aktualisht ka mbetur e paprekur nga motosharra, pasi është ruajtur nga vetë banorët e këtyre fshatrave. Kompania është mbrojtur duke bërë me dije se kishte fituar një kontratë të ligjshme dhe se po kërkon zbatimin e saj, pavarësisht kundërshtimit të banorëve.

"Ne jemi konform të gjitha rregullave, kemi fituar një kontratë të ligjshme dhe po kërkojmë zbatimin e saj, pavarësisht kundërshtimit të banorëve, tha për "Rruga e Arbërit" Shkëlqim Keshi, përfaqësues i kompanisë Lubima shpk. "Ne jemi konform të gjitha rregullave, kemi disponuar shkresat në të gjitha institucionet, që janë të firmosura dhe vulosura nga ish komuna e Fushë-Bulqizës, ku është edhe firma e ish kryeplakut të fshatit Koçaj, Qemal Stafa.

Por nga ana tjetër, Qemal Stafa, e mohoi firmën e tij. I kontaktuar nga "Rruga e Arbërit", për këtë problem, ish kryeplaku i fshatit Koçaj, tha: "Denoncoj hapur se shkresa me nr. extra, prot. datë 16.02.2015 e "nënshkruar" nga unë, ish kryeplak i fshatit Koçaj, ku thuhet se komuniteti dhe Komuna, janë dakord për zbatimin e këtij projekti për shfrytëzimin e pyjeve nga koncensionari, është e falsifikuar, pasi në asnjë rast nuk është e firmosur nga unë. Për këtë i jam drejtuar me shkresë denoncimi më 25.10.2015, ish prokurorit të Prokurorisë së Përgjithshme, z. Adriatik Llalla".

Ndërkohë, edhe ish anëtarë të këshillit komunal në atë periudhë kohore pohojnë se në asnjë rast nga ky këshill, nuk është marrë vendim për dhënien me koncension të pyjeve "Sheshe Bulqizë"..

Donika Hyseni, sekretare e përgjithshme në Prefekturën e Dibrës, tha për gazetën se " kontrata duhet parë, për t'i dhënë zgjidhje problemit të kësaj përplasje, që ajo të mos agravojë më tej". "Në atë kohë, thotë zonja Hyseni, më ka ardhur në Prefekturë një peticion me 450 firma kryefamiljarësh nga këta fshatra, të cilët kundërshtojnë shfrytëzimin e masivit pyjor, pasi në asnjë rast ata nuk kanë firmosur për dakordësi në këtë drejtim. Di që banorët kanë denoncuar për këtë problem, por nuk janë thirrur në Prokurori. Përderisa banorët nuk kanë dhënë pëlqim, ata janë në të drejtën e tyre të protestojnë. Natyrisht, bashkia Bulqizë, nuk duhet të jetë e njëanshme në qëndrimet e saj, pasi është prona e saj dhe duhet ta mbrojë atë konform ligjeve të shtetit", tha Hyseni, e cila në atë kohë ka ushtruar e komanduar detyrën e Prefektes së Dibrës.

* * *

Gjithsesi, ndodhemi në situatën kur të dyja palët këmbëngulin në të tyren. Kompania koncensionare mbrohet me faktin se ka një kontratë të ligjshme për shfrytëzimin e masivit pyjor në "Sheshe Bulqizë" dhe duhet ta vejë në funksion atë konform ligjeve të shtetit. Por, edhe banorët, me protestat e herë pas hershme, janë po kaq të vendosur në mbrojtje të masivit pyjor, pasi siç thonë ata, pylli mbi fshatrat e tyre është e mbetet i vetmi burim jetese për ta. Kështu që banorët, jo vetëm që nuk i kanë ndërprerë protestat, por i kanë zhvendosur ata para bashkisë Bulqizë, ku njoftojnë për protestën e radhës, duke kërkuar që bashkia të reflektojë, në mbrojtje të tyre për pyjet.



Kompania: Jemi konform të gjitha rregullave. Kemi fituar një kontratë të ligjshme dhe po kërkojmë zbatimin e saj. Deri më tani mbi 100 mijë euro humbje



Ministri Blendi Klosi premton pezullim të kontratës

Protestat e banorëve të fshatrave, Dushaj, Koçaj, Kodra e Danit dhe Kokërdhak, në njësinë administrative Fushë-Bulqizë, të bashkisë Bulqizë, që kundërshtojnë shfrytëzimin e masivit pyjor "Sheshe Bulqizë", sipër këtyre fshatrave, kanë detyruar Ministrin e Mjedisit dhe Turizmit, Blendi Klosi, të marrë pjesë në protestën e tyre të radhës. Më 21 korrik, ministri Klosi, së bashku me deputeten Almira Xhembulla dhe Prefektin Nexhbedin Shehu, u ngjit në fshatin Kodra e Danit, ku u premtoi atyre se një kontratë koncensionare për shfrytëzimin e pyjeve të zonës, të cilën banorët e kundërshtojnë, do të synohet të pezullohet. Në fjalën e tij para protestuesve, ministri falënderoi banorët, për vënien e tyre në mbrojtje të pronës publike. Protestat tuaja janë një monument promovimi për vendin, se si t'i ruajmë pasuritë natyrore.

"Si qytetar jam me ju, si ministër do të ndjek procedurat ligjore për verifikimin dhe pezullimin e kontratës ", tha në fjalën e tij Ministri Klosi. "Ajo që duam të themi është se ne, unë si ministër, pavarësisht se duhet të them se pylli është në pronësi të pushtetit lokal, pra tashmë kontratën duhet ta implementojë kryetari i bashkisë, por unë do kërkoj në bazë të inspektimit që ka bërë Inspektorati i Mjedisit, pezullim të kontratës. Ju falënderoj se keni bërë një mision shumë të madh, atë të "mbrojtjes", tha ministri Klosi mes banorëve, të cilët brohoritën deklaratën e tij. Klosi shtoi më tej se rruga e Arbrit do prodhojë mirëqenie. Klosi gjithashtu u tha banorëve se ministria e tij e ka shqyrtuar dosjen e kontratës së shfrytëzimit të pyjeve pas ankesave të banorëve dhe ka dalë në konkluzionin paraprak se ka disa shkelje, ndaj ne do na duhet ta pezullojmë atë.

"Ajo që kuptojmë ne, Inspektorati i Mjedisit, Prefektura, kontrata në 4 vite që nuk është zbatuar ka ndryshuar shumë nga implementimi i saj i parë. Situata ka ndryshuar. Ka pasur një ndërhyrje që ne duhet ta verifikojmë, për devijimin e një rruge. Ka prerje të pemëve, kanë prerë disa dynym dhe kjo është një gabim që do të ketë ndërveprim ligjor," tha Klosi.

Banorët: Pezullimi na gëzon, por nuk do të ndalojmë protestat derisa zgjidhja të jetë ligjore

Deputetja e PS-së e Qarkut të Dibrës, Alma Xhambulla, në fjalën e saj vlerësoi ngritjen e nënave dhe grave një model, që do të mbahet mend gjatë në Shqipëri. Si deputete e zonës i kërkoj edhe në emrin tuaj, ministrit Klosi dhe qeverisë, që të reflektojnë me seriozitetin maksimal për këtë situatë që është paksa komplekse. Kemi predispozitën maksimale për ta zgjidhur çështjen në dobi të qytetarëve, u shpreh deputetja Xhembulla përpara banorëve.

Banorët nga ana e tyre, kanë shprehur vendosmërinë e tyre për ruajtjen e pyjeve.

"Ne jetojmë me këto pyje. Ata janë gjithçka për ne. Ndaj në asnjë rast nuk do ta lejojmë që hajdutë të veshur me pushtet, të na e marrin atë për pellet. Kjo lëvizje e jona në mbrojtje të një pasurie të përbashkët siç janë pyjet, në mbrojtje të të vetmes kurorë të gjelbër mbetur në Bulqizë, do vijojë duke na mbajtur të bashkuar, për ruajtjen e pronës së përbashkët. Kjo përgjigje, për pezullimin e kontratës, na gëzon, por deri në momentin kur të jetë e zeza mbi të bardhë, vulosur dhe firmosur, nuk do të ulë në asnjë moment vigjilencën tonë për ndalimin e shkatërrimit të masivit pyjor "Sheshe Bulqizë".

Rruga e Arbërit nr. 147

aktualitet

Një studim në terren i 20 ekspertëve të atashuar nga PNUD (Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara) ka vërejtur një situatë alarmante në të gjithë procesin që shoqëron ndërtimin e HEC-eve...

149 HEC-et që po "minojnë" zonat e mbrojtura



Pamje nga Lugina e Setes ne Diber, ku ndërtimi i një HEC ka ccuar në konflikte me banorët, të cilët kanë kërkuar pezullim të punimeve, për shkak se hidrocentrali po ndërtohet në një zonë të mbrojtur, rrezikon ujin për vaditje dhe ekosistemin e zonës. Gjyqi për këtë është shtyrë disa herë në gjykatën administrative të Tiranës.

Të 26 HEC-et tashmë në operim në zonat e mbrojtura dhe 123 HEC-et tjera që janë në ndërtim dhe të planifikuara kanë dëmtuar rëndë trashëgiminë natyrore. Një grup ekspertësh prej 20 vetash të atashuar nga PNUD inspektoi 71 HEC-et e vogla tashmë në punë dhe gjeti një "mal" me probleme. Kompanitë nuk kanë respektuar asnjë standard mjedisor, teksa autoritet kanë shkelur në mënyrë flagrante ligjet në fuqi dhe konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit.

Në pellgun e lumit Drin, situata është më e rëndë në Parkun Natyror Korab-Koritnik, ku 12 HEC-e janë në operim dhe 6 të tjera janë planifikuar. Në Parkun Kombëtar Rrajcë-Shebenik 1 HEC është operativ, 3 janë në ndërtim dhe 28 të tjera janë planifikuar të ndërtohen.

Projektet e HEC-eve mund të ndikojnë në procesin e ujitjes dhe përdorimin e ujit të pijshëm. Sipas sondazhit në terren dhe rishikimit të VNM-së, ndikimet aktuale negative mbi përdorimin e ujit, si ujitja, janë dukshme.

Blerina HOXHA / *Monitor.al*

Pak ditë më parë, banorët e Dragobisë në Tropojë kanë fituar betejën gjyqësore ndaj kompanisë që po ndërton tre hidrocentrale në Parkun Kombëtar të Valbonës. Punimet janë pezulluar deri në një shqyrtim më të thellë të ligjshmërisë në të cilin janë kryer, por në parqet e tjera kombëtare të vendit situata është alarmante, pasi objektet janë larg zonave të banuara dhe vëmendjes publike.

Një studim në terren i 20 ekspertëve të atashuar nga PNUD (Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara) ka vërejtur një situatë alarmante në të gjithë procesin që shoqëron ndërtimin e HEC-eve që nga momenti i dhënies së lejeve, planifikimit dhe ndërtimit. Dëmet më të mëdha janë bërë në zonat e mbrojtura, pasi aty dendësia e lumenjve dhe ujërave është e madhe. Në zonat e mbrojtura aktualisht kanë përfunduar punimet dhe janë në operim 26 HEC-e, 16 të tjera janë në proces ndërtimi dhe 105 të tjera kanë marrë lejen. Sakaq inspektimi në HEC-et e përfunduara, i pari i këtij lloji nga një ekspertizë e pavarur ka gjetur se pjesa e dërmuese e objekteve janë ndërtuar pa respektuar standardet mjedisore dhe ato për mbrojtjen e faunës. Kushtet për vendkalimin e peshqve nuk janë marrë në konsiderate dhe kriteret për rehabilitimin e mbeturave dhe rivitalizimin e zonës pas punimeve nuk janë bërë.

Grupi i ekspertëve inspektoi në terren të 71 HEC-et e ndërtuara tashmë dhe shqyrtoi anën ligjore për mbi 520 lejet e dhëna. Në përfundim të kërkimeve ata kanë formuluar rreth 30 rekomandime, të cilat ia ka vënë në dispozicion Ministrisë së Energjetikës për të përmirësuar sado pak situatën. Ekspertët kërkojnë që të mos ndërtohet asnjë HEC tjetër në zonat e mbrojtura. Nga verifikimet në terren ata gjetën se, pothuajse të gjitha HEC-et kanë krijuar erozion dhe në të ardhmen pritet të sjellin kosto të mëdha financiare në buxhetin e shtetit për të menaxhuar pasojat negative në vijimësi.

Gjithashtu ekspertet vërtetuan se Ministria e Energjetikes gjatë dhënies së lejeve nuk ka marrë në konsideratë ligjet e tjera në fuqi për mbrojtën e mjedisit dhe zonave të mbrojtura. Gjithashtu ata verifikuan se Shqipëria ka shkelur edhe konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit që i ka nënshkruar më parë. Sipas tyre lejet për ndërtimin e HE-ve janë dhënë pa analizën kosto përfitim, por të shtyra nga logjika e plotësimit të kërkesës për energji dhe nevojës për të hapur fronte të reja për biznes.

SHKATËRROHET TRASHËGIMIA NATYRORE

Përveç dëmit në habitate, pasojat negative që projektet e HEC-eve do të kenë mbi peizazhin do të ndikojnë më së shumti zonat e mbrojtura. Të gjitha këto pasoja do të jenë edhe më të mëdha në rastet kur projektet e HEC-së janë planifikuar me sistem ujëvarë. Gjatë vëzhgimit në terren, u vizituan 26 HEC-e në zonat e mbrojtura. Analiza hapësinore tregoi se disa zona të mbrojtura janë seriozisht në rrezik nga skema e zhvillimit të HEC-eve. Rishikimi i VNM (Vendimeve të Ndikimit në Mjedis) tregoi se ndikimet në zonat e mbrojtura nuk janë marrë parasysh për shumicën e projekteve në këto zona. Në pellgun e lumit Drin, situata është më e rëndë në Parkun Natyror Korab-Koritnik, ku 12 HEC-e janë në operim dhe 6 të tjera janë planifikuar.

Gjithashtu, në Parkun Kombëtar të Luginës së Valbonës, 4 HEC-e janë në ndërtim e sipër dhe një tjetër është planifikuar. Situata është më alarmante në pellgun e lumit Shkumbin në Parkun Kombëtar Shebenik-Jabllanicë ku tashmë 2 HEC -e janë në funksion, 3 janë në ndërtim e sipër dhe 30 të tjera janë planifikuar të ndërtohen në vijim.

Në pellgun e lumit Seman, 3 HEC-e tani anë funksionalë brenda Parkut Kombëtar të Tomorrit dhe 2 të tjera janë planifikuar. Në pellgun e lumit Vjosa, 3 HEC-e janë funksionale, 2 janë në ndërtim dhe 2 janë planifikuar të ndërtohen brenda Parkut Kombëtar të Bredhit të Hotove-Dangëllisë. Në pellgun e lumit Drin, dy zonat janë nën presionin e zhvillimit të HEC-ve. Në peizazhin e mbrojtur të Korabit, 1 HEC ka nisur punën dhe 9 të tjerë janë në plan të ndërtohen dhe Alpet (Parku Kombëtar i propozuar) janë 4 HEC-e në punë dhe 10 të tjera në plan për t'u ndërtuar.

Në Shkumbin, në Parkun Kombëtar Rrajcë-Shebenik 1 HEC është operativ, 3 janë në ndërtim dhe 28 të tjera janë planifikuar të ndërtohen. Në pellgun e lumit Seman, 3 janë vënë në punë, 3 janë në ndërtim e 2 janë planifikuar. Në Parkun e Moravës janë planifikuar të ndërtohen 5 HEC-e. Në pellgun e lumit Vjosa në Parkun Kombëtar Germen-Shelegure – Zona Leskovik-Piskal një HEC ka nisur punën, 1 është në ndërtim dhe 14 të tjerë janë planifikuar të ndërtohen.

DËMI NË PEIZAZH

Edhe pse një numër i madh HEC-esh ndodhen larg zonave të banuara, ato kanë potencial të ndryshojnë peizazhin. Ndërtimi i rrugëve hyrëse shkakton degradimin e karakteristikave të peizazhit në nivele të shumëfishta. Ndikimi i drejtpërdrejtë është heqja e vegjetacionit natyror, gërmimi në shpatet e pjerrëta, teksa ato bëhen shkak për erozion si pasojë e punimeve.

Ekspertët thonë se karakteristikat e peizazhit mund të zvogëlohen me kalimin e kohës. Nga 71 HEC-et e ndërtuara, në 44 prej tyre ka pasur erozion. Edhe menaxhimi i papërshtatshëm i mbetjeve të ndërtimit, si materialet e gërmimit ka sjellë pasoja negative në peizazh. Nga 43 HEC-et e inspektuara vetëm për 16,3% prej tyre kishin menaxhuar materialet gërmuese në mënyrë të përshtatshme. Në vendet e tjera, depozitimi i materialeve është i dukshëm dhe shpesh në brigjet e lumenjve ose në shtratin e lumit. Ekspertët vërejtën se 65% e projekteve kishin plane të rehabilitimit në terren, por thuajse të gjitha HEC-et e ndërtuara nuk e kanë kryer rehabilitimin. Kjo mund të dëmtojë rëndë turizmin. Por ndikimet e mundshme të projekteve të HEC-eve në komunitet ndryshojnë nga pozitive në jashtëzakonisht negative.

NDIKIMI NË KOMUNITET

Ndikimi më i madh i HEC-eve në komunitetin lokal është pakësimi i ujit. Gjatë verifikimeve në terren në shumicën e rasteve, analiza tregoi se aktualisht nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë në ujitjen e zonave përreth. Ndikimi më i madh negativ në ujitje do të ndodhë në luginat buzë lumit Mat ku është planifikuar një numër i madh HEC-esh. Ato mund të përkeqësohen në të ardhmen për shkak të ndryshimit të kushteve klimatike. Mungesa e ujit mund të shkaktojë konflikte ndërmjet komunitetit në këto zona.

Tashmë, shumica e konflikteve lidhur me hidrocentralet në Shqipëri kanë të bëjnë me të drejtat e shfrytëzimit të ujit. Hulumtimi tregoi se rrugët e krijuara rishtazi janë përdorur nga vendasit, të cilat mund të sjellin ndikim pozitiv për komunitetin lokal. Megjithatë, sipas studimit në terren, hapja e rrugëve ka çuar në prerje të paligjshme të drunjve. Pasoja të tjera negative në ekonominë e zonave mund të vijnë nga ulja e numrit të turistëve pasi ndërtimit të HEC-eve.

Në disa raste, përgatitja e projektit nuk përfshinte komunikim cilësor me banorët e prekur drejtpërdrejt, pasi shumë HEC-e janë bërë në zona të pabanuara. Sipas hulumtimeve mbi konfliktet e lidhura me zhvillimin e hidrocentraleve në Shqipëri, angazhimi i palëve të interesit çoi në reagime të forta ndaj projekteve, madje me bllokada dhe protesta në rrugë. Hulumtimet në terren tregojnë se 64% e konflikteve të palëve të interesuara ishin të pasuksesshme.

HEC-ET E NDËRTUARA PA VLERËSIM E NDIKIMIT NË MJEDIS

Gjetja më shqetësuese është se vetëm 6,8% e projekteve të shqyrtuara (3 nga 44 projekte) iu nënshtruan procedurave të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) sipas kërkesave ligjore, që i atribuohen koncesionit dhe procedurës së veçantë që i nënshtrohen.

Nga ana tjetër, rreth 80% e projekteve u mungonin VNM dhe detajet e përshkrimit të projektit të HEC-eve. P.sh., vlerësimet ishin dhënë pa referuar detaje të vendndodhjes (koordinatat e gabuara të GPS) karakteristika kryesore të projektit ose karakteristika të tjera të tij, siç janë rrugët apo linjat e energjisë. Një tjetër lloj i dokumenteve të analizuara në shqyrtim ishte Leja e Mjedisit. Pajtueshmëria me të u vlerësua dhe për shumicën e projekteve u përcaktua se pajtueshmëria nuk është e plotë. Bazuar dosjet e26 lejeve mjedisore në dispozicion, 96% e projekteve nuk i plotësojnë kërkesat e përcaktuara.

Shqipëria ka një regjistër qendror publik në internet të hidrocentraleve që menaxhohet nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (NANR), por informacioni nuk është i plotë dhe as i azhurnuar plotësisht.

ZBARDHET PLANI PËR NDËRTIMIN E 583 HEC-VE TË VOGLA

Kontratat për ndërtimin e hidrocentraleve të vogla kanë nisur të evoluojnë me shpejtësi, por studimi i ekspertëve të PNUD ka gjetur se do të ndërtohen të paktën 60 HEC-e më shumë se qeveritë shqiptare kanë njoftuar në gjithë këto vite. Megjithatë, te dhënat bëhen më konfuze për shkak të shifrave të ndryshme që japin entet publike.

Regjistri i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore numëron 524 hidrocentrale (HC), teksa një publikim i fundit i Ministrisë së Energjisë tregon një shifër prej 506 HEC-esh gjithsej që do të ndërtohen në Shqipëri. Ndërkohë një studim specifik në maj të vitit 2015, nga organizata të pavarura, ka zbardhur një shifër prej rreth 583 projekte HEC-esh që janë planifikuar të ndërtohen në Shqipëri, cilëson studimi i PNUD. Të dhënat tregojnë se 104 HEC janë në punë dhe 75 janë në fazën e ndërtimit. Potenciali hidroenergjetik i tyre llogaritet mbi 2,100 MW.

Standardet ekzistuese të mbrojtjes së mjedisit, duke përfshirë mekanizmin e Vendimeve të Ndikimit në Mjedis nuk zbatohen në mënyrën e duhur gjatë miratimit, ndërtimit dhe funksionimit të HEC-eve.



Tubacionet e magazinuara buzë lumit Drin, që do të përdoren në ndërtimin e HEC në Kanionin e Setës.

Ndikim tjetër mbi biodiversitetin mund të krijohet nga fragmentimi i habitatit të shkaktuar nga hapja e rrugëve hyrëse, ndërtimi i linjave të reja të energjisë ose devijimi tubacioneve. Të gjitha HEC-et bazohen në tubacione për të devijuar ujin në turbinat e tyre, 56% e HEC-eve të vizituara kërkojnë rrugë të reja, kurse 46% linja të reja të energjisë.

PSE U NDËRTUAN

Ndërtimi i hidrocentraleve të vogla në lumenjtë dhe përrenjtë shqiptarë u nxit më së shumti nga nevojat për energji dhe kërkesa e privatëve për burime të reja investimi. Shumë koncesione u dhanë ndaj kompanive që nuk kishin burimet financiare të nevojshme dhe burimet njerëzore për menaxhimin e këtyre projekteve dhe këtë e tregoi edhe ecuria e mëvonshme e këtyre projekteve, pasi shumica e tyre nuk arritën të aktivizoheshin në afate dhe shumë leje u rishitën dhe ndërruan pronësi.

Grupi i ekspertëve ka gjetur se mekanizmi i zhvillimit të HEC-eve të vogla nuk është i qëndrueshëm dhe paraqet problematika në aspektin e ndikimit që kanë në mjedis. Ekspertët kanë gjetur se projektet janë zhvilluar pa një analizë kosto-përfitim, duke marrë në konsideratë se në shumë raste, dëmi që krijojnë në mjedis është më i lartë se përfitimet që vijnë nga prodhimi i energjisë. Degradimi që krijojnë në mjedis, nëpërmjet mungesës së ujit dhe në shumë raste, pengesat në zhvillimin e turizmit dhe dëmit të bimësisë dhe kafshëve janë shumë të mëdha në raport me përfitimin që sjell një HEC. Mekanizmi ekzistues i integrimit mjedisor në procedurën e koncesionit nuk është i mjaftueshëm për të garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe zbatimin e legjislacionit mjedisor.

ZHVILLIMI PA ASNJË PLAN

Ndërtimi i HEC-eve të vogla nuk është bazuar në një sistem planifikimi të ekuilibruar, por vetëm nga kërkesa për energji dhe nevoja për të bërë biznes. Promovimi i zhvillimit të sektorit të HEC-eve të vogla mbështetur nga Plani Kombëtar i Veprimit për Energji të Rinovueshme (NREAP) 2015 – 2020 i jep përparësi ndërtimit të HEC-eve. Nga ana tjetër, grupi i ekspertëve i PNUD ka verifikuar se promovimi i investimeve të hidroenergjisë mbështetet nga mjetet e "kontrollit dhe balancimit" siç janë planifikimi i menaxhimit të ujit ose përdorimi i qëndrueshëm i biodiversitetit.

Planet ekzistuese të menaxhimit për zonat e mbrojtura dhe biodiversitetin nuk janë marrë në konsideratë, d.m.th as nuk janë miratuar dhe as nuk janë zbatuar nga Ministria e Energjetikës. Plani për energjinë e rinovueshme 2015-2020 nuk është hartuar duke marrë në konsideratë ndikimin në mjedis të HEC-eve.

LIGJET PËR MBROJTJEN E NATYRË NUK ZBATOHEN

Zhvillimi aktual i HEC-eve nuk është në përputhje me legjislacionin ekzistues për mbrojtjen e natyrës në Shqipëri. Shumë HEC-e janë ndërtuar ose janë planifikuar brenda zonave të mbrojtura. Vendimmarrja e zhvillimit të HEC-së nuk është bazuar në informacione të sakta mbi zonën ku ndërtoheshin dhe nga ana tjetër, mungonte një inventar i pasurive të biodiversitetit dhe habitateve të lidhura me to. Pothuajse të gjitha studimeve të ndikimit në mjedis u mungon plotësisht vlerësimi i ndikimit të biodiversitetit.

Ekspertët kanë gjetur se zhvillimi aktual i HEC-eve është në kundërshtim me objektivat e mbrojtjes së biodiversitetit të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen e Biodiversitetit në Shqipëri 2015-2020.Ky zhvillim i pabalancuar i HEC-eve pritet që të rezultojë me pasoja të dëmshme si humbja e habitateve dhe llojeve të biodiversitetit, shpyllëzimin, mungesa e uji dhe erozion. Ekspertët gjetën se praktika aktuale e zhvillimit të këtyre objekteve nuk është në përputhje me disa marrëveshje ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit që Shqipëria i ka nënshkruar tashmë.

MJEDISI I CENUAR

Standardet ekzistuese të mbrojtjes së mjedisit, duke përfshirë mekanizmin e Vendimeve të Ndikimit në Mjedis nuk zbatohen në mënyrën e duhur gjatë miratimit, ndërtimit dhe funksionimit të HEC-eve. Grupi i ekspertëve ka gjetur se miratimet mjedisore nuk po mundin të krijojnë një mbrojtje efektive të mjedisit. Kushtet e vendosura janë shumë të përgjithshme dhe nuk bazohen në karakteristikat rast pas rasti. Projektet dhe planet e biznesit nuk përfshijnë kostot mjedisore të HEC-it. Po ashtu ka mungesë rregullash për përgjegjësinë mjedisore të HEC-eve.

Sipas ekspertizës, kostoja në mjedis që do të krijojnë HEC pritet të jetë një barrë e madhe financiare për shpenzimet publike, për të trajtuar në vijim degradimin e mjedisit si shpyllëzimi, erozioni dhe humbja e biodiversitetit. Ndikimet kumulative të HEC-eve në të njëjtën kaskadë nuk janë vlerësuar dhe nuk janë marrë asnjëherë në konsideratë në procesin e vendimmarrjes.

NDIKIMET NË UJËRAT NËNTOKËSORE DHE SIPËRFAQËSORE

Sipas rezultateve të studimit në terren dhe ndikimeve të vlerësuara në VNM, shumica e projekteve të planifikuara kanë pasoja të vogla në ujërat nëntokësore në zona të rëndësishme si në Erzen – Baseni Ishmi. Situata është pak më e keqe në pellgjet e lumenjve Vjosa dhe Semani. Në Shkumbin dhe lumin Drin kanë ndikim më të madh. Sipas analizës së ekspertëve, gjendja më e keqe është në pellgun e lumit Mati ku rezultatet tregojnë se projektet e HEC mund të kenë pasoja të mëdha kumulative.

Por, nga ana tjetër, asnjë prej VNM-ve nuk ka marrë parasysh ndikimin e HEC-eve në ujërat nëntokësore, edhe pse këto janë shumë të rëndësishme për të ardhmen e lumenjve. HEC-et mund të shkaktojnë ndryshime në morfologjinë e lumit si vazhdimësia, thellësia, gjerësia e rrjedhës ujore si dhe ndryshimet në strukturën dhe nënshtresën e shtratit të lumit dhe të lumit. Sipas rezultateve të studimit në terren, gjatësia e parashikuar e lumenjve të prekur nga devijimi i ujit (nga pika e marrjes në pikën e hyrjes) fuqia dhe pika e lëshimit) është më e larta për pellgun e Shkumbinit, ku mesatarja e lumit e prekur është 3,83 km, e ndjekur nga 3.73 kilometër të basenit të Vjosës. Situata është pak më e mirë në lumenjtë e Erzenit dhe Ishmit, Drini, Semani dhe Lumi Mat preken në një gjatësi me shkurtra.

Edhe pse një HEC i vetëm mund të ndikojë në gjatësinë e lumenjve së paku me një kilometër, e vërteta është se ndikimi kumulativ vjen nga kaskadat. Sistemet e kaskadës kanë ndikim të madh tek lumenjtë pasi ato mund të shkaktojnë ndryshime të rëndësishme në rrjedhën e lumenjve dhe nivelin e ujit. Por dhe nëse HEC-et nuk janë planifikuar si sistem kaskadë, ka të ngjarë që ato të jenë në një lumë që ka më shumë se një HEC gjatë rrjedhës në drejtim të rrymës ose në degët e saj.

THAJNË UJIN DHE DËMTOJNË PESHKUN

Projektet e HEC-eve mund të ndikojnë në procesin e ujitjes dhe përdorimin e ujit të pijshëm. Sipas sondazhit në terren dhe rishikimit të VNM-së, ndikimet aktuale negative mbi përdorimin e ujit, si ujitja, janë dukshme. Shumica e projekteve të HEC-eve, ka të ngjarë që të kenë ndikim të konsiderueshëm kumulativ në faunën e peshkut, nëse nuk merren masat e duhura. Standardet e sotme imponojnë që HEC-et të kenë rrjedhat e posaçme për peshk. Por nga vëzhgimet në terren, shumica e projekteve të HEC-eve nuk kanë rrjedha të tilla. Në këtë mënyrë, ato do të krijojnë një ndikim të fortë kumulativ negativ në faunën tonë. Kjo situatë është shkaktuar nga fakti se në gati 41% të VNM-ve të rishikuara për ndikimet mbi popullatat e peshkut nuk janë marrë parasysh nga zhvilluesit e HEC-eve.

Një ndikim tjetër mbi biodiversitetin mund të krijohet nga fragmentimi i habitatit të shkaktuar nga hapja e rrugëve hyrëse, ndërtimi i linjave të reja të energjisë ose devijimi tubacioneve. Të gjitha HEC-et bazohen në tubacione për të devijuar ujin në turbinat e tyre, 56% e HEC-eve të vizituara (71 gjithsej) kërkojnë rrugë të reja, kurse 46% linja të reja të energjisë. Këto ndikime negative janë më të theksuara në zonat e pabanuara, ku gjatësia e infrastrukturës së nevojshme është më e madhe, dhe gjithashtu habitatet janë të natyrshme. Përveç kësaj, linjat e reja të energjisë rrisin rrezikun për zogjtë. Duke pasur parasysh analizën e mësipërme të ndikimeve negative në biodiversitet, dëmet mund të jenë edhe më të mëdha në zonat e mbrojtura – thuhet në studim.

REKOMANDIMET PËR TË FRENUAR PËRKEQËSIMIN

– Duhen të merret në konsideratë analiza e kostove që krijojnë HEC-et në procesin e vendimmarrjes. Duhen të inventarizohen habitatet dhe fauna, si dhe të përcaktohen llojet që janë në kërcënim.

– MTE-ja mund të zbatojë planet ekzistuese të veprimit për speciet e kërcënuara dhe të financojë më shumë studime mbi llojet e habitateve.

-Të aplikohen standarde specifike të mbrojtjes së mjedisit për projektet e HEC-eve dhe të krijohet një legjislacion efektiv për mbrojtjen e mjedisit

– Programet monitoruese duhet të zbatohen në nivel kombëtar.

– Të aplikohen politika dhe një plan veprimi për efektet e ndryshimit të klimës

– Sistemi i monitorimit hidrometeorologjik duhet të përmirësohet për të lejuar ose jo ndërtimin e HEC-ve të reja.

– Rekomandohet që të aplikohen dispozita në legjislacionin kombëtar si ato të Direktivës 2004/35 / EC i Parlamentit Europian mbi përgjegjësinë mjedisore në lidhje me parandalimin dhe korrigjimin e dëmit mjedisor, i cili funksionon me parimin "Ndotësi paguan" për të zbutur dëmet mjedisore në tokë, ujë dhe biodiversitet.

– Faktorët mjedisorë dhe socialë duhet të integrohen në procedurën e dhënies autorizim për zhvillimin e projekteve të HEC-eve nën 2 MË, të cilat nuk janë subjekt i procedurës koncesionare.

– Në përgjithësi, procesi i koncesionimit duhet të japë më shumë rëndësi ndikimit në mjedis dhe analizës kosto-përfitim.

– Informacioni mjedisor (raporti VNM) gjatë procedurës së tenderit duhet të jetë rast për rast, jo i përgjithshëm, sikur ka ndodhur deri më tani

-Shqyrtimi dhe përfshirja e ndikimit në mjedis në procesin e koncesionit duhet të kryhet nga MTE.

-Ecuria mjedisore (pjesa e caktuar e pikëve) brenda procedurës së tenderit prej 10% nuk mjafton për të ndikuar në projektin e propozuar, por vetëm të zvogëlojë ose të rrisë shanset për të fituar tenderin nga investitori përkatës.

-Përmirësimi i legjislacionit duke miratuar një kriter të veçantë mjedisor (një instrument ligjor) për vlerësimin i HEC-eve të propozuara në këtë fazë do të përmirësonte procesin e vendimmarrjes.

-Miratimi përfundimtar i projektit duhet të bëhet pas fazës së miratimit të VNM (brenda MTE) dhe bazuar mbi kriteret ekologjike të vendosura gjatë procedurës së VNM.

- MTE duhet të jetë në gjendje të sigurojë që parametrat përfundimtarë të projektit janë në përputhje me standardet mjedisore.

-MIE dhe ministritë përkatëse duhet të publikojnë detajet e nismës, duke përfshirë detajet teknike në lidhje me zonën e zhvillimit projektit, dhe jo vetëm njoftimet e vendimeve. MIE duhet të ftojë palët të japin komente dhe sugjerime për projektin para publikimit e thirrjes për tender.

– Rekomandohet të vazhdohet me zhvillimin e një baze të dhënash GIS të projekteve të HEC-eve, të cilat duhet të jenë në dispozicion të publikut.

-Për shkak të vlerës së zonave të mbrojtura, rekomandohet të mos ndërtohen më HEC-e në këto zona.

-Përgatitja e projektit duhet të përfshijë komunikim cilësor dhe angazhim me aktorët e prekur drejtpërsëdrejti.

-Koha për përgatitjen dhe dorëzimin e dosjeve të projektit nga investitorët duhet të jetë të mjaftueshme për të mundësuar studimin e pasurive biologjike në zonën e projektit.

-Përshkrimet e projektit duhet përfshijnë të gjitha detajet e nevojshme për vlerësimin e ndikimit në mjedis, veçanërisht të dhënat e sakta të vendndodhjes dhe rrjedhës së ujit (siç janë rrugët, linjat e energjisë, kanalet e devijimit, tubacionet dhe sipërfaqja nën ndikimin nga projekti)

– Raportet e VNM duhet të adresojnë ndikimet e projektit në biodiversitet (lumenj dhe tokë). Gjithashtu, ata duhet vlerësojnë ndikimet kumulative mbi këto parametra mjedisorë (që vijnë nga HEC-et).

– VNM duhet të rekomandojnë masa zbutëse efektive për të gjitha ndikimet e përcaktuara.

-Projektet e HEC-eve me diga duhet të kenë pasazhe të peshkut.

-Nëse monitorimi tregon efekte negative nga devijimi i rrjedhës ndryshimet në regjimin e përdorimit të ujit duhet të bëhen në përputhje me rrethanat.

-Përdorimi i ujit për qëllime energjetike nuk duhet të pengojë përdorimin e ujit të pijshëm ose përdorimin e ujit për ujitje

-Nëse një projekt është planifikuar me një rezervuar, rekomandohet që përveç funksionit të tij origjinal, duhen të merren në konsideratë aktivitete rekreacioni

-Format e HEC-eve duhet të ndjekin gjerësisht karakteristikat dhe format e peizazhit lokal.

-Gjatë ndërtimit, materiali i tepërt i gërmuar duhet të vendoset në një vend të përshtatshëm, larg nga rrjedha e ujit.

– Pas ndërtimit, është e nevojshme të riparohet zona përreth me rehabilitimin e pjerrësive dhe zonat e erozionit, rindërtimi i bankave të lumit (kthimi në gjendjen natyrore të mundshme) të peizazhit dhe ripyllëzimit.

-Nëse HEC-et që veprojnë tregojnë ecuri të dobët mjedisore, miratimet mjedisore duhet të jenë rishikuar dhe përditësuar me rast / rast kushtet / masat për mbrojtjen e mjedisit (në përputhje me standardet specifike të mbrojtjes / kriteret e performancës për projektet e HEC – rekomandimi 5) dhe të gjitha lejet përkatëse duhet të jenë në përputhje me rrethanat (p.sh., mjedisore, uji, energjia etj.), e ndjekur nga zbatimi i kushteve të reja në vend.

-Projektet e miratuara për të cilat ende nuk ka nisur puna duhet të rivlerësohen, duke përfshirë edhe faktorin e ndryshimit të klimë.

Rruga e Arbërit nr. 147

veprimtari

Të rinjtë në Peshkopi dhe në Urën Vajgurore, në fokus të projektit që synon angazhimin e të rinjve në krijimin e komuniteteve lokale të qëndrueshme kundër ekstremizmit

Ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizmi fetar tek të rinjtë

Ritja e radikalizmit fetar dhe ekstremizmit të dhunshëm u manifestua në Shqipëri në rastin më ekstrem me shtetas shqiptarë të cilët iu bashkuan konflikteve në Siri dhe në Irak. Ndonëse shifrat variojnë sipas raportimeve të ndryshme, mendohet se më shumë se 100 shqiptarë t'i jenë bashkuar konfliktit në një kontekst fetar. Disa arrestime janë bërë ndër rradhët e imamëve të rekrutuar, të cilët më vonë janë proceduar penalisht. Shteti shqiptar sakaq ka ndërmarrë të gjitha masat legjislative dhe zbatuese, si partner në luftën ndërkombëtare ndaj terrorizmit. Hulumtime të mëtejshme që pasuan, nxorrën në dukje se disa nga faktorët dhe arsyet e radikalizimit të të rinjve, që i shtynin ata drejt akteve të dhunshme dhe i bënin pre të manipulimeve, ishin niveli i ulët i njohjes me fenomenin dhe niveli i ulët i përgatitjes për parandalim, margjinalizimi apo izolimi socio-ekonomik dhe mungesa e një koordinimi efektiv ndërmjet mekanizmave institucionalë.

Të dyja zonat e Peshkopisë dhe Urës Vajgurore janë të prekura nga zhvillimi i ulët ekonomik, mundësitë e pakta të zhvillimit për rininë, margjinalizimi shoqëror e mungesa e informacionit mbi temat e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Për këtë arsye, Instituti Shqiptar i Studimeve Ndërkombëtare në bashkëpunim me dy organizata lokale Art-Culture-Initiative (ARCI) dhe Qendrën për Zhvillim Rajonal dhe Ekonomik (Alpin) ka zhvilluar një seri diskutimesh të hapura dhe seminarësh me qëllim angazhimin e të rinjve në krijimin e komuniteteve lokale të qëndrueshme kundër ekstremizmit. Në total, 4 seminarë dhe 4 diskutime të hapura janë mbajtur në Peshkopi dhe në Urën Vajgurore nga lektorë dhe ekspertë të çështjeve të sigurisë dhe të ekstremizmit të dhunshëm, mbështetur nga fondet e Bashkimit Evropian, dhe grantit të përfituar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit që i rendit këto organizata ndër rradhët e dhjetëra organizatave që po bashkëveprojnë me njëra-tjetrën në mbarë Shqipërinë si pjesë e rrjetit "Shoqëria civile kundër ekstremizmit të dhunshëm".

Në një prej diskutimeve të hapura të mbajtura në rrethin e Dibrës, Hysen Uka, ekspert i sigurisë, foli mbi konceptet e ekstremizmit, ekstremizmit të dhunshëm, radikalizmin dhe favorizimin e terrorizmit në përgjithësi, si dhe duke u ndalur në shfaqjen e këtyre fenomeneve te fëmijët dhe të rinjtë. Përmes sqarimit të këtyre koncepteve, u synua që të pranishmit, mësues, prindër, klerikë të besimeve të ndryshme, por dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, të bashkëbisedonin dhe të kishin kuptim të njëjtë apo të përafërt për këto fenomene. Për të gjithë pjesëmarrësit në seminar, grupi i synuar ishte i njëjtë: fëmijë, nxënës dhe të rinj.

"Të gjithë kanë detyrimin dhe përgjegjësinë shoqërore, por dhe ligjore që gjatë procesit të edukimit të kuptojnë e të parandalojnë në kohë çdo ndikim apo tendencë për ekstremizëm e radikalizëm të dhunshëm. Masat preventive, parandaluese, janë më efektive se të luftosh fenomenin kur ai të jetë shfaqur në një formë apo në një tjetër," theksoi lektori Hysen Uka.

Por, a ka raste apo shfaqje të sjelljve të dhunshme dhe radikale nga nxënësit dhe fëmijët në shkolla, në mjedise shoqërore etj., në rrethin e Dibrës? Uka theksoi se nuk mund t'u fshihemi disa fakteve, të mos pranojmë se raste të sjelljes së dhunshme apo ekstremiste edhe në rrethin tonë ka. Shkaqet për veprime e sjellje ekstremiste e të dhunshme janë të shumta e të larmishme.

Ata kanë burim kryesor proceset ende të pamaturuara të shndërrimeve social-politike e kulturore në vendin tonë. Shoqëria jonë ka pësuar ndryshime tërësore, radikale, dhe kalimi nga totalitarizmi në sistemin e demokracisë liberale krijon hapësira edhe për keqpërdorim të lirisë, apo shpërdorim të saj. Në kuptimin institucional, reforma ka prekur të gjitha llojet e marrëdhënieve: marrëdhëniet në familje, marrëdhëniet në shkollë mësues-nxënës dhe ato midis nxënësve, marrëdhëniet në shoqëri. Gama e lirive është zgjeruar e plotësuar edhe me liritë e besimit e predikimit, të organizimit etj.

Zhvillimi i vrullshëm i teknologjisë, veçanërisht i asaj të komunikimit e të përhapjes së informacionit, e ka vënë sistemin e edukimit dhe të kujdesit ndaj fëmijëve dhe të brezit të ri përballë sfidash të vështira e të vazhdueshme, sfida që nuk mund të përballohen vetëm dhe pa një bashkëpunim të vazhdueshëm, të gjithanshëm e në të gjitha nivelet shoqërore dhe institucionale. Përhapja e lajmeve të pavërteta, manipulimi i ngjarjeve, nxitja e prirjeve radikalizuese, krijimi i rrjeteve të solidarizimit e të ndërveprimit për qëllime e ide radikale, stimulimi dhe frymëzimi i ndjenjës së heroizmit në mjediset e të rinjve e të fëmijëve krijojnë problem serioz me të cilat jemi përballur vitet e fundit në forma të ndryshme. Kohezioni social dhe siguria e komunitetit janë vazhdimisht të kërcënuara, veçanërisht nga të rinj të ekstremizuar e të radikalizuar nga rrethana e ndikime brenda vendit apo nga jashtë.



Dhuna në disa shkollat të rrethit Dibër ka shënuar edhe raste fatale, me humbje jetësh të nxënësve.
Fëmijët janë të prirur të zgjedhin modele, kryesisht modele të të fortëve, të të rinjve apo shokëve me ndikim e imponues, të atyre që sfidojnë rregullat e nuk njohin rrezikun.

Dhuna në disa shkollat të rrethit Dibër ka shënuar edhe raste fatale, me humbje jetësh të nxënësve. Fëmijët janë të prirur të zgjedhin modele, kryesisht modele të të fortëve, të të rinjve apo shokëve me ndikim e imponues, të atyre që sfidojnë rregullat e nuk njohin rrezikun. Shoqërimi me to duket edhe fëmijët dhe të rinjtë. Por, në mjedisin tonë social, sidomos në rrethe periferike e me lëvizje të vazhdueshme të popullatës vendase, me destabilizim tërësor të hierarkisë së vlerave, hapësirat për depërtimin e fenomeneve të ekstremizmit të dhunshëm e të radikalizmit që frymëzon terrorizmin janë të shumta dhe përdoren prej organizatave apo individëve me prirje radikaliste e ekstremiste".



Ndërkaq në Urën Vajgurore, në një prej diskutimeve të hapura të mbajtura aty, lektori, Vilson Shehu cilësoi marrëdhëniet midis prindërve e fëmijëve si një prej zgjidhjeve më të rëndësishme e efektive. Komunikimi i hapur, inkurajimi i pjesëmarrjes në aktivitete pozitive, kontrolli mbi aplikimet online, ndihma për të kuptuar rreziqet, shpjegimi se ka shumë mashtrues në ofertat online etj. u diskutuan si dukuri që sot janë prezente e mund të shndërrohen në rrezikshmëri.

Uka theksoi se ekstremizmi i dhunshëm nuk gjen kushte në një shoqëri të konsoliduar, në një shoqëri në të cilën rregulli dhe ligji, veprojnë dhe janë njëlloj për të gjithë, vlerat që krijon shoqëria ju përkasin, respektohen dhe mbrohen nga institucionet në shërbim të shoqërisë, jo në shërbim të më të fortëve. Shoqëria vetë krijon modelin e mirë, prej të cilit frymëzohen e udhëhiqen sikur u jep siguri më të dobtëve dhe të paqëndrueshmëve, të cilët më vonë bëhen viktima të zgjedhjes dhe shoqërisë së tyre të gabuar.

Për më shumë informacione mbi aktivitete të ngjashme pranë jush, ju ftojmë të ndiqni faqen Shoqëria civile kundër ekstremizmit të dhunshëm në Facebook.





Më shumë mund të shikoni në faqen e gazetës në FB: Rruga e Arbërit
ose ndiq linkun: goo.gl/1bq2r6

Publikimi i vendimeve të Këshillit Bashkiak dhe transparenca e njësive të pushtetit vendor është një detyrim që buron nga ligji 119/2014 "Për të drejtën e Informimit"

Bashkitë e qarkut të Dibrës, **jo transparente** në publikimin e vendimeve të Këshillit Bashkiak

Nga Sami CURRI

Nga një vëzhgim i realizuar nga Porta Vendore për transparencën e 4 bashkive të qarkut Dibër në lidhje me informacionin e nevojshëm për mbledhjet e këshillit bashkiak si dhe vendimet që merren, bashkia Mat rezultoi më korrekte përsa i përket publikimit të vendimeve, ndërsa në Bashkitë Klos, Bulqizë dhe Dibër transparenca lë shumë për të dëshiruar. Mos publikimi i vendimeve shpesh konfuzon edhe qytetarët e këtyre zonave duke e bërë informacionin e paaksesueshëm.



Xhafer Imeri është banor i Lagjes së Re në Bulqizë. Në fillim të muajit shtator 2017 pronat e tij, por edhe të shumë banorëve të tjerë në këtë lagje u dëmtuan nga rrëshqitja e tokës. Për këtë, me kërkesë të Këshillit Bashkiak Bulqizë, u ngrit një grup inspektimi nga Bashkia Bulqizë dhe Shërbimi Gjeologjik Shqiptar. Por edhe pse kanë kaluar më shumë se 7 muaj nga ky inspektim, ai dhe banorët e tjerë nuk dinë se cilat ishin gjetjet e këtij raporti për shkaqet e rrëshqitjes së tokës, edhe pse kanë kontaktuar me administratën e Bashkisë. "Ku ta marrim vesh se çfarë ka ndodhur. Raporti u tha se do t'i kalonte Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak dhe më pas do mund ta merrnim. Po ku të drejtohemi, ne nuk dimë ku të drejtohemi për të mësuar për atë se çfarë na ka ngjarë ne", shprehet për Porta Vendore Xhafer Imeri.

Që prej vitit 2015 banorët e tre fshatrave të njësisë administrative Fushë-Bulqizë, po protestojnë për mbrojtjen e një masivi pyjor të njohur si "Sheshe Bulqizë", e vetmja zonë pyjore që ka ngelur e pa prekur deri më sot. Bashkia e Bulqizës në fillim të muajit maj, pas një kërkesë të koncesionarit, tentoi të shtynte afatet e lejes së ndërtimit të rrugës automobilistike për shfrytëzimin e masivit pyjor, që kundërshtohet nga banorët, pasi leja për këtë të fundit kishte përfunduar, kjo e kërkuar përmes një projekt-vendimi, për të cilin kërkoi miratimin e Këshillit Bashkiak. Koncesionari ka fituar një tender për shfrytëzimin e masivit pyjor të njohur si "Sheshe Bulqizë", fillimisht bashkimi i tri kompanive kishte një koncesion për shfrytëzim pa rrugë auto – pyjore dhe më pas bërë një shtojcë në kontratë me Ministrinë e Mjedisit dhe me pëlqimin e Bashkisë Bulqizë për hapjen e një rruge që do të dërgonte tek masivi pyjor.

Pas dy mbledhjesh, Bashkia përmes juristit të saj, njoftoi tërheqjen e kërkesës për votimin e projekt-vendimit, duke thënë se Këshillit i ishte kërkuar vetëm mendim.

Por vetëm pak ditë më parë, kompania që ka fituar koncesionin, "Almex-Wood" dhe 'Lubima' sh.p.k, për shfrytëzimin e pyllit pranë fshatrave, vazhdoi punën për hapjen e rrugës. Lahim Deda, një prej banorëve të zonës u shpreh për Portën Vendore se vendimin apo edhe procesverbalin e mbledhjes së Këshillit nuk e disponojnë. "Protesta është kolektive. Për të marrë vendimin e Këshillit që e refuzonte propozimin e kompanisë për hapjen e rrugës automobilistike duhet t'i biesh nga Kina. Të bësh kërkesë e të presësh derisa ata të kthejnë përgjigje. Kjo është punë kolektive, do të duhej një person që të merret me këtë punë. Por situata është e tillë që çdo vonesë kthehet në problem. Kur këta mund t'i publikonin vendimet në faqen e internetit dhe ju plasje në fytyrë vendimin dhe atë se çfarë Këshilli kishte vendosur për këtë çështje" shprehet Deda.

Publikimi i vendimeve të Këshillit Bashkiak dhe transparenca e njësive të pushtetit vendor është një detyrim që buron nga ligji 119/2014 "Për të drejtën e Informimit" dhe gjithashtu nga ligji organik 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 17 pika 2 thuhet qartë se: "Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara për këtë qëllim brenda territorit të njësisë vendore dhe në media të aksesueshme në njësinë vendore, dhe përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes". Me një ligj të tillë edhe afishimi i vendimeve nënkuptohet. Ku në faqen e internetit të pushtetit vendor duhet të jenë të afishuara vendimet. Banorët kanë pasur ankesë se edhe mbledhja nuk është bërë publike. Por nga bashkitë e Qarkut të Dibrës një ligj i tillë shkelet me të dyja këmbët.

BASHKIA DIBËR

Pas kërkesës për informacion të"Porta Vendore" drejtuar bashkisë së Dibrës, kjo e fundit deklaron se datat e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak publikohen së bashku me rendin e ditës në faqen zyrtare të Bashkisë Dibër dibra.gov.al, gjithashtu edhe vendimet e Këshillit Bashkiak publikohen në të njëjtën faqe.

Nga monitorimi i faqes së Bashkisë Dibër, në kategorinë "Këshilli Bashkiak", rezulton se një gjë e tillë nuk bëhet, por jepet vetëm një informacion rreth punës së Këshillit. Madje tek kjo kategori e cila duhet të ishte e pasur me informacion, nuk ekziston as dhe lista e këshilltarëve. Publikimi për mbledhjen e Këshillit Bashkiak më 16 maj 2018, është bërë fill pas kërkesës për informacion të Portës Vendore. Ndërkohë asnjë vendim i marrë nga Këshilli Bashkiak Dibër nuk është publikuar në faqen e internetit të Bashkisë.

Menjëherë pas kërkesës për informacion që Porta Vendore ka depozituar në bashkinë Dibër, ka pasur lëvizje në këtë drejtim.

Irini Shehu, anëtare e Këshillit Bashkiak Dibër, përfaqësuese e Partisë Demokratike u shpreh për "Porta Vendore" se anëtarët në Këshillin Bashkiak të Dibrës e kanë ngritur disa herë si shqetësim këtë çështje, duke i kërkuar administratës së Bashkisë që të marrë masat e nevojshme për publikimin në faqen e internetit të Bashkisë të vendimeve që merren nga Këshilli Bashkiak, por që deri më sot, sipas Shehut nuk ka marrë zgjidhje ky problem. "Situata ka arritur deri në atë pikë sa që janë marrë edhe vendime pa qenë kuorumi i nevojshëm për të zhvilluar mbledhjen. Kemi konstatuar 2-3 vendime të tilla, kjo në shkelje të plotë të ligjit dhe rregullores së Këshillit Bashkiak. Për këtë ne si këshilltarë të opozitës kemi dashur t'i drejtohemi edhe prokurorisë për të ndjekur procedurat e nevojshme", tha zonja Shehu.

Muharrem Rama, kryetar i Bashkisë së Dibrës tha për Portën Vendore se akuzat për vendime të marra pa kourumin e nevojshëm, nuk qëndrojnë dhe se Bashkia e Dibrës ka një raport shumë të mirë me anëtarët e Këshillit Bashkiak dhe thuajse vendimet kanë kaluar me unanimitet të plotë. Por Rama pranoi se mos publikimi i vendimeve në faqen e internetit të Bashkisë është një problem që do të marrë shumë shpejt zgjidhje. " Partia Socialiste në Këshillin Bashkiak të Dibrës është opozitë, si mund të marrë opozita vendime pa mazhorancën!? Sa për mos publikimin e vendimet është e vërtetë që nuk bëhet një gjë e tillë, por kam urdhëruar administratën të marrë të gjitha masat e nevojshme që të bëhet sa më shpejt të jetëe mundur publikimi i vendimeve. Është një kritikë me vend dhe ne do të punojmë që një gjë e tillë të marrë sa më shpejt zgjidhje", deklaroi Rama për "Porta Vendore".

BASHKIA BULQIZË

Nga monitorimi i bërë në faqen e internetit të Bashkisë Bulqizë, të vetmet vendime të Këshillit Bashkiak Bulqizë të publikuara janë ato të muajit shkurt – mars 2017 dhe në asnjë muaj tjetër nuk është postuar asnjë vendim,dhe asnjë informacion për datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes së Këshillit Bashkiak. Gjithashtu Këshilli Bashkiak nuk ka një kënd të sajin në ambientet e Bashkisë. Nga përgjigja e dhënë, Bashkia deklaron se për shkak të problemeve teknike nuk kanë akses në faqen e internetit dhe se për një gjë të tillë kanë vënë në dijeni edhe institucionet përkatëse.

Gazmend Kenga, Kryetar i Këshillit Bashkiak Bulqizë nga radhët e Partisë Socialiste, tha se mbledhjet e Këshillit Bashkiak Bulqizë janë të hapura si për qytetarët që duan të marrin pjesë, por edhe për median. Për zotin Kenga deri më sot, vendimet e Këshillit Bashkiak kanë qenë thuajse unanime, me mbështetjen e të gjithë këshilltarëve dhe kanë kaluar në çdo hallkë institucionale, që nga qarku e deri tek prefekti duke marrë miratim.

"Sa për mos publikimin e vendimeve në faqen e internetit të Bashkisë Bulqizë, keni të drejtë që është një problem. Për këtë detyra është e administratës së Bashkisë dhe e Sekretarit të Këshillit që të marrin masat e nevojshme që çdo datë e mbledhjes së Këshillit Bashkiak dhe vendimet që merren të jenë të aksesueshme për qytetarët. Ky është një problem, e pranoj dhe se në mbledhjen më të afërt të Këshillit do ta ngre si shqetësim që të merren masat e nevojshme për zgjidhjen sa më shpejt të këtij problemi", u shpreh zoti Kenga për "Porta Vendore".

Por mungesa e transparencës së Këshillit Bashkiak në Bulqizë, përpos problemeve që ka krijuar tek qytetarët,është kthyer në një problem edhe për organizatat e ndryshme që operojnë në këtë zonë. Daniel Bica, përfaqësues i shoqatës "Ekspertët e Rinj Mjedisor" shprehet se në këtë drejtim bashkia Bulqizë është shumë problematike. "Ne na pengon sepse për të marrë vendimet e Këshillit duhet t'i biem gjatë e gjatë. Nëse këto vendime do të ishin në internet mund te aksesoheshin shumë kollaj nga ne si shoqëri civile, apo edhe nga qytetarët", tha zoti Bica.

Bashkia Dibër u vlerësua me 4 pikë nga 10 për transparencën e saj dhe implementimin e ligjit 119/2014 për të drejtën e informimit. Ndërsa bashkia Mat kishte performancën më të mirë në këtë drejtim, duke u vlerësuar me 7 pikë nga 10, krahasuar me tre bashkitë e tjera të qarkut Dibër.

BASHKIA KLOS

Edhe Bashkia e Klosit, ka të njëjtën problematikë, në sajë të monitorimit të kryer, rezulton se; që prej muajit nëntor 2017 nuk është publikuar më asnjë vendim që merret nga Këshilli Bashkiak. Por në faqen e Bashkisë së Klosit, ndryshe nga tre bashkitë e tjera të qarkut të Dibrës gjen një informacion më të plotë për këshilltarët, forcën politike që ata përfaqësojnë në këshill dhe se çfarë arsimimi kanë.

Dorina Qafa, përgjegjëse për Marrëdhëniet me Publikun në Bashkinë Klos tha për "Porta Vendore" se një problem i tillë ka ardhur si pasojë e mungesës së personelit të specializuar për tu marrë me faqen e internetit të Bashkisë. "Menaxhimin e faqes së internetit të Bashkisë Klos më parë e merrnim nga një person me kontratë të jashtme. Por ka disa muaj që një shërbim i tillë nuk ofrohet më dhe Bashkia nuk ka aktualisht një personel të kualifikuar për tu marrë me këtë punë edhe pse të gjitha materialet për publikim janë gati. Prej disa javësh kemi nje person nga Bashkia që po trajnohet në këtë drejtim dhe shpresojmë që faqja të jetë funksionale sa më shpejt", u shpreh zonja Qafa.

BASHKIA MAT

Në grupin e bashkive të Qarkut të Dibrës, më korrekte në publikimin e vendimeve që merren nga Këshilli Bashkiak është Bashkia Mat, ku në faqen e saj, bashkiamat.gov.al janë publikuar të gjitha vendimet dhe janë të aksesueshme për publikun. Bashkia Mat është korrekte në publikimin e vendimeve, por nga ana tjetër nuk publikojnë asnjë njoftim për datat e mbledhjeve dhe rendin e ditës për Këshillin Bashkiak.

"Ky problem do të marrë zgjidhje prej këtij muaji e në vazhdim. Mos publikimi i datave dhe ora e mbledhjeve ka ardhur si pasojë e mos koordinimit të sekretares së Këshillit Bashkiak Mat dhe administratës së Bashkisë, për shkak se ata nuk njoftonin se kur do të mbahej mbledhja e radhës", tregoj Edison Doçi, përgjegjës për Marrëdhëniet me Publikun në Bashkinë Mat.

Në sajë të një monitorimi kombëtar të realizuar nga Qendra për Çështje të Informimit Publik, INFOCIP, në maj 2016 , mësohet se si është implementuar ligji 119/2014 për të drejtën e informimit në nivel të qeverisjes vendore, rezulton se vetëm 28% nga 61 bashki në vend e "kalonin klasën", ndërsa të tjerat janë "ngelëse" në këtë drejtim.

Në raport theksohej se Bashkia Bulqizë nuk kishte një faqe interneti funksionale, ku qytetarët të mund të aksesonin vendimet e Këshillit Bashkiak apo të informoheshin për punën e Bashkisë, duke u vlerësuar me 2 pikë nga 10. Bashki Bulqizë mund të ketë një faqe interneti aktualisht, por që prej më shumë se një viti nuk është bërë asnjë postim dhe ka një mungesë të plotë të transparencës lidhur me punën e saj. Bashkia Dibër u vlerësua me 4 pikë nga 10 për transparencën e saj dhe implementimin e ligjit 119/2014 për të drejtën e informimit. Ndërsa bashkia Mat kishte performancën më të mirë në këtë drejtim, duke u vlerësuar me 7 pikë nga 10, krahasuar me tre bashkitë e tjera të qarkut Dibër.

© *portavendore.al, Korrik 2018*

Lidhjen origjinale të shkrimit mund ta gjeni në: https://portavendore.al/2018/07/27/bashkite-e-qarkut-te-dibres-jo-transparente-ne-publikimin-e-vendimeve-te-keshillit-bashkiak/

Rruga e Arbërit nr. 147

Në kuadrin e 70 vjetorit të krijimit të shkollës pedagogjike Peshkopi

kujtime

Nga **Besnik LAMI**
ish nxënës i kësaj shkolle

Shkolla pedagogjike Peshkopi, një nga shkollat më të mira të Republikës

Në shtator të këtij viti do të festohet 70 vjetori i hapjes së shkollës pedagogjike të Peshkopisë, sot gjimnazi ''Said Najdeni''. Për këtë jubile të rëndësishëm arsimor e kulturor është ngritur një komision i posaçëm i kryesuar nga ish drejtori i kësaj shkolle e ish nxënës i saj shoku Shemsi Manjani dhe zv/kryetar z. Hilmi Cami. Puna përgatitore dhe kontaktet me ish nxënësit e saj, kuadro të arsimit e të kulturës, sot shumica në pension, ka filluar që 2-3 muaj. Është hartuar dhe një program pune i detajuar.

Në kuadrin e këtij eventi të rëndësishëm kulturor, edhe unë si ish nxënës i kësaj shkolle desha të paraqes në këtë shkrim disa mbresa e kujtime personale nga jeta në këtë shkollë, që na përgatiti për jetën, na bëri kuadro e edukatorë të brezit të ri. Dihet se Shqipëria doli nga Lufta e Dytë Botërore e shkatërruar dhe e prapambetur në të gjitha fushat. Nga statistikat e vitit 1938, kur sundonte mbreti Zog, dihet se 90 % e popullit tonë ishte analfabet, ndonëse Shqipëria atëherë kishte rreth 1 milion banorë. Dihen rrethanat historike-shoqërore të vendit tonë në këtë drejtim që nisin që nga sundimi pesëshekullor turk. Në këtë gjendje të prapambetur doli Shqipëria nga Lufta NCL. Kur vendet e Europës si Italia, Franca, Gjermania, Zvicra, Çekia etj., kishin ngritur universitetet e tyre që në shek.XIII apo të XIV, Shqipëria jo që s'kishte universitet e shkolla të tjera të larta, por dhe shkollat e mesme të hapura në qytet kryesore të vendit numëroheshin me gishtat e dorës. Për të përmbysur këtë gjendje të mjeruar të vendit e të popullit, qeverisë popullore, e dalë nga Lufta NÇL i dilnin detyra të shumta e të vështira, sepse s'mund të ecej përpara kur analfabetizmi mbretëronte në 90% të popullatës. S'mund të ecej përpara me një popullsi analfabete. Qeveria e re demokratike i shpalli luftë analfabetizmit. Për këtë, që me 1945 u hapën në çdo rreth, krahinë e fshat të vendit kurse kundër analfabetizmit, ku shkonin djem e vajza, burra e gra të moshës deri në 40 vjeç të mësonin shkrim e këndim, madje këto kurse funksionuan që në vitet e luftës çlirimtare, ku partizanët tanë heroik krahas luftës kundër pushtuesve fashistë bënin në kohë të lirë, në brigada e batalione dhe kurse kundër analfabetizmit. Krahas luftës kundër analfabetizmit që bënte Partia e pushteti popullor në atë kohë e që zgjati rreth 10 vjet, deri më 1955, qeveria hapi shkolla fillore në çdo fshat të Shqipërisë ku s'kishte shkolla dhe bëri arsimin fillor të detyrueshëm për të gjithë brezin e ri dhe vite më vonë bëri të detyrueshëm për të gjithë shtetasit tanë dhe arsimin 8-vjeçar.

Natyrisht, kuadrot që drejtonin luftën kundër analfabetizmit s'kishin ndonjë arsim kushedi çfarë, po kështu dhe mësuesit e viteve të para të çlirimit. Shumica e drejtuesve të këtyre kurseve si dhe e mësuesve të shkollës fillore ishin me arsim fillor e 7-vjeçar, të trajnuar në kurse të shkurtra kualifikimi në rrethe apo në Tiranë. Shqipëria në këto vite të para të çlirimit kishte etje për dituri e kulturë, kishte në radhë të parë për kuadro jo vetëm në fushën e ekonomisë e të ushtrisë, por në radhë të parë në fushën e arsimit. Kjo qe arsyeja që pushteti popullor i asaj kohe hapi dhe shumë shkolla të mesme dhe Institute të larta ku përgatiteshin mësues, infermierë, mjekë, ushtarakë, specialistë, agronomë, ekonomistë e inxhinierë. Në këto rrethana u hap për herë të parë në qytetin tonë verilindor shkolla e mesme pedagogjike në shtator të 1948 që përgatiti kuadrot e para për mësues jo vetëm për rrethin e Dibrës, por për gjithë zonën VL të Shqipërisë. Në këtë shkollë studionin jo vetëm djem e vajza nga krahinat e ndryshme të Dibrës, por dhe



nxënës nga rrethi i Matit, i Kukësit, i Pukës dhe i Tropojës. Shumica e nxënësve që mësonin në këtë shkollë ishin konviktorë me bursë nga shteti dhe vetëm një pjesë e vogël dibranësh ishin nxënës të jashtëm.

Që para se të hapej shkolla, u ngrit ndërtesa katërkatëshe e shkollës pedagogjike në qendër të qytetit, me një arkitekturë të përsosur. Shkolla edhe sot e kësaj dite, edhe pse kanë kaluar 70 vjet, qëndron e fortë dhe e bukur, e shndërruar në gjimnaz. Kati i parë i shkollës shërbente për kuzhinë e mensë për konviktorët e dhoma pune. Kati i dytë e i tretë shërbeu për klasa mësimi, kurse kati i IV shërbente për dhoma fjetje. Ngjitur me shkollën në krah të majtë të saj u ngrit dhe shkolla ushtrimore, ku bënin praktikë mësimore mësuesit e rinj, si dhe palestra e shkollës, kurse oborri i madh nga prapa kishte të gjitha këndet sportive dhe fushe volejbolli e basketbolli.

Edhe sot e kësaj dite kjo shkollë e ngritur në qendër të qytetit është krenaria e tij me gjithë historinë e kësaj shkolle. Sa herë kalojmë në bulevardin ''Elez Isufi'', ne shikojmë shkollën pedagogjike me nostalgji e krenari, sepse kjo shkollë na bëri kuadro e na përgatiti për jetën, na dha dritë e dituri.

Nga dyert e kësaj shkolle kanë dalë rreth 2200 kuadro, djem e vajza, që çuan dritën e kulturën në gjithë krahinat e fshatrat e zonës verilindore të Shqipërisë. Nga dyert e kësaj shkolle dolën dhe kuadro të Partisë e të pushtetit popullor, dolën gjuhëtarë e profesorë, poetë e shkrimtarë, artistë, diplomatë e gazetarë të ardhshëm që kontribuan me punë e dituri në zhvillimin e vendit si: Xhelil Gjoni, Zenel Sula, Shemsi e Lutfi Manjani, Nuri e Femi Abdiu, Avni Fida, Abdi Baleta, Hajri Shehu, Xhezair e Hamza Abazi, Bashkim e Veli Rama, Abaz Disha, Tefta Cami, Zymbile Zeneli, Xhafer Martini, Naim Plaku, Besim e Suria Stafa e të tjerë e të tjerë.

Shkolla pedagogjike "8 Nentori" Peshkopi u hap në shtator të 1948 dhe u mbyll në korrik të 1967, për t'u rihapur më vonë në vitet '70 të shek. të kaluar e më pas prapë u mbyll dhe prapë u rihap. Unë dhe moshatarët e mi dibranë, matjanë apo kuksianë i përkasim brezit të fundit të kësaj shkolle. E filluam vitin e parë të shkollës së mesme në shtator të 1963 dhe e përfunduam në korrik të 1967, ku u diplomuam për mësues të CU. Hyrja si nxënës në shkollën pedagogjike ishte për mua një gëzim i madh. Atëherë s'isha veçse 14 vjeç. Sapo kisha mbaruar shkollën 7-vjeçare "Demir Gashi". Fillova shkollën pedagogjike me gëzim e entuziazëm. Ajo do të na zgjeronte horizontin kulturor e shkencor e do na përgatiste për mësues. Shkolla ishte e bukur dhe e mirë me të gjithë hapësirat e nevojshme e mbi të gjitha me një staf pedagogjik të përgatitur. Në vitin e parë të pedagogjikes kishim drejtor të famshmin Zenel Sula. Ai në vitin e pare na jepte letërsi. Kishte mbaruar arsimin e lartë në Moskë. Kur na fliste për Tolstoin e madh e shkrimtarë të tjerë të mëdhenj, ne mbeteshim gojëhapur e vetëm dëgjonim të mahnitur. Vitin e dytë patëm drejtor shkolle z.Sami Ferizi nga Kukësi. Ne vitin e trete patëm drejtor shkolle z. Shemsi Manjani, i cili na jepte lëndën e rusishtes. Një vit më pas prof. Shema u bë shef i Arsimit në rreth dhe drejtor shkolle na erdhi pedagogu e oratori Mislim Koka. Sjell në kujtesë të gjithë mësuesit e shkollës pedagogjike, secili më i mirë se tjetri, të përgatitur, eruditë e me takt të admirueshëm pedagogjik. Kë të kujtoj: Profesor Saimir Hoxhën nga Gjirokastra, që rrinte gjithmonë i veshur ekstra e kravatë e në orën e mësimit me bluzë të bardhë, se na jepte kimi, Kadri Zhulalin - i qetë e i përpiktë, që na jepte matematikë e gjeometri, Mufit Trepçen, Osman Turren e Lutfi Hankun që na jepnin gjuhë e letërsi apo zonjush Nevrezin, që na jepte lëndën e gjeografisë. Nevrezi ishte mësuese e re. E ardhur nga Elbasani, e martuar në Dibër, por dukej si një dibrane e vërtete. Ishte gjithë energji e dinamizëm. Lëndën e re na e shpjegonte me pasion. Në orët e lira ose në pushim të gjatë znj.Nevrezi ulej e bisedonte lirshëm me nxënësit e klasës në kujdestari. I konsideronte ata si motra e vëllezër më të vegjël.

Kujtoj Durmish Shehun, mësuesin babaxhan të biologjisë, Lavdrim Kabën, mësuesin strikt e korrekt të historisë, Bajram Matën, mësuesin piktor të vizatimit, Esat Sadikun, mësuesin e edukimit fizik apo mjeshtrin Munir Shehu, që na jepte muzikën. Atëherë kishte rregull e disiplinë në shkollat tona. S'kishte celularë e kompjutera si sot. Vëmendja e nxënësve përqendrohej vetëm mbi mësimet e ditës. Burimi kryesor i diturisë ishin librat. Përveç mësimit bëheshin dhe aktivitete kulturore-artistike si dhe sportive të programuara nga drejtoria e shkollës për çdo muaj, mbrëmje tematike-dëfrimi si për festat e 28 e 29 Nëntorit, për Vitin e Ri etj. Kujtoj xha Veselin që i binte ziles sa herë që fillonte apo mbaronte ora e mësimit.

Aspekt të veçantë të jetës në shkollë ishte dhe praktika pedagogjike që ne nxënësit e shkollës e bënim në shkollën ushtrimore ngjitur. Kjo praktikë pedagogjike fillonte në vitin e tretë e të katërt të pedagogjikes. Në shkollën ushtrimore punonin mësues të zgjedhur e të kualifikuar, me përvojë të mirë pedagogjike si Jolanda Rada, Hava Shehu, Sanie Zeneli e Remzi Prapaniku.

Një dite vjeshte të vitit 1966 tre klasat paralele të maturës i dërguan në spitalin e qytetit për të dhuruar gjak sipas grupit. Nuk ishin pak, por 120 maturantë. Nga 120 maturantë që dhuruan gjak, vetëm mua e Idajete Qoses (Daci) na ra të fiket, sa na morën 50 gram gjak. Nuk na ra të fikët se ishim të dobët fizikisht, por se ishim të ndjeshëm. U ndërpre dhurimi i gjakut dhe kuzhinier Ejupi nxitoi të na jepte diçka për të ngrënë, por në atë gjendje që u bëmë ne, të zverdhur si limoni, s'mund të hanim asgjë. Na shtrinë në krevat, na vunë serum, pushuam dhe pastaj shkuam në shtëpi.

Në shkurt-mars të 1967 kur ne ishim maturantë, tri klasat paralele të maturës, na çuan në Lushnje, në aksion për ndërtimin e hekurudhës Rrogozhinë - Fier. Ne ishim në turnin e parë të aksionit. Përveç nesh kishte dhe nxënës e të rinj nga rrethe të tjera të vendit. Ne aksionistët e Dibrës na përqendruan në sektorin e Gradishtës-Lushnje. Të gjithë ne maturantët kishim hyrë në moshën e 18 vjetëve. Ishim gjithë energji e forcë. Vajtja në aksionin e rinisë ishte udhëtimi ynë i parë jashtë rrethit. Kur udhëtonim rrugës me autobus që nga Peshkopia në Lushnje, shikonim me kërshëri luginat, malet, lumenjtë, fshatrat e qytetet që na dilnin përpara si Burrelin, Laçin, Durrësin, Kavajën, Rrogozhinën, etj. Pamë fushën e pamatë të Myzeqesë. Pasi u sistemuam në kapanonet e ngritura apostafat nga qeveria për të rinjtë aksionistë, me 3 shkurt 1967 u bë inaugurimi i fillimit të punimeve të hekurudhës së rë.

Edhe aksioni na mësoi shumë gjëra. Na mësoi si ta duam punën, si të punojmë me energji e disiplinë për të realizuar detyrën. Na mësoi e na kaliti me vështirësitë e punës dhe me thellimin e erës së detit në mëngjes që të priste në fytyrë si me brisk. Edhe në aksion punonim me turne. Mbaj mend që atëherë se edhe unë me shokë kam punuar 6-7 net në turnin e natës. Hapeshin themelet e këmbëve të një ure të rëndësishme. Unë me shokë nxirrnim ujë me kova nga këmba e urës dhe e hidhnim jashtë, pasi aty do të shtriheshin hekurat e do të hidhej beton. Atëherë s'kishte mjete mekanike si sot, pompa, betonuese etj., dhe shumë procese pune bëheshin me krahë. Nga fundi i shkurtit 1967, duke punuar në trase e shtypur dheun me tokmak apo mbartur dhé me karrocë, mua dhe një shokun tim të klasës, i quajtur Gjon Zefi, na kapi gripi nga thellimi i erës së detit. Të nesërmen nuk shkuam në punë se ishim të sëmurë dhe e bëmë pushim pranë kapanonit. Për fat atë ditë shkurti kalon në sektor një fotograf lushnjar. Unë dhe Gjoni dolëm në fotografi për kujtim të ditëve në aksion. E ruaj këtë fotografi me Gjonin që 50 vjet, si kujtim të atyre viteve të bukura të rinisë, por Gjonin e ri e simpatik, të cilin po ta shoh tani, nuk mund ta njoh, se s'jam takuar që 50 vjet e nuk e di fatin e tij se ku banon e jeton.

Ruaj kujtime të pashlyeshme nga aksioni në hekurudhën Rrogozhinë-Fier.

Theksoj se kam qenë nxënës i jashtëm, se po të isha konviktor, do të ruaja më tepër kujtime e mbresa. Atëherë ishim të rinj dhe nuk mbanim dhe ditar.

Lavdi shkollës pedagogjike Peshkopi!

Me 8.07.2018



Fruti i rrallë medicinal

Në Maqellarë të Dibrës, fermeri Zija Keshi nga viti në vit por zgjeron me sukses parcelat e tij me këtë frut të çmuar. Foto: Flickr

Pse **të gjithë** kërkojnë **aronian** e Dibrës?

Një frut i rrallë medicinal po kultivohet në Shqipëri, vlerat e të cilit janë të jashtëzakonshme për kurimin e shumë sëmundjeve dhe problemeve shëndetësore.

Bëhet fjalë për Aronian.

Një frut ngjyrë vjollcë, i vogël, por shumë i fuqishëm. Kjo kokërr e vogël ka një shije të veçantë që të rrudh qiellzën dhe që të kujton thartësinë e rrushit të verës.

Në Maqellarë të Dibrës, fermeri Zija Keshi nga viti në vit por zgjeron me sukses parcelat e tij me këtë frut të çmuar si për shijen e veçantë ashtu edhe për vetitë shëruese.

Ai thotë për AgroWeb.org se tri vite më parë ai testoi kultivimin e këtij fruti në një parcelë eksperimentale dhe pasi u bind se kushtet për kultivimin e saj ishin optimale atëherë vendosi të niste kultivimin masiv të saj.

"Aktualisht kam mbjellë rreth 6500 metra katrorë sipërfaqe toke me bimën e Aronias. Ky është viti i dytë i prodhimit dhe perspektiva është shumë e mirë.

Jam duke u kujdesur personalisht për çdo bimë të Aronias që kam mbjellë.

Synimi është që prodhimi të jetë tërësisht bio ndaj dhe frutat e Arionas në parcelën tonë po rriten përmes plehut organik dhe ujit dhe asgjë tjetër. Ndihem shumë mirë kur e them këtë fakt" shprehet Zijai për AgroWeb.org.

Megjithë mundimin në vitin e parë, mbjelljen dhe kujdesin e vazhdueshëm, Zija Keshi thotë për AgroWeb.org se i gjithë përkushtimi i tij u shpërblye kur sa "hap e mbyll sytë" sipas tij, brenda kohës më të shkurtër që mund të imagjinonte të gjitha frutat e Arionas u shitën.

Përse të gjithë kërkojnë Aronian

Duke qenë se është ndër të paktët fermerë në Shqipëri që kultivojnë këtë frut të jashtëzakonshëm, Zijai është shndërrruar në pikën kryesore ku të gjithë drejtohen për të blerë Aronian e shumëkërkuar.

"Nga Kepi i Rodonit, Tirana, Durrësi, Jugu i Shqipërisë dhe Veriu, qytetarë nga i gjithë vendi kanë ardhur në fermën tonë ku kanë kërkuar të blejnë Aronia. Vitin e kaluar, brenda 1 muaji e gjysmë arrita të shisja 350 kilogramë.

Kjo më dha shpresë që këtë vit të rrija edhe më shumë plantacionet dhe prodhimin gjithashtu.

Këtë vit pres të marrë si prodhim rreth 2.5 ton aronia të njomë.

Këtë vit pres që ta shes edhe më shpejt të gjithë prodhimin sepse porositë kanë nisur me kohë dhe sa vijnë dhe shtohen" shprehet Zijai.

Ai tregon se të gjithë të interesuarit e blejnë për vlerat kurative që fruti i Aronias ka duke nisur nga sëmundjet e zemrës, tensionit të lartë, diabetit etj.

Vlerat e jashtëzakonshme medicinale

Në fakt, sipas të gjitha të dhënave të AgroWeb.org kokrrat e Aronias kanë burimin më të lartë të antioksidantëve të pranishëm në një frut.

Ato përmirësojnë qarkullimin e gjakut, duke i bërë enët e gjakut më të forta dhe duke zvogëluar rreziqet që vijnë nga sëmundjet e zemrës.

Kokrrat e Aronias mbajnë tensionin e gjakut në nivele normale.

Lëngu ose çaji i Anorias rekomandohet për njerëzit që kanë problem me tensionin e gjakut dhe qarkullimin e tij.

Aronia është studiuar në lidhje me rolin e tyre në parandalimin e sëmundjes së diabetit.

Një prej studimeve arriti në konkluzionin që konsumimi i këtij fruti nuk rrit nivelin e sheqerit në gjak, madje e ul atë.

Ky frut përbën një kurë fantastike jo vetëm për problemet me stomakun, por edhe ato të veshkave.

Janë të gjitha këto vlera që e shndërrojnë Aronian në një super frut medicinal i cili për nga efektet e fuqishme kurative sigurisht nuk ka të paguar./**AgroWeb.org**

printime dixhitale

DUKE FILLUAR NGA 1 KOPJE E VETME

shpejtësi | cilësi | çmime të favorshme
libra | broshura | revista | fletëpalosje
katalogë | kalendarë | postera | ftesa etj.

për informacion: mbbotime@gmail.com / Cel. 069 20 68 603

Rruga e Arbërit nr. 147

Dali Horeshka ka punuar pothuajse vetëm me të huaj, me shoqata e fondacione të ndryshme. Në mbarim të kontratave, ata jo vetëm që nuk janë zhgënjyer, por do të kishin dashur që të kishin punuar më gjatë akoma.

profil

Dali Horeshka, miku i madh i fermerëve të Dibrës

Nga **Osman XHILI**

Ishte një shkurt i vitit 2014. Pa shumë bujë e zhurmë, në qendër të qarkut në Peshkopi u hap zyra e Fondacionit "Sared", për të ndihmuar fermat dhe fermerët dibranë. Dibra ishte përzgjedhur si një nga gjashtë qarqet që do të përfitonte ndihmën dhe bujarinë e donatorëve. Ishte një kooperim i frytshëm nga tre aktorë: qeveria daneze, qeveria gjermane dhe ajo shqiptare. E para do të ishte financuese e projektit, e dyta do ta drejtonte atë, kurse qeveria shqiptare ishte mbështetëse e projektit në fjalë. Duhej një koordinator për zyrën, një njeri i përgjegjshëm, një njeri i ditur, një njeri që do të merrte përsipër barrë të rënda mbi shpinë. Mes shumë konkurrentëve të tjerë ishte dhe ekonomisti me përvojë Dali Horeshka. Nuk di pse, ne të tjerët, që e ndiqnim nga afër "lojën", besuam dhe shpresuam që ai do të ishte fituesi.

Ashtu ndodhi. Zyra qendrore në Tiranë e programit "Sared" konfirmoi fitues Daliun, shokun, kolegun dhe bashkëpunëtorin tonë të palodhur. Ata që nuk e njihnin, ndoshta dhe u stepën në fillim, kur krahasuan pamjen me imagjinatën. Ndoshta kishin menduar një njeri të gjatë e të fuqishëm, kurse miku ynë nuk ishte fort i tillë. Në fakt, ai kishte shumë fuqi, por ato i kishte diku tjetër, i kishte në mendje dhe në shpirt.

Daliu mbaroi shkollën e mesme për agronomi në shkollën e Kastriotit me rezultate shumë të mira. Mund t'i vazhdonte fare mirë studimet e larta për këtë degë, por në fakt e ndryshoi paksa kursin. Do ta ndihmonte sërish bujqësinë e Dibrës, por në një mënyrë tjetër, me lapsin e tij, me planifikimin sa më mirë të gjërave që duheshin bërë. Ishte fillimi i viteve tetëdhjetë. Unë isha në vitin e dytë të shkollës së lartë, Daliu filloi vitin e parë të studimeve. I urtë, i qetë, studiues tipik, që kishte ardhur jo thjeshtë për të mbaruar shkollën, por për të fituar sa më shumë njohuri, që aq shumë do t'i duheshin në jetë. Disa fakultete kishin rusishten si gjuhë të huaj. Ndërsa shumë studentë përpiqeshin thjeshtë ta merrnin provimin e rusishtes, Daliu donte të shkonte shumë më larg, të miqësohej me këtë gjuhë, ta mbronte, siç thuhet, pse jo dhe ta fliste.

Kështu, pra, me punë, me ambicie, mes sfidave të shkollës, të punës dhe të jetës, Daliu i mbylli studimet me rezultate shumë të mira dhe u kthye në Dibër. Fushë Çidhna u bë stacioni i tij i parë i punësimit. Për gati katër pesë vite ai i provoi kooperativat e dikurshme, për ta parë atë sistem me të këqijat, por pse jo dhe me disa të mira, që duheshin marrë si gurë me vlerë, për t'i vendosur në themelet e demokracisë së brishtë shqiptare. Ai bisedoi me njerëzit e varfër të para nëntëdhjetës, me njerëzit punëtorë dhe



Dali Horeshka në zyrën e tij të punës.

bujarë. E kuptonte që kjo situatë nuk mund të vazhdonte gjatë, jo në pafundësi. Ashtu nisi kthesa e madhe, me arrëza e tufëza, si një falje e madhe për gabimet e bëra, me kthimin e pronës tek pronari i vërtetë.

Për shumë e shumë vite Daliu u end në kërkim të punësimit, në kërkim të dijeve të reja, në formim të identitetit të tij. Katër vite punoi te agjencia e privatizimeve. Po të kishte qenë dikush tjetër, ndoshta do ta shihte veten të ndryshuar ekonomikisht si në përralla. Dikush tjetër, ama, por jo Daliu. Edukata familjare i kishte mësuar atij të merrte vetëm ato gjëra që realisht i takonin dhe jo më shumë. Katër vite të tjera punoi te statistika dhe gati po kaq te bashkia. Të gjitha këto vite në total i shërbyen atij për të pasur dije mbi shumë gjëra, që aq shumë do t'i duheshin më vonë.

Në Shqipëri filluan të vijnë fondacione të huaja. Ata donin bashkëpunëtorë seriozë, të ndershëm, profesionistë dhe të aftë për të punuar në grup. Daliu i plotësonte më së miri këto kërkesa, por vetëm në një pikë kishte problem. Ah, sa do të kishte dashur që në vend të rusishtes, që e kishte mbrojtur, të kishte qenë anglishtja. Tani do të ishte duke folur rehat e komod, me këto të huajt e perëndimit. Kur u qetësua ajo dallga e parë e pendimit, në shpirtin e tij nisi një fazë reflektimi e reagimi. Ishte kapërcyelli i mijëvjeçarit të dytë dhe ai nuk ishte më shumë se dyzetë vjeç. Do të bënte me anglishten, as më pak e as më shumë, se ato gjëra që kishte bërë me rusishten. E thënë shkurt, do të fillonte nga e para dhe do ta mësonte. U habitën kolegët e huaj kur panë ndryshimin drastik, kur Daliu filloi të përgatiste në anglisht materialet e para. Kaq kishte dashur njeriu fjalëpakë e punëshumë, sa të fillonte. Më pas, gjërat do të merrnin rrokullimën, si një ortek, në sensin pozitiv, për të shkruar, folur e diskutuar në këtë gjuhë, me të cilën nuk kishte pasur më parë asnjë lloj kontakti. Që atëherë Daliu ka punuar pothuaj vetëm me të huaj, me shoqata e fondacione të ndryshme. Në mbarim të kontratave ata jo vetëm që nuk janë zhgënjyer, por do të kishin dashur që të kishin punuar më gjatë akoma.

KATËR VITE MË PARË

Katër vite më parë, siç e përmendëm në fillim, startoi programi "Sared", në Shqipëri, por dhe në Dibër. Ishin disa miliona euro që do të kalonin në xhepat e fermerëve shqiptarë, të materializuara në mjete pune, në traktorë, pajisje të tyre, restaurim bujtinash për turistë apo si krijim blloqesh me pemë frutore, me të gjitha parametrat e kohës. Daliu për një moment u tremb. Jo, në fakt, nuk kishte qenë frikë, por një emocion, për peshën morale që duhej të mbante në supe. Nuk ishin gjëra të thjeshta, por bile shumë të komplikuara.

Gjatë gjithë kohës ai punoi ngushtë me shërbimin këshillimor të qarkut Dibër, madje një nga specialistët më të mirë të këtij stafi, Haxhi Abazin, e mori në zyrë për gjatë gjithë kohës, si bashkëpunëtor dhe konsulent për çështjet e bujqësisë. U bënë takimet e para në Tiranë, Shkodër, Korçë, Dibër, Kukës e rrethe të tjera të vendit. Drejtuesi i përgjithshëm, danezi Ole, gjermani Bertold dhe doktori shqiptar Rolandi, dhanë gjithçka dinin nga mendja dhe përvoja e tyre, që gjërat të ishin sa më të thjeshta e të qarta për t'i zbatuar. Daliu mendoi se takime të tilla të ngjashme duheshin bërë dhe në territorin e qarkut që mbulonte. Kështu, nisën seminare të thjeshta me specialistë e fermerë potencialë. Problemi ishte që kërkesat e programit dhe nevojat e fermerëve duhej të konvergonin në një pikë, përndryshe asgjë nuk quhej e realizuar. Ndihmesë të madhe dhanë miqtë dhe partnerët tanë, që u angazhuan në përgatitjen e projekteve serioze, për të qenë sa më cilësore dhe për t'u shpallur fitues. Çlirim Leshi, ekonomisti i zyrës së "USAID-it", Zaim Rina, specialist me shumë vlera i frutikulturës, Zenulla Mehmeti, inxhinier, autor i shumë projekteve, ishin disa nga këta njerëz, që u bënë si një urë lidhëse mes programit "Sared" dhe fermerëve, në mënyrë që këta të fundit të ishin maksimalisht fitues. Erdhën në jetë projektet e parë fitues, të tjerë e të tjerë më pas. Po t'u referohemi shifrave, do të thoshim se numri i tyre arriti në gjashtëdhjetë, ku gati 80 për qind e tyre u shpallën fitues. Vetëm nga komuna e Maqellarës u përfituan dhjetë traktorë, ku shumica patën dhe agregate shtesë, si makina mbjellëse, pompa spërkatëse, rimorkio e plot të tjera si këto. Medin Kryemadhi, Premtim Agolli, Bardhul Muça, Qamil Lata, Berti Mullameti e plot të tjerë do të jenë shumë mirënjohës ndaj programit "Sared" dhe gjithë bashkëpunëtorëve, që materializuan dhe i bënë realitet dëshirat e tyre.

Projektet e fermerëve tanë u shtrinë dhe në fusha të tjera si turizmi dhe blloqet e reja me pemë frutore. Sabri Shahini nga Rabdishti është përfaqësues tipik i biznesmenit të ri, që dëshiron të investojë në fushën e turizmit. Fshati i tij Rabdishti është shpallur në listën e njëqind fshatrave turistikë dhe Sabriu e ka kthyer shtëpinë e tij në një bujtinë, shumë të dashur e të frekuentuar nga turistët. Po kështu, ka vepruar dhe është shpallur fituese zonja Adelina Salkurti nga Rashnapoja.

Arsen Tifeku, nga njësia administrative e Melanit, dëshironte që bllokut të tij të mollëve dhe qershive tradicionale, t'u shtojë dhe një hektar me qershi, me sistem mbështetës dhe me vaditje me pika. Në këtë projekt kurajoz prej gati tridhjetë mijë eurosh, i erdhi në ndihmë programi "Sared", duke i dhënë 65 për qind të kësaj shume, në formë grandi.

E përkthyer në vlerë, shuma e projekteve përfitues do të ishte rreth 800 mijë euro ose një miliardë lekë, të përfituar nga fermerët e qarkut të Dibrës. Kujtojmë këto shifra dhe këto rezultate të arritura dhe mendja na shkon te Dali Oreshka, njeriu që aq shumë u përpoq për t'i realizuar këto gjëra, duke mbetur një mik i madh i fermerëve dhe i njerëzve të punës.



Bilbil Zebi, fermer, një nga përfituesit e Programit "Sared".



Shtëpia e Sabri Shahinit, e kthyer në bujtinë. Përfitues i Programit "Sared".

cyan magenta yellow black


libër i ri

Qëllimi i përmbledhjes së këtyre studimeve në këtë botim përfshin dhe interesat e një leximi të gjerë intelektual, për çdokënd që interesohet për njohjen elitare të letërsisë së shekullit XX-XXI, për autorët e saj më vendimtarë...

BOTIME M&B

Rr. "Isa Boletini", Nd.2, H.12, Nj.A.9, 1017, Tiranë
+355 4 2233283
+355 69 20 68 603 +355 68 65 08 441
mbbotime@gmail.com www.mbbotime.com.
M&B - Botime dhe Studio Grafike MBBotime

www.facebook.com/
M&B - Botime dhe Studio Grafike
Për porosi: botimemb@gmail.com
Cel: 069 20 68 603
www.mbbotime.com
I gjeni te libraria M&B *(te Selvia),*
Adrion *(te Pallati i Kulturës)*
Libraria Fleta XXI *(Peshkopi)*



Parafjalë për botimin

Monografia "Letërsia dhe procesi letrar në shekullin XX" synon të përmbushë një njohje sa më përfaqësuese të peizazhit europian e më gjerë në kulturat letrare përgjatë shekullit XX. Në këtë vëllim (sikundër dhe në dy vëllimet e tjera të ardhshme) kemi parashtruar një variant sa më efikas të procesit dhe rrjedhave letrare të shekullit, duke u orientuar nga kriteri i kanonit dhe kodit të traditave letrare, të cilat kanë përcaktuar specifikën e vetëdijes letrare të epokave, të shkrimtarëve dhe të lexuesve, midis normës dhe tabuve në krijimin dhe receptimin e letërsisë.

Evolucioni letrar është një dukuri që reflekton formacionet mbizotëruese të gjendjes shpirtërore të njeriut, vetëdijes dhe ndjeshmërisë së tij në etapa të caktuara të vendit dhe kontekstit ku realizohet një letërsi e dhënë. Madje, në varësi të këtij konteksti (kulturor, historik, psikologjik apo ideologjik), letërsia përpunon mjetet shprehëse duke provokuar formacione të reja stilistike në paraqitjen sa më të gjerë në tektonikën shpirtërore e psikologjike të njeriut.

Raporti i shkrimtarit përballë përvojave artistike pararendëse karakterizohet nga pranimi ose refuzimi i tyre, nga eksperimentimi apo nga velja përgjatë marrëdhënieve me to dhe, në fakt, parë në një plan më të gjerë, raporti i shkrimtarit me traditën dhe përvojën, nën dritën e shpikjeve dhe të zbulimeve, shpie te pranimi, refuzimi apo dhe verifikimi i autoritetit, i peshës që kërkon të homogjenizojë strukturën njerëzore të mendimit, ndjeshmërisë dhe estetikës. Periudhat e entuziazmit dhe të dëshpërimit nga revolucionet, luftërat, ideologjitë, progresi teknologjik dhe mitet e shkencës, kanë sjellë gjithëherë nevojën për një ëndërrim të ri, për utopi të reja, për rezistencë ndaj bjerrjes së cilësive shpirtërore të njeriut dhe njerëzimit në një botë që ndryshon vazhdimisht orientimin, sistemin e vlerave, etikën dhe idealin e saj estetik. Prandaj dhe letërsia e krijuar përgjatë shekullit XX është në metamorfozë të përhershme, herë duke mbrojtur vlerat estetike, humaniste e tradicionale e herë duke i sulmuar ashpër ato me një patos të pakompromis, në të mirë të zbulimit të mjeteve të reja shprehëse. Në këtë libër kam synuar të përkap letërsinë mes një bote në ndryshim të vazhdueshëm, si dhe të paraqes disa nga tiparet thelbësore të ligjeve universale, që e udhëheqin krijuesin gjatë krijimit të modeleve midis shqetësimit të tij si pjesëmarrës në përvojat kolektive dhe raportit të thellë të përvojës së brendshme individuale dhe metafizike. Paradigmat artistike e letrare të shekullit XX janë parë paralel me formacionet botëkuptimore intelektuale të këtij shekulli, të cilat janë ngjizur në këtë shekull përmes utopish, dilemash e katastrofash kombëtare e ndërkombëtare.

Të paraqesësh letërsinë e shekullit XX sipas një koncepti të përfunduar është punë e pamundur, madje, në thelb, e dyshimtë. Parimet kronologjike, historike apo sociologjike, përveçse nuk e sqarojnë thelbin e procesit, e bëjnë konfuze dhe vulgare një ndërmarrje të tillë. Në librin tonë këtyre aspekteve historiko-sociologjike u kemi lënë një hapësirë "koprace", por të ndershme, sa për të sqaruar koordinatën e kohës dhe sfondin psiko-social kur zhvillohet personaliteti i shkrimtarit.

Parimisht për mua ka qenë shumë i rëndësishëm formacioni stilistik dhe fizionomia estetike e shkrimtarëve që imponojnë me risitë e tyre një rend të ri vlerash letrare. Letërsia e shekullit XX është një oqean i paskajtë, në të cilin mund ta humbasësh shpejt busullën e orientimit. Prandaj dhe parimi i reprezantimit të peizazhit letrar që kam ndjekur në këtë libër ka synuar të zhdavarisë konfuzionin e pashmangshëm, duke bashkërenduar disa kritere, ndër të cilët, më të rëndësishëm më duken:

Kriteri i evolucionit/revolucionit të paradigmave artistiko-estetike: modernizmi, avangarda, postmodernizmi, kultura masive. Kriteri i risisë dhe eksperimentit me shqyrtime teorike të manifesteve, traktateve dhe doktrinave që proklamojnë shkolla e variante të ndryshme moderniste e postmoderniste.

Ilustrimi i platformave teoriko-estetike në krijimtarinë e përfaqësuesve tipikë të shkollave/rrymave të ndryshme letrare.

Veçoritë dhe specifikat e letërsive kombëtare, nisur nga logjika e brendshme kulturore e secilës prej tyre. Zgjedhja e disa linjave (përplotësuese) që përshkojnë letërsinë e shekullit XX-XXI, siç janë "trashëgimtarët e linjës realiste", "Erosi modernist", "Utopia/antiutopia në shekullin XX, "mitologjizmi dhe neomitologjizmi", "romani i ri/antiromani", "dimensioni i absurdit/absurdizmi" etj., çka lejon një vështrim shtesë, që rrok zhvillimet procesuale letrare, sidomos pas Luftës së Dytë Botërore.

Ky libër është nevojë e drejtpërdrejtë e mësimdhënies jo vetëm në auditoret e Fakultetit Filologjik të Universitetit të Tiranës. Ky botim paraqet ndryshime dhe përmirësime thelbësore, duke përditësuar dhe pasuruar disa krerë si nevojë e domosdoshme për disa autorë dhe koncepte, në dritën e studimeve të reja dhe përkthimeve të fundit në shqip të disa autorëve të rëndësishëm.

Megjithatë, qëllimi i përmbledhjes së këtyre studimeve në këtë botim përfshin dhe interesat e një leximi të gjerë intelektual, për çdokënd që interesohet për njohjen elitare të letërsisë së shekullit XX-XXI, për autorët e saj më vendimtarë në formimin e shijeve, stileve dhe estetikave të veçanta, si pjesë e domosdoshme e konstruktit estetik e filozofik të njeriut bashkëkohor.

Agron Tufa

LETËRSIA DHE PROCESI LETRAR NË SHEKULLIN XX
AGRON TUFA

Botimet M&B, 2018
ISBN 978-9928-256-16-4
Faqe 432 / Çmimi: 1500 lekë

Rruga e Arbërit nr. 147

Do të ishte në nderin dhe dinjitetin e Bashkisë së Peshkopisë, si dhe të miqve të autorit, përgatitja për botim dhe botimi i veprës së lënë në dorëshkrim "Dibra nga Monarkia në Demokraci", si një homazh mirënjohjeje për studiuesin Moisi Murra.

in memoriam

Fjalë malli për studiuesin **Moisi Murra**, një mik i vyer dhe i paharruar

Në mëngjesin e datës 18 korrik 2018, një telefonatë e hershme dhe e pazakontë, na detyronte ne, shokëve të tij, të udhëtonim drejt Peshkopisë. Nga Tirana dhe Dibra, nga Ballanca dhe Kojnara, nga Maqellara dhe gjithë Fusha e Shehrit, nga Reçi dhe Dardha, nga Çidhna dhe Kastrioti, nga Muhuri dhe Luznia, nga Qafë-Murra dhe Katër Grykët, nga Sllova dhe Kalaja, nga Gryka e Madhe dhe Gryka e Vogël, nga Zerqani dhe Bulqiza, nga Lura, Golloborda dhe Martaneshi, nga e gjithë Dibra. Por në se herët e tjera udhëtonim me dëshirë drejt Peshkopisë, këtë herë vinim kokëulur, me sy të skuqur e të përlotur. Shoferi i furgonit ishte nga një familje e fisme e Malësisë së Dibrës së Poshtme. Sapo mësoi arsyen e atij udhëtimi, asnjë fjalë tjetër nuk ishte më e nevojshme dhe si rrallë herë, udhëtuam pa atë pushimin e detyruar të Klosit dhe pa ato kasetofonët e bezdisur të furgonëve.

Ajo telefonatë e hershme dhe e pazakontë e Astrit Murrës, nipit të Moisi Murrës, na i preu shpresat që ende ushqenim për shërimin e një kolegu dhe miku të hershëm dhe të vyer. Njeriu që në 35 vitet e fundit ishte shquar si studiues i zellshëm dhe energjik i historisë së vendit të të parëve, njeriu që ishte identifikuar me Dibrën dhe historinë e saj, për të cilën shkroi me shumë dashuri, njeriu që njihte çdo skutë të Bibliotekës dhe çdo pëllëmbë të Dibrës në të dy anët e kufirit, njeriu që me veprën e tij kishte bërë krenar qindra e mijëra dibranë, këtë radhë, nuk mund të na priste më! Pas një sëmundje shumë të rrallë dhe po aq të shpejtë, ishte shuar Moisi Murra. Prej më shumë se 35 vjetësh, Moisi Murra është përfshirë në radhën e studiuesve serioz të Historisë së Dibrës dhe të Shqipërisë dhe është padyshim një nga përfaqësuesit më të spikatur të studiueseve të kësaj fushe. Studiues i zellshëm i historisë në të dy Dibrat, kryetar i Lidhjes së Historianëve Dibranë, autor i një numri të madh studimesh, artikujsh shkencorë e monografishë, emri i tij ishte radhitur prej kohësh ndër emrat e rëndësishëm të historiografisë shqiptare.

Prind dhe bashkëshort model, bashkë me Xharin e tij të shtrenjtë, rritën dhe edukuan dy djem të mrekullueshëm dhe të kulturuar, si ata vetë, Eridin dhe Denin. Moisi e përjetoj me dhimbje të thellë humbjen e parakohshme të shoqes së tij të shtrenjtë të jetës, dashurisë së tij të madhe, mbështetëses më të fortë në të gjithë veprën studimore të Moisit, që mjerisht "e preu në besë" shumë herët shokun e saj të jetës (07.01.2016). Dhe të gjithë ata që e kanë njohur ose jo, sapo të hapin monografinë e fundit të Moisit mbi Dibrën, do të përshëndeten me portretin e qeshur dhe të dashur të saj, dhe me kushtimin prekës të autorit, që ka qenë i bekuar nga një dashuri e tillë, e fortë dhe e pashuar.

Me ndarjen nga jeta të Moisit, në këtë ditë të hidhur e të rëndë, familja humbi njeriun e dashur, Eridi dhe Deni babain e shtrenjtë, Dilaveri dhe Fehmiu vëllanë e vyer, farefisi njeriun e përkushtuar për të ndihmuar të gjithë, miqtë e shumtë, një mik të rrallë e shumë të vyer, kolegët, mikun e shokun e tyre të paharruar. Ikja kaq e shpejtë e Moisit është një humbje e madhe edhe për studimet historike në Dibër, që prisnin vepra të tjera të rëndësishme prej tij. Eridi dhe Deni, megjithatë, do të ndjehen shumë krenarë për babanë e tyre të shtrenjtë, për të gjithë kontributin e tij të çmuar për historinë dhe etno-kulturën e Dibrës.

Moisi Murra ka lënë një trashëgimi mjaft të pasur intelektuale, me mbi 2000 faqe kompjuterike. Autor i disa vëllimeve me studime si "Kreshniku i Dibrës" (me bashkëautorsi) (kushtuar gjeneralit me shajak Elez Isufi (Ndreu) (1996), monografitë kushtuar figurave të shquara patriotike të Dibrës si "Fiqiri Dine" (1997), "Cen Elezi" (1998), "Selim Rusi" (2000), "Salë Markja" (2002), "Mersim Dema" (2003), "Misim Ahmeti" (2004), "Musa Lala" (2004), "Aqif Lleshi" (2005), "Bilal Çela" (2006), "Një emër në univers" (2008) etj. Gjithashtu, një kontribut të çmuar përbën edhe guida turistike mbi Peshkopinë "Peshkopia-guidë turistike" (2010). Por vepra jetësore



Moisi Murra duke mbajtur fjalën e përshëndetjes, Tiranë 02.12. 2017

më e rëndësishme e tij do të mbetet monografia e fundit ***"Dibra nga Antikiteti në Monarki"*** (Tiranë 2017). Kur në dhjetorin e shkuar, u promovua në Tiranë, kjo monografi me vëllim prej 711 faqesh, askush nuk mund ta mendonte ikjen kaq të shpejtë të autorit nga kjo botë, madje as ai vetë, që në fjalën përshëndetëse, na premtoi se së shpejti, do të dilte nga shtypi, vëllimi i dytë i kësaj vepre, i titulluar ***"Dibra nga monarkia në demokraci".*** Por këtë herë, në të vetmen rast, ai nuk e mbajt dot fjalën e dhënë! Megjithatë, dibranët e Tiranës, të Grykës së Vogël dhe të gjithë Dibrës, e kishin mbushur plotë sallën e madhe të Muzeut, sikur t'a dinin se kjo do të ishte edhe dalja e fundit publike e studiuesit të mirënjohur Moisi Murra!

Që nga nëntori i vitit 1982, kur u zhvillua Konferenca shkencore mbi luftën e Dibrës kundër pushtimit serb (1912-1921) e deri në dhjetorin e vitit të shkuar (2017), për 35 vjet rresht, Moisi Murra ka qenë gjithnjë pjesëmarrës aktiv ose organizator i të gjitha veprimtarive shkencore të organizuara në rajonin e Dibrës (Peshkopi, Maqellarë, Shupenzë, Bulqizë, Zerqan, Lurë, Çidhën, Kastriot, Sllovë etj) dhe veçanërisht në qytetin e Dibrës së Madhe.

Ardhja e demokracisë dhe shembja e perdes së hekurt që ndante vëllezërit e një gjaku dhe të një gjuhe, me të njëjtën traditë etno-kulturore dhe historike (1992), i jep krahë dhe frymëzim punës së zellshme e pasionante të Moisi Murrës. Vetëm një vit më vonë, në qytetin e Dibrës, do të mbahej i pari Simpozium ndërkombëtar mbi etno-kulturën e Dibrës (21-23 nëntor 1993), ku Moisi Murra do të ishte në grupin nismëtar dhe organizator dhe do të kontribuonte si rrallë kush. Për tre ditë me radhë, studiues nga të dy Dibrat, nga Tirana dhe Shkupi, si dhe studiues dibranë nga Evropa dhe Amerika, mbajtën kumtesat e tyre me kontribute befasuese. Materialet e këtij simpoziumi me nivel mjaft të mirë shkencor, tashmë janë botuar në dy vëllimet "***Dibra dhe etno-kultura e saj***" (Dibër 1995), ku Moisi Murra ka një kontribut të veçantë si redaktor dhe anëtarë i bordit editorial. Por, për të ardhur deri tek realizimi i tij, është dashur shumë punë në terren, kryesisht në pjesën lindore të Dibrës, deri atëherë "mollë e ndaluar" për ne të anës perëndimore të saj. Të mbështetur fuqishëm nga vëllezërit tanë të qytetit të Dibrës, në mënyrë të veçantë nga Jakup Markja, Fisnik Cami, Qeram Lleshi, Nuri Kaleci, Atli Dema, Sazan Papraniku, Bashkim Mashkulli, Dashamir Markja, Afrim Mashkulli etj. dhe të ndjerët Moisi Lutfiu e Munir Fida. Në këtë periudhë bashkë me Moisi Murrën dhe të paharruarin Hazis Ndreu, kemi vizituar kalanë e Koxhaxhikut (qytetin e Sfetigradit), kështjellën e Modricës dhe më vonë atë të Skudrinës etj., që ruajnë dëshmi të çmuara arkeologjiko-historike të trashëgimisë antike ilire si dhe të periudhës mesjetare, veçmas të luftrave çlirimtare të Skënderbeut etj.

Moisi Murra ka kontribuar drejtpërdrejt në organizimin e të gjitha eventeve shkencore dhe historiko-kulturore, kushtuar përvjetorëve të ngjarjeve të rëndësishme historike të Rilindjes shqiptare, ku qyteti i Dibrës ishte shquar mbi shumë të tjerë. Mjafton të përmendim veprimtaritë shkencore dhe akademitë përkujtimore mbi Lidhjen Shqiptare të Prizrenit (1878), Kuvendin e Dibrës (1899), Kongresin e Manastirit (1908), Kongresin e Dibrës (1909), Kryengritjen e Shtatorit (1913), Kuvendi i Arrasit (1920), Betejën e Lan-Lurës dhe çlirimin e Dibrës (1920) etj. Po kështu ai ka dhënë një kontribut të çmuar edhe në veprimtaritë kushtuar figurave patriotike dibrane si, Josif Bageri, Seit Najdeni, Hoxhë Muglica, Salë Markja, Selim Rusi, Haxhi Vehbi Dibra, Dom Nikollë Kaçorri, Elez Isufi (Ndreu). Kontributi i tij është gjithashtu shumë i vyer në plotësimin e dosjeve të luftëtarëve të periudhave të ndryshme historike, në hartimin kalendarit historik të Dibrës etj. Vitet 1993-2013 kanë qenë të mbushura me veprimtari të tilla, të zhvilluara si në qytetin e Dibrës ashtu edhe në atë të Peshkopisë.

Kontributi i tij shkencor mbi historinë e Dibrës, është mirëfilli i përfaqësuar veçanërisht në monografinë e tij të fundit. Monografia ***"Dibra nga Antikiteti në Monarki"***(Tiranë 2017), është fryt i një pune të gjatë e sistematike rreth 30 vjeçare, në terren, në arkiva, në biblioteka dhe në kabinet. Është sistemuar dhe klasifikuar një material i pasur dhe i larmishëm historik, me shtrirje kohore shumë të gjerë, i cili i serviret i gatshëm në tavolinë e të nxënit çdo studiuesi të Historisë së Dibrës në veçanti dhe të Shqipërisë në përgjithësi. Mund të thuhet pa frikë teprimi se ajo është vepra studimore më e rëndësishme e autorit, dhe si e tillë mund të quhet lirisht si vepra e jetës së tij. Me një dashuri të madhe për Dibrën dhe historinë e saj, me një përkushtim të rrallë dhe skrupulozitet të veçantë, Moisi Murra ka arritur të paraqesë në mënyrë sintetike historinë e Dibrës përgjatë një periudhe shumë të gjatë kohore, mbi 2000 vjeçare, vepër që tashmë është në duar të çdo dibrani, kudo ku ai jeton, në Shqipëri, FYROM apo SHBA.

Me rastin e promovimit të saj, jemi shprehur se me këtë monografi, autori ka shënuar disa arritje të rëndësishme për historinë e Dibrës. Ai ka meritën se e ka trajtuar Dibrën si një etnitet gjeohapsinor dhe etno-kulturor, pavarësisht ndarjes dhe masakrimit të saj territorial nga Konferenca e Londrës e vitit 1913. Ai ka realizuar një porosi të moçme të çdo brezi që i zhvilloi luftrat e shumta për mbrojtjen e Dibrës. Me një gjetje interesante dhe të besueshme, ai na përcjell thirrjen heroike të atyre që i bënë këto luftra mbrojtëse, të brezit të gjyshërve tanë, mbi nevojën për të shkruar, për

Moisi Murra ka kontribuar drejtpërdrejt në organizimin e të gjitha eventeve shkencore dhe historiko-kulturore, kushtuar përvjetorëve të ngjarjeve të rëndësishme historike të Rilindjes shqiptare, ku qyteti i Dibrës ishte shquar mbi shumë të tjerë.

t'i hedhur në letër dhe për t'i dëshmuar brezave më të rinj heroizmin masiv dibran në mbrojtje të Dibrës dhe jo vetëm. Nevoja për të shkruar dhe rishkruar historinë tonë me objektivitet shkencor, është një kërkesë jo vetëm e nevojshme por edhe e domosdoshme. Me këtë monografi, Dibra ka tashmë një memuar historik, të shkruar me dashuri dhe përkushtim, që i kushtohet historisë së vjetër dhe të re të Dibrës, me të cilën dibranët ndjehen më të plotësuar. Monografia përveç vlerave historike e kulturore ka edhe vlera të shumta patriotike e atdhetare, për edukimin e brezave të rinj, me vlerat më të mira të të parëve tanë, që më shumë se çdo gjë e deshën vendin dhe atdheun e tyre. Falë punës studimore të studiuesve dibranë, përfshirë edhe kontributin e spikatur të Moisi Murrës, në Historinë zyrtare të Shqipërisë, kohët e fundit janë korrigjuar disa pasaktësira lidhur me historinë e Dibrës. Njohës i shkëlqyer i terrenit, autori ka sjellë argumente të reja të pathëna më parë në mbrojtje të hipotezave të ngritura prej tij, siç është p.sh hipoteza mbi lokalizimin e Albanopolisit në Jabllanicë, hipoteza mbi lokalizimin e fushës së Torviollit në fushën e Kastriotit dhe të Volezës, ato mbi lokalizimin e disa vendbetejave të Skënderbeut në Dibër etj. Autori ka sjellë dëshmi të shumta arkivore dhe dokumentare, mbi pjesëmarrjen e dibranëve në luftrat mbrojtëse jo vetëm në Dibër, por në të gjitha krahinat e Shqipërisë natyrale. Kudo të shkosh në hapësirën e Shqipërisë etnike (Kalis, Kolosjan, Prizren, Zhurr, Dibër, Shkodër, Lezhë, Manastir, Ohër, Shkup, Karadak, Kotor, Nish), do të gjeshë varre dibranësh të rënë në luftrat mbrojtëse, madje edhe jashtë kësaj hapësire (Follorinë, Selanik, Bullgari). Monografia plotësohet edhe me fotografitë e 42 dibranëve të shquar, duke filluar nga rilindasit Seit Najdeni, Josif Bageri, Haxhi Vehbi Dibra e Dom Nikollë Kaçorri, drejtuesit dhe luftëtarët dibranë gjatë Luftës Nacional-Çlirimtare, si Haxhi Lleshi, Ismail Strazimiri, Faik Shehu, Gjok Doçi, Dali Ndreu etj, shkrimtarët përparimtarë Haki Stërmilli dhe Haki Sharofi deri tek studiuesit Vahid Kurmaku, Munir Shehu, Lutfi Turkeshi dhe Hazis Ndreu etj. Monografia është e pajisur me një aparat të pasur shkencor, me dokumente të shumta arkivore dhe literaturë të gjerë e të plotë, të pasqyruar në 1625 fussnota. Monografia është pajisur me aparat të pasur ilustrativ, fotografi, faksmile dokumentesh, skica, planimetri dhe portrete të dëshmorëve dhe heronjëve të luftrave çlirimtare.

Me informacionin e pasur dhe të larmishëm historik që sjell, me analizën dhe sintezën për ngjarje të rëndësishme historike, "*Dibra nga Antikiteti në Monarki"*, është një monografi që plotëson një boshllëk të ndjeshëm një njohjen më të mirë e më të plotë të historisë së ndritur të Dibrës.

Do të ishte në nderin dhe dinjitetin e Bashkisë së Peshkopisë, si dhe të miqve të autorit, përgatitja për botim dhe botimi i veprës së lënë në dorëshkrim "***Dibra nga Monarkia në Demokraci***", si një homazh mirënjohjeje për studiuesin Moisi Murra.

Jakup Markja, Adem Bunguri, Ulvi Shehu, Fisnik Cami, Atli Dema, Qeram Lleshi, Ibrahim Kolari, Sazan Papraniku, Nuri Koleci, Bashkim Mashkulli, Mersim Markja, Dashamir Markja, Bashkim Lleshi, Zabit Lleshi, Gafur Zoto, Adrian Skuka, Iliaz Kaca, Luan Kaba, Skënder Cala, Bujar Karoshi, Hysen Uka, Halil Rama, Teki Kurti, Fasli Mera.

histori

Shkëputur nga libri "Dibra nga Antikiteti në Monarki" i autorit Moisi Murra

KALENDAR HISTORIK
shek. V p.e.s. - qershor 2009

VITI NGJARJET

Shek. V para krishtit- Herodoti përmend emrin Dibër
Shek. IV pas krishtit- U ndërtua Kalaja e Grazhdanit, në një sipërfaqe prej 34 ha tokë, me një mur rrethues 2760 m gjatësi, 2. 8 – 4. 5 m lartësi. Në kala kanë qenë të ndërtuar 40 kulla. Kalaja ka pas urë tri hyrje me përmasa 9 x14 m. Në vitin 1969 është shpallur Monument kulture.
170-169 p. e s- Autorët antikë përmendin fisin ILIR të Penestëve.
292-306- Dibra ndodhet në pushtimin romak.
395- Dibra bie nën pushtimin e Perandorisë së Lindjes (Bizantit)
527-565 e. s- Ndërtohet Kalaja ilire e Peshkopisë.
1020 - Ngrihet Epishkopata e Dibrës, me seli në lagjen "Bulke" të Dobrovës.
1107- Dibra bie nën pushtimin osman.
1108 - Dibra bie përsëri nën pushtimin bizantin.
1192 - Treva dibrane shkëputet nga sundimi bizantin.
1257 - Oraniku (Shehri i sotëm i Dibrës) përmendet në dokumente qytet.
1270 - U ndërtua në fshatin Kërçisht Kisha e Cveti Spas (Shën Sofia). Në mure ruhen afreske me përmasa 7x3. 2m. Në vitin 1970 është shpallur monument kulture.
1270-1380 - Në fshatin Herbel u ndërtua Kisha e Shpërfytyrimit. Është ndërtuar me një teknikë të thjeshtë, Pranaus Nauso-Absieda tre faqesh. Materiali i ndërtimit është gur dhe llaç gëlqereje. Në vitin 1970 është shpallur Monument kulture.
1283 - Dibra bie nën sundimin serb.
1330 - Dibra bie përsëri nën sundimin bizantin.
1355 - Pal Gropa merr nën zotërim Ohrin dhe Dibrën.
1375 - Dibra kalon nën zotërimin e Balshajve.
1385 - Dibra bie nën pushtimin e turqve osmanë.
1389, 15 qershor - Gjergj Kastrioti (kastragjysh i Skënderbeut) merr pjesë në Betejën e Fushë Kosovës.
1402 - Gjon Kastrioti merr pjesë në betejën e Ankarasë.
1405 - Lindi Gjergj Kastrioti – Skënderbeu.
1426 - Gjon Kastrioti me djemtë i dhurojnë manastirit të Hilandrit fshatrat Radostush dhe Trebisht.
1430, pranverë- Ushtritë osmane dhe ushtritë e despotit serb të Rashës sulmuan viset e Gjon Kastriotit.
1431, 25 korrik - Vdiq djali i Gjon Kastriotit, Reposhi.
1437 - Dibra ngrihet në rang sanxhaku.
1438 - Vdiq Gjon Kastrioti.
1440 - Skënderbeu emërohet sanxhakbej në Dibër.
1443, 3 nëntor - Ushtritë osmane thyhen afër Nishit. Skënderbeu kthehet drejt zotërimeve familjare.
1444, 29 qershor - U zhvillua në Dibër të Poshtme, në Fushën e Torviollit (Fusha e Kastriotit), ndën Kalanë e Volasit, beteja e parë e shqiptarëve nën udhëheqjen e Skënderbeut kundër 25000 trupave turke që komandoheshin nga Ali Pasha. Ushtria turke humbi 8000 të vrarë dhe 2000 robër. Nga shqiptarët mbetën 1600 të vrarë dhe 2000 të plagosur.
1445, 10 tetor - U zhvillua Beteja e Mokrës, kundër 10000 trupave turke të komanduara nga Firuz Pasha dhe ushtrisë shqiptare të komanduar nga Skënderbeu. Ushtria turke pati 1500 të vrarë dhe 1000 robër.
1446, 27 shtator - U zhvillua Beteja e Otonetës në vendin e quajtur «Çezmja e mbretit», krahina e Rekës, ndërmjet forcave shqiptare dhe forcave turke. Në këtë betejë 15000 kalorës turq u komanduan nga Mustafa Pasha. Ushtria turke pati 5000 të vrarë dhe 300 ushtarë të kapur rob.
1448, 14 gusht - U zhvillua Beteja e Oranikut, kundër 15000 trupave osmane të komanduara po nga Mustafa Pasha dhe ushtrisë shqiptare të komanduar nga Skenderbeu. Ushtria turke pati 5000 të vrarë. Vetë Mustafa Pasha u kap rob nga Moisiu i Dibrës në fushë të Rrethas (fusha e Mireshit).
1449, 10 maj - Shqiptarët nën udhëheqjen e Skënderbeut goditën dhe asgjësuan në
Grykën e Radikës 2000 ushtarë osmanë.
1449, 14 maj - Sulltan Muradi II, në krye të një ushtrie prej 80000 vetash ngriti kampin para mureve të Sfetigrad (Koxhaxhik).
1449, 22 qershor - Shqiptarët, nën udhëheqjen e Skënderbeut mundën, në Betejën e Talmiranës, fusha rëzë malit Tal, në veri të Bulqizës, një trupë ushtarake të komanduar nga Ibrahim Pasha. Turqit në këtë betejë lanë 3000 veta.
1449, 25. X - 26 XI - Skënderbeu mbajti të rrethuar Sfetigradin.
1451, 21 korrik - U zhvillua beteja e Modricës në mes të ushtrive shqiptare të komanduara nga Skënderbeu dhe një trupe ushtarake turke prej 10000 ushtarësh, e komanduar nga Hamza Pasha. Në këtë betejë ushtria turke pati humbje të mëdha dhe vetë Hamza Pasha u kap rob.
14451, 21 korrik - U zhvillua në një fushë, ndërmjet fshatrave Prapaniku i Epërm dhe Prapaniku i Poshtëm), 2 orë pas betejës së Modricës, beteja e Meçadit. Ushtarët turq në këtë betejë komandoheshin nga Talip Pasha, i cili u vra nga Moisiu i Dibrës, që në çastet e para të luftimit. Në Betejën e Modricës dhe të Meçadit ushtria turke pati 7000 të vrarë.
1456, 20 maj - U zhvillua në Oranik beteja kundër Moisi Golemit.



1465, prill- U zhvillua beteja e Valkalisë-Valikardhës (sot fusha e Zerqanit) ndërmjet ushtrive osmane të komanduara nga Ballaban pashë Badra dhe ushtrive shqiptare të komanduara nga Skënderbeu.
1465, gusht- U zhvillua beteja e dytë e Valkalisë (Valikardhës).
1467, mars - Peshkopia është fshat me 32 shtëpi.
1468 - U ndërtua Xhamia e Hinqarit (Xhamia e mbretit Fatih) në qytetin e Dibrës, në një sipërfaqe prej 1287 m².
1468, 17 janar - Ndërroi jetë, Gjergj Kastrioti–Skënderbeu, Heroi Kombëtar.
1560, 27 shkurt - Pesëqind banorë nga Dibra e Poshtme hidhen në kryengritje.
1560, 26 prill - Mbi 500 banorë nga Dibra e Poshtme janë hedhur në kryengritje dhe kanë djegur shtëpitë e spahinjve.
1582- Nis islamizimi i banorëve të Peshkopisë.
1585 - U ndërtua Xhamia e Allajbegisë. Është shpallur Monument kulture në vitin 1970.
1595, 22 gusht - Dhjetëmijë kryengritës shqiptarë që prej tre vitesh veprojnë në krahinat e Dibrës. Ata kanë sulmuar disa herë trupat turke në qytetet e Tetovës, Dibrës dhe Shkupit.
1713, dhjetor - Banorë nga fshatrat Topojan, Stushaj, Vilanicë (lagje e Homeshit), Vlashaj, Gjuras, Kovashicë, Mazhicë, Selishtë.
1714, shkurt - Të krishterët kryengritës të fshatrave të Lurës kundërshtonin taksën e xhizjes.
1833, 16 shkurt - Banorët e Çidhnës nën udhëheqjen e Vejsel Lushës dhe Sali Nokës hidhen në kryengritje.
1835, 17 korrik - Kryengritësit e Dibrës, pasi kapën qytetin e Strugës, fshatrat përreth dhe rrugën e Shkodrës, i drejtohen Ohrit.
1838, nëntor - Kryengritës nga fshatrat e Grykës së Vogël hidhen në kryengritje dhe kërkojnë zëvendësimin e nëpunësve osmanë me shqiptarë.
1844, 5 - 10 nëntor - U Zhvillua lufta e Gjoricës (lufta kundër Hajredin
Pashës).
1855, qershor - Dibranët nën udhëheqjen e Salë Markes kundërshtojnë reformat e Tanzimatit.
1860, pranverë - Bulqizakët nën udhëheqjen e Sheh Fejzë Çangës hidhen në kryengritje.
1860 - Lindi Pop David Dufi në fshatin Duf të Rekës së Epërme. Kishte lidhje me Josif Bagerin, Anastas Allbanskin, Llazar Stilianin, Qamil Dacin, Shyqyri Qokun, Vehbi Xhidrin, Hasan Ballancën, etj. Mbrojti përkatësinë shqiptare të fshatit Duf. U vra nga serbët në janar të vitit 1913.
1864 - Peshkopia bëhet qendër e kazasë së Dibrës së Poshtme.
1870 - Lindi në Nistrovë të Rekës Josif Bageri. Emigroi në Bullgari. Qe një nga iniciatorët e themelimit të shoqërisë "Dëshira" dhe "Afron dita" të Sofjes. Më 18 maj nxori gazetën "Shqypeja e Shqypnisë". Në 1910 botoi në Sofje përmbledhjen me poezi "Kopsht malësori". Në 1914 erdhi në Durrës, ku mori drejtimin e gazetës "Ushtima e Krujës". Vdiq në Prishtinë në vitin 1914.
1870 - Lindi në Tanushe të Rekës Hafiz Maliq Tanusha. Mësimet e para i mori në medresenë e qytetit të Dibrës. Emigroi në Stamboll. Ka qenë anëtar i shoqërisë "Bashkimi" të Stambollit. Atje hapi disa klube e shkolla shqipe. U nda nga jeta në vitin 1928
1872 - Vendoset linja telefonike Oranik (Shehri i Dibrës) – Peshkopi.
1873 - Lindi në qytetin e Dibrës, Jashar Erebara. U shkollua në Shkup dhe Bukuresht. Nxori gazetat "Albanija" dhe "Shkupi" etj. Mori pjesë në Kongresin e Manastirit, në Shpalljen e Pavarësisë në Vlorë dhe Kongresin e Lushnjës. Është një ndër themeluesit e "Komitetit Kombëtar për Mbrojtjen e Kosovës". Është zgjedhur deputet i Dibrës dhe ka drejtuar edhe pushtetin vendor në Tiranë për një periudhe të shkurtër. Jashar Erebara dha kontribut në themelimin e Klubit shqiptar të Kumanovës, i cili u hap në janar të vitit 1909. Ky klub hartoi abetaren e njohur "ABECEJA SHQIPE" e Kumanovës, ku mësohej shkrim-leximi. U nda nga jeta, më 24 qershor 1953 në Tiranë.
1875, pranverë - Dibranët nën udhëheqjen e Abas Repës janë hedhur në kryengritje.
1878, 3. 03 -13. 06 - Dibranët protestojnë kundër vendimit të traktatit të Shën Stefanit që i jepte Bullgarisë vise të tëra të trevës dibrane.
1878, qershor - Themelohet Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Iljas Pashë Dibra zgjidhet kryetar i Kuvendit dhe kryetar i këshillit të përgjithshëm.
1878, qershor - Formohet Lidhja Shqiptare e Prizrenit, dega Dibër me kryetar Iljaz Pashë Dibra.
1878, 1 nëntor- Dega e Lidhjes Shqiptare të Dibrës dhe e Toskërisë i kërkojnë qeverisë osmane njohje Shqipërisë si vilajet autonom.
1881, mars - Lindi në qytetin Dibrës Hafiz Xhemal Mullaj. Studimet e larta në teologji e më vonë, në drejtësi i bëri në Stamboll. Njihte gjuhët turke, arabe dhe perse. U emërua pedagog i Teologjisë në Universitetin e Stambollit dhe pastaj anëtar i Gjykatës Islame. U zgjodh kryetar i Shoqërisë "Bashkimi" të shqiptarëve të Stambollit. Në Turqi hapi shkolla shqipe nga kamja e tij. Në vitin 1921 erdhi në Shqipëri si përfaqësues i shqiptarëve të Turqisë. U zgjodh nënkryetar i Asamblesë dhe si jurist, dha një kontribut të çmuar në përpilimin e ligjeve themelore të shtetit të ri shqiptar. Deri më 7 prill 1939 qe gjithnjë deputet i Dibrës dhe kryetar i komisionit të drejtësisë në parlament. Në qershor të vitit 1939, për qëndrim të fortë antifashist, u arrestua e u burgos. Pas dy muajsh u internua në Bergamo të Italisë, ku e mbajtën 5 vjet. Pas kthimit nga internimi iu përkushtua vetëm fesë si mësues në Medrese. Vdiq në Tiranë në mjerim të plotë, në një dhomë të errët, në shkurt të vitit 1959.
1885 - Lindi në qytetin e Dibrës Abdurrahman Dibra. Mësimet e para i mbaroi në vendlindje, të mesmen në Manastir dhe shkencat politike e administrative në Universitetin "Mulqije" të Stambollit, ku iu akordua medalje ari. Në Turqi iu besuan funksione të ndryshme si nënprefekt i Stambollit, inspektor në Ministrinë e Brendshme dhe drejtor i një dikasteri. Në vitin 1920 kthehet në atdhe. Në vitin 1923 u zgjodh asamblist në Asamblenë Kushtetuese si përfaqësues i Dibrës. Mbas proklamimit të monarkisë është zgjedhur deputet i Dibrës në të gjitha legjislaturat dhe senator 1925. Ka mbajtur poste ministrore nga viti 1924 deri në 1939: Ministër i PB 27 maj 1924 - 10 qershor 1924, 23 dhjetor 1924 - 1 shkurt 1925, 12 shkurt 1927 - 10 maj 1928; Ministër i Financave 1926-1936; Ministri i Arsimit 1936-1939. Nga viti 1931-1936 ka qenë drejtor dhe administrator i gazetës "Besa". Në 1940 fashistët italianë e internuan në Itali. Me urdhër të kryeministrit Shefqet Vërlaci iu sekuestrua gjithë pasuria e luajtshme dhe paluajtshme. U kthye nga internimi në shtatorin e vitit 1943. Vdiq në Tiranë në vitin 1946.
1886 - Lindi në Oranik (Shehër) të Dibrës Hafiz Ismet Dibra. Mësimet e para i mori në vendlindje. Studimet e larta i kreu për teologji në Stamboll. Hafiz Ismeti zotëronte gjuhën arabe, perse dhe atë turke. Në vitin 1923 u zgjodh deputet i Dibrës. Në vitin 1930 iu besua drejtimi i Medresesë së Tiranës. Në vitet '30 të shekullit XX zhvilloi një veprimtari të gjerë intelektuale, fetare e atdhetare. Në vitin 1946 arrestohet dhe dënohet me 12 vjet heqje lirie. Ndërroi jetë në Tiranë në vitin 1955.
1889, 12 qershor - Lindi në qytetin e Dibrës Faik Shatku. Mësimet e para i mori në vendlindje, të mesmennë tregtaren franceze në Selanik, të lartën në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Stambollit. Më 14 maj 1924 emërohet anëtar i gjykatës së shkallës së parë në qytetin e Elbasanit e pastaj në Korçë. Më 11 shkurt 1925 emërohet prokuror i gjykatës së shkallës së parë në Tiranë. Më 23 mars 1925 deri 1929 punon si sekretar i përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë. Në vitin 1929 emërohet anëtar i Këshillit të Shtetit dhe më pas zëvendëskryetar i këshillit të shtetit, duke mbajtur dhe funksionin e Kryeprokurorit të Përgjithshëm të Shtetit dhe kryeprokuror i përgjithshëm i Gjyqit Ushtarak të Naltë. Në zgjedhjet për Asamblenë Parlamentare të vitit 1936 zgjidhet deputet i prefekturës së Elbasanit. Nga 9 nëntor 1936 deri 1938 mban postin e Ministrit të Arsimit. Në vitin 1937 propozoi dhe mundësoi kthimin e eshtrave të të madhit Naim Frashëri në atdhe. Ka qenë Kryetar i Federatës Sportive Shqiptare. Më 1 qershor 1938 u mandatua Ministër i Drejtësisë, në kabinetin e Koço Kotës, detyrë të cilën e mbajti deri në 7 prill 1939, kur u largua për në Turqi. Në muajin mars të 1940 kthehet në atdhe. Po këtë vit fashistët italianë e arrestojnë dhe e burgosin në Bari e në Bergamos të Italisë. Në maj të vitit 1941 lirohet nga burgu dhe kthehet në atdhe.
Mbështeti luftën nacionalçlirimtare. Pas kthimit ai emërohet kryetar i komisionit të kontrollit pranë Ministrisë së Financave. Ndërroi jetë në Tiranë, më 15 prill 1946.

(Vijon)

"Artisti i Merituar" Imer NELI
"Mjeshtër i Madh"

Një jetë në skenë me trofe e tituj të lartë

Nga **Esat RUKA,** *Mjeshtër i madh*

Tetëdhjetë vite në jetën e njeriut të grishin në bialncin e punëve të kryera, pse jo edhe të përjetimit të një pensionimi aktiv. Në jetën e një artisti vitet të japin kurorë nderimi për faktin se *arti nuk njeh moshë*. Është shkruar e kënduar se „nuk ka moshë kur këndon", apo se „robi plaket kur don vetë", por në rastin e artistit popullor Imerr Neli, bilanci është jo vetëm shumë i pasur me krijimtari e interpretime, por edhe me trofe e Tituj të Lartë si nga Juritë e hierarkive artistike, ashtu edhe nga protokollet e qeverisjeve Vendore dhe të Presidentëve të Republikës.

Imerr Neli u lind në lagjen Valxhi të Macukullit, ku i ati, Adem Luli (1899- 1946), njihej si instrumentist dhe mjeshtër i prodhimit të çiftelisë e laurisë. Të gjithë meshkujt e asaj shtëpie luanin me çifteli dhe fyej. Në zonën e Prellit qarkullonte shprehja vlerësuese se *„dajret e Valxhiut e ngrejnë paren prej toke",* shprehje e cila përmban muzikimin e folklorit krahinor, homogjenitetin artistik, jehonën që kishte ahengu i kësaj familjeje. Kjo specifikë e shtonte simpatinë tek bashkëkrahinasit e vet. Kjo dhunti e pasuronte vlerën e bujarisë, e mikpritjes, respektit e vullnetit për punën, atdhedashurinë e mirësinë.

Ndërsa më të mëdhenjtë e familjes rreshtoheshin darkave pranë njëri-tjetrit me instrumenta në dorë, Imerri i ri do ta ledhatonte papushim fyellin gjithë ditën teksa i printe tufës së dhive drejt bjeshkës për në Grykën e Valcës. I ndërthureshin të riut Imerr rrërfimet e dëgjuara për betejën e Shkallës së Deshëve kundër sërbit, për qëndresën e macukllanëve e matjanëve të tij për të mos lejuar komunizmin në Mat, për mbrojtjen e pronës, të nderit, të lirisë etj.

Nga gryka e një tubi metalik fluturonin jonet muzikore plot nostalgji e bukuri, plot butësi e dritë e ndërsa tufa e dhive i mblidhej rreth, Imerri hynte në një botë tjetër, në një mister ende të pashpjegueshëm. Intuita e artistit të ardhshëm gëlonte që tregimet, bisedat, blegërimën, fëshfërimën e barit e drurëve, shkarkimet qiellore, shkëlqimin e yjeve, çapitjet e njerëzve.... t'i fuste në tingujt e fyellit të tij magjik. Ai ngjitej malit dhe ulej mbi *„gurin e shkru"* jo vetëm që të kontrollonte më lehtë tufën, por ta kundronte gjithë hapsirën e luginës përrallore të Matit, kalatë përrreth saj, ujin e kristaltë të lumit Mat deri në derdhjen e tij në Adriatik. Magjepsej tufa e dhive me tingujt e mahnitshëm të fyellit, por krenoheshin edhe bashkfshatarët për të ardhmen e tij. Kishte njerëz që gjenin shkak dhe kalonin në grigjë, afër djaloshit të ri për të dëgjuar tingujt që ekzekutonte në melodité pafund me teknikën e përsosur, ornamentet e ritmet e shumta.

"Viti 1958 do të shënonte pjesëmarrjen time të parë në takimin folklorik zonal të organizuar në Derjan (atëherë - qendra e lokalitetit). Që nga ajo kohë, bashkë edhe me artistë të tjerë të Matit do të kisha fatin të takoja muzikantë të mrekullueshëm në qytetin e Burrelit dhe të njihesha me skenën dhe spektatorët" shprehet Imerri. *"Kur kam shkuar për herë të parë në vitin 1959 në Tiranë, drejtori Isuf Meta më shtynte nga mbrapa, pasi unë kisha emocion të dilja në skenën e festivalit i saposhkëputur nga bjeshkët, që i dashuroja aqë shumë".*

Djaloshi 20 vjeçar Imer Neli nga Macukulli nuk njihte lodhje së luajturi pa ndërprerje me fyellin e tij një repertor të larmishëm me intonacion e frazë të plotë, me ornamentikë e ngjyrë timbrike përkëdhelëse. Ai do të tërhiqte vemendjen e specialistëve dhe jurive dhe do të mbetej subjekt shumë i çmuar i etnofolkloristikës shqiptare. Ky nuk mund të ishte rast i izoluar. Ishte një trokitje në ndërgjegjen e nuhatjen e gjurmuesit e studjuesit të zellshëm të muzikologjisë, Prof. Ramadan Sokoli, se kjo begati e folklorit të krahinës së Matit buron vlera të panjohura, por shumë të larmishme e identitare. Studjuesi me intuitën dhe përvojën e profesionistit kërkon të njohë e regjistrojë materiale të tjera nga instrumentistë, rapsodë e grupe vokale të zonave të ndryshme të krahinës së Matit. Bashkë me Imerrin do të ishin edhe Shaqir Hazizi, Ibrahim Minxhozi, Hysni Hysneli me çifteli dhe Lim Rrahmani në lauri. Tanimë pranë Institutit të Folklorit në Tiranë (sot IAKSA) u bënë pjesë e arkivit jo pak material muzikor shumë i dobishëm.



Imerr Neli & Behar Neli, Gjirokastër 1978,

A është "Artisti i Merituar", "Mjeshtri i Madh" Imer Neli produkt i punës institucionale?

Në të gjitha kohrat dhe hapsirat institucionet janë ngritur mbi kontributin e talenteve individuale dhe kolektive. Hershmëria, cilësia, tipologjitë, kriteret, spiralja e zhvillimit, koherenca e arritjeve dhe infrastruktura mbështetëse e kapaciteti profesional etj, janë *asete* që mbështeten në trashëgiminë dhe modernitetin e sejcilit komb. Kjo përbën një temë që kërkon shtjellim më vete. Por le të potencojmë me logjikë të ftohtë se sukseset e gjeneratës të cilës po i referohemi janë të pandara nga ndikimi i ndërsjelltë individ-institucion. Ky është një fakt që nuk duhet injoruar.

Në fund të viteve **'50** të shekullit të kaluar bardi Imerr Neli u përball me skenën sipas një kalendari shtetror për zhvillimin e folklorit. Që nga ai vit do të përzgjidhej nga specialistët si talent me origjinalitet të sipaktur. Duke qenë pinjoll i një mjedisi muziktarësh ishte një arkiv i madh i krijimtarisë anonime të zonës së vet. "Legaizimi" i tij në publik e më pas jeta skenike nën drejtimin e kompozitorit *Skënder Frashëri* në Burrel do ta njihte me këngën e re qytetare të kri-

Lauranti i përjetshëm i festivaleve, reformatori dhe ekzekutuesi i talentuar në veglat popullore,njeriu fjalëpakë, korrekt e serioz, instruktori i përkushtuar prej dekadash i talenteve të reja, prindi shembullor dhe "fëmiu i dënuar" për të qenë përjetë mirënjohës ndaj vlerave të trashëgimisë artistike, Ai. që për 60 vite krijoi dhe përcolli jonet më të ëmbla të instrumentit në hapësirat kombëtare e kudo.
Ky është matjani i nderuar, artisti Ymer Nelaj, "Mjeshtër i Madh".

juara nga ky i fundit. E enthusiazmonte tepër fakti se Imerri bard e kishte ushqyer kompozitorin me bulëzat muzikore të lirikave të mrekullueshme të Matit.

I dyti do të ishte kompozitori *Munir Shehu* në mesin e viteve **'60** që do të organizonte *orkestrinën e parë* me instrumenta të trevës dhe Imerrin do ta kishte solist në orkestrinë. Bashkëzanimi i asaj orkestrine me këngët e bukura të kënduara nga e magjishmja Feride Kurti do të ishin një start tjetër i ri për Matin.

Në mesin e viteve **'70** kompozitori *Naim Gjoshi* e fuzionoi më tej përvojën dhe cilësinë e ekzekutimit si rezultat edhe i pjekurisë artistike të instrumentistëve. Roli i këtij instrumentisti do ngjitej në një platformë të re. Ai jo vetëm do të transportohej në tonalitete duke provuar me suksese kromatikën në bilbil, por do të deputonte në festivale i vlerësuar me çmime edhe si krijues.

Me këtë status përgatiti e drejtoi për dekada me radhë grupin e instrumentistëve të vegjël pranë QKF, të cilët u bënë rasati i orkestrinës, tashmë famoze të Matit. QKF-ja do të përfaqësohej disa herë në festivale më fëmijët dhe nën drejtimin e Imerrit do të meritonte gjithnjë vende të para.

Nuk shkruajti partiturë, por ishte ushqyes i partiturave të kompozitorëve në rreth dhe më pas bëhej ekzekutuesi i atyre partiturave me fyellin dhe bilbilin e tij.

Ishin talenti, pasioni,vullneti, disiplina, dashuria për trashëgiminë e trevës së vet? Padyshim, të gjitha bashkë plotësinin portretin artistic të tij. Por unë do të shtoja edhe respektimin nga ana e Imerrit e *punës programore* në zbatim të politikave kulturore të institucioneve, tek përgatitja profesionale e drejtuesve të muzikës, tek qarkullimi e ballafaqimi në skenë, ku cilësia artistike dhe disiplina e madhe ktheheshin në një shkollë të re për 'të. Imerri kujton: " *Kur kam parë për herë të parë në Tiranë Xhevat Lishin me dajre në grupin përfaqësues të Matit, që morën në mënyrë të padiskutueshme çmimin e parë, e ndjeva veten krenar dhe përnjëherë mendova pozicionin tim në përbërje të këtij grupi artistik.*

Dhe vërtetë tingujt e fyellit, bilbilit e çiftelisë së Imer Nelaj në krye të ansamblit "Mati" do të dominonin thuajse pjesën më të madhe të joneve që prodhonte orkestrina popullore. Pa asnjë mëdyshje do të justifikonte jo vetëm besimin e drejtuesve por edhe respektin e kolegëve për aftësitë, talentin, përkushtimin dhe disiplinën. Një muziktar me këto aftësi në mardhënie me skenën dhe me cilësi të tjera shoqërore e qytetare, gëzon për një periudhë kaq të gjatë atributet e një artisti të pëlqyer e të duartrokitur. Një muziktar i tillë mbulohet me një aureolë adhurimi e *nderimi* falë dhuntive dhe vlerave që përcjell. Prandaj edhe ka tërhequr vemendjen e shumë kronikanëve e poetëve, gazetarëve e studjuesve, lokalë e kombëtarë të cilët të frymëzuar nga pasioni dhe vibrimet e tij shpirtërore, kanë evidentuar me solemnitet e elegancë në vargjet dhe frazat e tyre.

Është rast unikal në shkallë kombëtare, që artisti Imerr Neli, që nga viti 1958 nuk i është ndarë asnjëherë skënës së koncerteve, festivaleve lokale, kombëtare në tipologjitë e gjinive të artit folklorik dhe të Festivalit Folklorik Kombëtar në Gjirokastër. Imerr Neli është pjesëmarrës në të **10** Festivalet, pra që nga viti 1968 si solist në aerofone, laureat në disa syresh radhazi, i titulluar Artist i Merituar në vitin 1979. Tani mban edhe titullin e lartë "Mjeshtër i Madh". Ndërsa ka deputuar në dhjetra festivale pa ndërprerje dhe ka fituar qindra diploma, çmime, Mirënjohje, dekorata dhe Tituj brenda dhe jashtë vendit, në diasporën shqiptare dhe në mediumet shkencore Ai shpreh me veneracion mirënjohjen dhe respektin për spektatorin e mrekullueshëm që e ka ndjekur dhe duatrokitur kudo për 60 vite me radhë.

Nuk mund të përcaktoj numrin e kilometrave të bëra e të orëve të vona në skenat e ndryshme të koncerteve, buzëqeshjet e ngazëllimet, duartrokitjet e sukseset, as edhe telat e këputur nëpër instrumenta apo ndonjëherë edhe tendosje nervash, por një fakt mund ta them: "kam shpenzuar aq shuma tuba plastikë për të prodhuar fyejt që më nevojiteshin në skenë, sa me 'to e kisha sjellë ujin e lagjes Valxhi të Macukullit në banesën time në lagjen "Pjetër Budi" në Burrel".

Njerëzit aktivë të kësaj moshe gjithnjë kërkojnë të dijnë pengjet të cilat mendojnë se nuk kanë arritur t'i zbusin. Ne gjykojmë se *ky artist punoi e "magazinoi" në koshiencën e tij artistike bereqetin më të madh të trashëgimisë, përvojën më të mirë, i vuri ato në shërbim të pajës estetike të gjeneratës së vet, mbolli gjatë jetës aq rasat artistik, sa do ta kujtojnë e nderojnë për shumë kohë talentet dhe skenat e Festivaleve.*

Kjo ndihmesë dhe ky shembull i tij kulmon me të birin, *Beharin*, i cili ka hyrë në tregun e produksionit muzikor me guxim, pasion, virtuozitet dhe origjinalitet si një shembull kreativ i gjeneratës së tij. Edhe për këtë faleminderit artistit Imer Nelaj.

Kemi kënaqësinë t'i urojmë përzemërsisht me mirënjohje mikut dhe kolegut tonë Imer Neli: Gëzuar 80 Vjetorin e lindjes! Lumturofshi në 100 vite jetë aktive me familjen tënde të nderuar dhe familjen tonë të artit popullor. Pleqërofshi në mesin e të dashurve, duke shijuar kënaqësitë dhe nderimin që të jep puna, talenti dhe përkushtimi.

Me rastin e 75 vjetorit
të krijimit

Batalioni partizan i Dibrës

Gjatë vitit 1943 lufta kundër fashizmit italian çoi në zhvillime të reja e të rëndësishme për fatet e Atdheut dhe popullit shqiptar. Jashtë këtyre zhvillimeve nuk mund të mbetej Dibra, përkundrazi aksionet e Çetës së parë të Dibrës (20 qershorit 1942)u shtuan. U krijuan Çetat e reja partizane si ajo e Grykës së Madhe, Sllovës në shkurt të vitit 1943 dhe Çeta e Gollobordës në ditët e para të muajit gusht 1943.1 U shtuan radhët e luftëtarëve, lindi nevoja e krijimit të njësive më të mëdha ushtarake si batalionet, brigadat, divizionet e korparmatat. Më 10 korrik 1943 në Labinot u vendos krijimi i Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare, Shtabi i përgjithshëm i saj që mori përsipër udhëheqjen ushtarake të Luftës Antifashiste për çlirimin e vendit.

Më 24.07.1943 në shtëpinë e Isuf Koçit në Çerenec të cilën e kishim bazë të luftës qysh prej marsit 1941 bëmë mbledhjen e Celulës së Partisë. Mbasi i rrahëm mendimet për detyrat e reja që na dilnin, përpunuam planin e organizimit të batalionit. Diskutuam konkretisht për shtimin e radhëve me partizanë të rinj, për kuadrin e batalionit e të çetave, për aksionet e ardhshme, etj. 2 Komandant u caktua Haxhi Lleshi dhe komisar Njazi Islami. Në Gjoricën e sipërme, para shkollës, më 26 korrik u mblodh populli i Grykës së Vogël bashkë me 180 luftëtarë që përfaqësonin tre çetat partizane të Dibrës; Grykës së Vogël me komandant Ymer Lleshi, Grykës së Madhe me komandant Lym Zeneli, më vonë Muntas Kodra dhe Sllovës me komandant Esat Ndreu pastaj Faik Ndreu. Çeta e Gollobordës erdhi në batalion në gjysmën e dytë të muajit gusht me komandant Ahmet Cami.

Në Dibër, veprimtaria luftarake e çetave i kish detyruar forcat italiane të përqendroheshin në qytete si, Dibër e Madhe, Peshkopi, Burrel, Tetovë, Gostivar, Strugë, Kërçovë e Zerqan. Ishin krijuar zona të lira pothuajse në të gjitha fshatrat , reparte të vogla me pak personel ushtarak kishte në nën/prefekturën e Zerqanit, Trebisht e Bulqizë.

Përmbysja e Musolinit në Itali ishte një lajm i gëzueshëm për Luftën Nacionalçlirimtare. Shumë shqiptarë që ishin mobilizuar me forcë në radhët e ushtrisë italiane dezertuan, ndërsa ushtarëve italianë iu ngjallën shpresat për t'u kthyer në atdheun e tyre pranë familjeve. Vendimi i parë i Batalionit partizan ishte çlirimi i Zerqanit. Kjo detyrë iu ngarkua Çetës partizane të Grykës së Madhe.

Më 1 gusht 1943 Çeta hyri në Zerqan, bllokoi zyrat e administratës e nën/prefekturës, përforcoi forcat rreth kazermës së xhandarmërisë dukë kërkuar dorëzimin e tyre pa harruar disa masa të tjera si prerja e linjës telefonike që lidhte Zerqanin, prishjen e urës në Zall Sopot, etj. Më2 gusht erdhi me urgjencë në Zerqan Haxhi Lleshi së bashku me komandën e Çetës e komisarin e saj Spiro Velko, thirrën nëpërmjet Isa Sulës (një patriot e bazë e luftës) Shyqyr Baftjari (komandant i xhandarmërisë së Nën prefekturës), i kërkuan të dorëzonte garnizonin e të bashkohej me lëvizjen. Ai dorëzoi armët dhe nëpërmjet një letre u dha urdhër vartësve të tij të dorëzoheshin pa kushte. Bashkë me ato u dorëzuan disa karabinierë italianë nën komandën e marshall Mancotin. Të gjithë u lanë të lirë, italianët u drejtuan për në Dibër të Madhe.

"Armiku dorëzoi 7 mitraloza, 60 pushkë, si dhe municione e veshmbathje të shumta"3, të cilat iu shpërndanë popullit pas manifestimit që u organizua me rastin e çlirimit të Zerqanit. Ishte një fitore pa luftë e rezistencë sepse forcat armike e ato reaksionare e dinin mbështetjen që i bënte luftës Nacionalçlirimtare populli i Grykës së Madhe, ku morali, besimi e optimizmi rritej nga dita në ditë e nga aksioni në aksion. U zgjodh edhe Këshilli Nacionalçlirimtar i krahinës,me kryetar Myslim Shehun dhe anëtar: Riza Hanku, Adem Sinani, Islam Gurra e Riza Navaku. Partizanët e Batalionit të Dibrës më 6 gusht çarmatosën postën e karabinierisë në Spas, ndërsa më 7-14 gusht së bashku me forcat partizane të Martaneshit, Çermenikës e vullnetarë nga Gryka e Madhe e Bulqiza sulmuan repartin italian që ruante Minierën e Bulqizës.

Komanda e forcave italiane vendosi të kryente një operacion me 14 gusht në drejtim të Peshkopisë. Ajo nisi një regjiment këmbësorie shoqëruar me autoblinda. Forcat partizane zunë me shpejtësi kodrat e Pesjakës (Maqellarë) në vijën Pesjakë-Pocest-Obok. Rreth orës 900 të mëngjesit makinat me ushtarë italianë hynë në zonën e pritës, partizanët hapën zjarr, ndaluan autokolonën. "Forcave italiane u erdhën në ndihmë përforcime, megjithatë nuk mundën të lëviznin për në Peshkopi, u tërhoqën mbrapa, dogjën shtëpitë e Fiqiri Dines dhe shkuan në Dibër të Madhe." 4

Italianët lanë në fushën e betejës 13 të vrarë, shumë të plagosur, dy makina u dogjën e disa të tjera u dëmtuan rëndë.

Në Sofraçan batalioni ka zhvilluar një nga betejat më heroike të Luftës Nacionalçlirimtare. Ai ishte në dijeni për përgatitjet që bënte ushtria italiane për të hapur rrugën Dibër-Mat, të ripushtonte Zerqanin dhe të vendoste lidhje me garnizonin e Burrelit. Më 23 gusht një autokolonë e ushtrisë italiane prej mijëra ushtarësh doli nga Dibra e Madhe, Maqellarë, Shupenzë, u nda në tre kolona; e I-ra Vlashaj–Sofraçan-Krajkë-Peladhi; e II-ta Ura e Çerenecit-Sofraçan-Krajkë dhe kollona bashkë me Çetën vullnetare të Zerqanit ishin caktuar në prapavijën Sopot-Zerqan-Strikçan me detyrë për të mbrojtur krahët. Partizanët të maskuar ndoqën veprimet e armikut i cili me autoblinda kontrolloi rrugën deri në Krajkë në gatishmëri për të hapur zjarr. Në kodrat e Çerenecit artileria hapi zjarr në mbështetje të forcave tokësore. Kur forcat e armikut hynë në zonën e pritës partizanët hapën zjarr të befasishëm ndalën autokolonën të cilën e kapi një panik i madh dhe u çorientua. Gjatë natës partizanët lëvizën dhe zunë pozicione të tjera. Pas tre ditësh forcat italiane mundën të mbërrijnë në Qafën e Buallit. Nga ushtria italiane mbetën të vrarë 100 dhe u plagosën dhjetëra të tjerë, kurse nga ana e Ushtrisë Nacionalçlirimtare ranë heroikisht Mexhit Tola nga Ostreni e Kamber Xhafa nga Kovashica. Lufta e Sofraçanit bëri bujë të madhe në Dibër e jashtë saj ; Tashmë lufta po futej në një fazë të re, forcat italiane ishin demoralizuar e strukur në garnizonet e tyre.

Më 2 shtator 1943 Çeta e Gollobordës dhe e Grykës së Vogël dëbuan forcat e xhandarmërisë së Postës së Trebishtit. Këshillit Nacionalçlirimtar iu dorëzua komuna, në të gdhirë dolën në Modriç në rrugën Dibër-Strugë duke i zënë pritë një autokolone ku u vranë 3 dhe u plagosën 10 të tjerë, u dogjën 3 makina, u kapën 1 mitraloz, 5 pushkë, dhe municion tjetër ushtarak. Më 4 shtator forcat italiane për hakmarrje dogjën 400 shtëpi në Trebisht.

Më 8 shtator 1943 kapitulloi Italia fashiste, pas dy ditësh komisari i Çetës së Grykës së Vogël Ahmet Jegeni me një njësit të vogël nga Gjorica shkoi në Dibër të Madhe. Në emër të komandës së Batalionit të Dibrës i kërkoi gjeneral Aldo Aci që forcat italiane t'i dorëzoheshin Batalionit të Dibrës, depot, armatimet, ushqimet dhe veshmbathjet që disponojnë. Ai siguroi gjeneralin italian se ato që do të dorëzoheshin nuk prekeshin, do t'u sigurohej ushqimi, paprekshmëria e personit nga ushtari deri tek oficerët e komandës së Divizionit.


Pas dorëzimit të ushtrisë italiane u grumbulluan në Peshkopi rreth 3000 forca të reaksionit të cilat kërkonin që forcat italiane t'i dorëzohen Parisë reaksionare, të ndanin plaçkën e luftës në qytet dhe të mertnin pushtetin. Siç dihet Divizioni Firence iu dorëzua Batalionit të Dibrës. Kjo solli konfliktin që njihet si lufta e Peshkopisë, 17-18 tetor 1943. Luftime të ashpra u zhvilluan në sektorin veri lindor (Çipure-Kamen) të Peshkopisë që mbrohej nga Çeta e Gollobordës ku u plagos komandanti i saj Ahmet Cami i cili pas disa ditësh ndërroi jetë në një spital të Tiranës. Ranë dëshmorë Halil Hasa nga Tetova, Idriz Kaba nga Tomini, Nesim Kaza nga Cerjani, Alush Stojku nga Peshkopia. 5

Më 31 tetor deri më 3 nëntor, në bashkëpunim me Batalionin e Martaneshit u luftua 4 ditë e 4 net rresht për çlirimin e Dibrës së Madhe kundër nazistëve gjermanë, Batalioni i Dibrës pas kalimit të Divizionit sulmues në veri mori pjesë nëçlirimin e Homeshit, të Peshkopisë, në luftën e Fushë Alies etj.

Lindur dhe kalitur në luftë Batalioni partizan i Dibrës i kreu me sukses detyrat luftarake në Zerqan, Bulqizë, Peshkopi, Trebisht, Kërçovë, Strugë, Dibër e Madhe, Lumë, Krujë, Mat, Çermenikë, etj. Ky batalion i dha Atdheut 34 dëshmorë për 13 muaj të ekzistencës së tij,6 nga këto dy heroj populli, Nazmi Rushiti e Hibe Palikuqi. Më 18 gusht 1944 Batalioni Partizan i Dibrës u inkuadrua në Brigadën e 18 Sulmuese në Sllatinë.

Zabit Lleshi
Xhevat Jella
Kryetar i Komitetit të Veteranëve të LANÇ Bulqizë

Tiranë korrik 2018



Haxhi Lleshi
Kom.Batalioni Dibrës

Lindur dhe kalitur në luftë Batalioni partizan i Dibrës i kreu me sukses detyrat luftarake në Zerqan, Bulqizë, Peshkopi, Trebisht, Kërçovë, Strugë, Dibër e Madhe, Lumë, Krujë, Mat, Çermenikë, etj. Ky batalion i dha Atdheut 34 dëshmorë për 13 muaj të ekzistencës së tij...



Ymer Lleshi
K.Çete G.Vogël



Muntaz Kodra
K.Çete G.Madhe



Esat Ndreu
K.Çete Sllovës



Ahmet Cami
K.Çete Gollobordës

REFERENCAT
1- Xheladin Krifca (2005) *Dibra dhe Dibra e Madhe në luftë*. Tiranë 2005
2- Haxhi Lleshi (1996) *Vite, njerëz, ngjarje*, faqe 132, Tiranë 1996
3- Rakip Sinani (1986) *Lufta heroike e Batalionit të Dibrës,* gusht 1943, Gazeta Ushtima e Maleve 26 korrik 1986
4- Grup autorësh (2005) *Lufta Nacionalçlirimtare e popullit dibran,* faqe 114, Tiranë 2005
5- Grup autorësh (2005) *Lufta Nacionalçlirimtare e popullit dibran,* faqe 225, Tiranë 2005
6- *Almanaku Dibra* (1969), faqe 250 Peshkopi 1969

Rruga e Arbërit nr. 147

Michele Mëziu dëshiron të realizohet sa më parë është Rruga e Arbrit. Kjo do na bëjë që Dibrën të mund ta vizitojmë me shpesh dhe ajo të bëhet më e zhvilluar dhe më afër me botën.

të rinj të talentuar

Michele Mëziu, muhrraku në origjinë, talenti në shkëlqim

Nga **Gjon FIERZA**



Në historinë e saj Dibra ka shumë personalitet që kanë bërë emër brenda dhe jashtë Shqipërisë, në çdo fushë të jetës dhe një shtrirje të gjatë kohore. Vazhdon të rritet ky numër nga dita në ditë, kudo ku jetojnë e punojnë dibranet në çdo skaj të botës dhe pasardhësit e tyre duan të kenë një emër të zëshëm dhe të dallohen për vlerat që mbartin. Nuk është e mundur, as qëllimi i shkrimit të mund të listoj disa syresh. E shoh me vend veçoj një rast konkret më një shembull të një muhurraku larg Fushë-Muhurrit. Me të krenohet jo vetëm familja dhe të afërmit e tij, por dhe Dibra. Ai është në moshë të re, sapo mbaroi gjimnazin me rezultate shkëlqyshëm. Tani është në kërkim të shkollimit të lartë. Talenti dhe cilësitë e spikatura të Micheles janë vërejtur që në vite të para të shkollës për të vazhduar në gjimnaz. Ai është ndjekur dhe vazhdon të ndiqet nga specialistët e mësuesisë dhe të shkencave inxhinierike në procesin e shkollimit të diferencuar, pikërisht duke vlerësuar prirjet dhe përkushtimin e tij për dije dhe sukses.

Michele (Selman e Mimoza) Mëziu është djali që veçohet si ndër nxënësit më të shkëlqyer që kanë përfunduar gjimnazin në Firence, Itali, në qershor të këtij viti (2018) dhe që tashme po përzgjedh degën dhe universitetin për më tej.

Michele Mëziu ka lindur në Firence në tetor 1999, është fëmija i parë i çiftit Mëziu me dy motra Alessia dhe Sara, që duket se po e ndjekin atë në çdo hap. Mimoza dhe Selman Mëziu kanë emigruar në Firence që në vitin 1995. Mimoza bënë punë të ndryshme dhe së shumti ndjek shkollimin e fëmijëve. Selmani si specialist gjelbërimi, punon në një ndër kompanitë me emër në Firence, duke realizuar projekte jo vetëm në Itali, por dhe në Francë, Spanjë, etj.

Michele Mëziu, nuk u bë i njohur vetëm në këtë vit, ai të gjitha vitet e shkollimit të tij i ka me vlerësimin maksimal, shkëlqyeshëm, duke qenë një nxënës aktiv dhe në shumë veprimtari të tjera jashtë mësimit. Në provimet e këtij viti, ai nuk ka dhënë thjeshtë provime para një komisioni shtetëror, por ai ka ligjëruar për më shumë se një orë e gjysmë lëndë të veçanta, tashmë përpara një auditori me pjesëmarrës të zgjedhur që kishin ardhur të dëgjonin talentin shqiptar Michele Mëziu. Ai ka lexuar dhe vazhdon të lexojë shumë: libra artistik, historik dhe ne këto vitet e fundit dhe filozofik, është marre me art dramatik, etj. Ai është pjesëmarrës në disa olimpida dhe konkurse të ndryshme në shkencat e matematikës, fizikës, astronomisë, italishtes, etj., në Toskanë dhe në shkallë kombëtare-Itali dhe jo vetëm. Nga shumëçka që ai ka bërë dhe kërkon të bëhet, një rrugë e trasuar prej tij është, matematika, fizika dhe shkencat kompjuterike, këtu ai është absolut, ku mund të konsiderohet një talent i vërtetë. Mësues të veçantë të tij qe nga shkolla fillore dhe në atë të mesëm vazhdojnë ta ndjekin, ta orientojnë në rrugën e tij të dijes. Micheli, përveç se shqipes dhe italishtes, si gjuhë të nënës dhe të vendlindjes, zotëron shkëlqyeshëm anglishten dhe gjermanishten. Tek bisedon me Michelin dhe të mund të përmbledhësh në esencë zanafillën e këtyre që ai ka arritur dhe është në proces, mund të themi se: nëna e tij Mimoza, e shkolluar për mësuese matematike, por e pamundur ta ushtrojë këtë profesion në emigracion, duket se tërë atë pasion dhe çfarë ajo ka dashur tu jepte nxënësve të sajë ta transmetonte tek fëmijët e sajë, së pari te Micheli dhe vajzat: Mësoni të bëheni të ditur për të jetuar më mirë, por, edhe për të qenë të respektuar në shoqërinë civile italiane dhe me gjerë, ju thotë Moza fëmijëve të saj.

Selman Meziu, i shkolluar për inxhinier pyjesh, i njohur jo vetëm profesionist i shkëlqyer në pyje, duke pasur një veprimtari të lavdërueshme në rreth 13-15 vite në Shqipëri, por sot, ndonëse jashtë vendlindjes, ka pasionin e pylltarit dhe i vendosur të ruaj vlerat natyrore dhe mjedisin shqiptar. Ai është një njeri që kërkon ndryshimin, është botues i disa librave me shumë vlerë informuese dhe ndërgjegjësuese dhe i qindra artikujve në shtyp për pyjet dhe mjedisin shqiptar. Kjo veprimtari e Selmanit ka ndikuar fuqishëm tek Micheli, me shembullin vetjak. Micheli ka parë tek i ati, si ai pas ditës së punës së lodhshme; së pari si arriti të mësojë të punojë në kompjuter, si ai shpesh gjithë natën e kalonte duke shkruar, ka parë dhe lexuar librat e tij, duket se këto i kanë shërbyer për ti ngulitur vullnetin për shkollimin, për të arritur sa më lartë, të plotësojë ato aspirata që Selmani nuk i arriti në rininë e tij, apo dhe në vendlindjen e tij. Janë netë pa gjumë të Michelit, jo vetëm gjatë sezonit të provimeve, por dhe këto ditë, ku ai po aplikon në disa universitete me të njohura në Angli, Itali, Zvicër, etj. Ai po njihet me programet e tyre, vendos komunikim dhe kudo deri tani është mirëpritur interesi i tij për aplikim.

Michele Meziu e do vendlindjen e prindërve, ai çdo vit deri tani pushimet verore i kalonte në Dibër dhe Tiranë, atje i pëlqente të njihej me sa më shumë njerëz; me jetën, doket dhe zakonet e dibranëve. Ai, ndonëse ka lindur në Itali, gjithnjë e prezanton veten si dibran, ndërsa në Shqipëri ai të thotë se jam nga Fushë-Muhurri, në breg të Drinit të Zi. Tek bisedon me të dhe sa ndjek situatën në Shqipëri, ai të thotë se ajo çfarë dëshiroj të realizohet sa më parë është Rruga e Arbrit. Kjo do na bëjë që Dibrën të mund ta vizitojmë me shpesh dhe ajo të bëhet më e zhvilluar dhe më afër me botën.

Tek përmbyll këto radhë për Michele Mëziun, për talentin që padyshim do spikasë me arritjet e tij, na mbetet ti urojme "shëndet dhe suksese për më tej". Ndoshta disa vite me pas ky shkrim do të ketë thënë shumë pak nga sa Michele Mëziu ëndërron dhe do të bëhet. Ai nuk do jetë dhe vetëm një njeri i suksesshëm, por një njeri me shumë vlera.



Keni ndonje shqetesim per te ndare me komunitetin?

SHKRUANI NË GAZETË! BASHKËPUNO EDHE TI!

< rrugaearberit@gmail.com >

histori

Të tre këto toponime: Kepi i Xhitetit, Fusha e Xhitetit dhe Kalaja ilire e Çidhnës, pranë dhe ngjitur me njëri-tjetrin, përbëjnë argument për të na bindur se këtu kemi të bëjmë me një qendër urbane e hershme.

Gjurmë lashtësie në Çidhën

(vijon nga numri i kaluar)

Sqarojmë këtu se për fat të keq, ky monument historik, arkeologjik, me vlera të pallogaritshme për historinë jo vetëm të krahinës së Çidhnës e të Dibrës, por për mbarë historinë kombëtare shqiptare, ato gjurmë të murit të Kalasë së Çidhnës, janë asgjësuar në vitin 1971 nga padituria e punëtorëve të ish-ndërmarrjes së ujërave të Peshkopisë, të cilët e kanë thermuar me mina, për t'i kthyer në zhvorr për ta përdorur për mirëmbajtjen e kanalit të Setës që kalon mbi Drin e del në Laçes, Fushë-Alie, Kastriot etj.

Të tre këto toponime: Kepi i Xhitetit, Fusha e Xhitetit dhe Kalaja ilire e Çidhnës, pranë dhe ngjitur me njëri-tjetrin, përbëjnë argument për të na bindur se këtu kemi të bëjmë me një qendër urbane e hershme. Lidhur me këtë vlen të theksojmë faktin se vetëm në Çidhën të Poshtme kemi katër toponime me emrin "Kishë" ku ekzistojnë edhe gjurmët e mureve të tyre, ndërsa sipas dëshmisë së disa pleqve, ata arrinë deri në shtatë të tilla; si dhe fakti tjetër se në Çidhën dhe në Shashar,më 1467, veç të tjerash përpunohej edhe **mëndafshi**, përbën një argument tjetër më shumë që tregon se këtu ka qenë një qendër urbane e hershme. Lashtësia e këtij qytetërimi mund të arrijë deri në periudhën homerike të para 2500 vjetëve. Këtë konkluzion e mbështesim në argumentin se përputhja e emrit të hyjneshës greke "Circe", personazh i Homerit në këngën XII të poemës së tij **"Iliada** dhe **Odisea**", që ngjason jo vetëm në aspektin fonetik, por edhe më gjerë, me toponimin "Çërce" në "Çidhën", për të cilin banorët vendas tregojnë një sërë legjendash me personazhe xhindësh, shtrigash, kuçedrash, zanash, magjistricash etj, pra edhe nga karakteristikat e personazhit **"Circe"**, e cila si hyjneshë, këshillon Uliksin që t'i shmanget luftimit me kuçedrën "Shilë", me gjashtë krerë e me nga tri palë dhëmbë, **nuk** mund të jetë thjesht **rastësi.**

Nisur edhe nga fakti se shumë studiues kanë konkluduar se Homeri, autori i poemave "Iliada" dhe "Odisea" është me origjinë pellazgo-ilire (pra, shqiptare) edhe neve na lejohet e drejta të mendojmë se, së pari, përputhja e plotë e toponimit "Çirçe" në Çidhën me emrin e hyjneshës "Circe", të krijuar nga Homeri në poemën "Odisea" nuk mund të jetë një përputhje e rastit; së dyti, mbështetur në sa sipër, na lejohet të hamendësojmë se edhe vet Homeri mund te këtë qenë ndoshta dhe nga Çidhna, i cili duke njohur toponimin "Çërce" dhe legjendat rreth tij, duhet të jetë frymëzuar prej tij për të krijuar atë personazh e për t'i vënë atë emër, "Circe". Prandaj nuk do të thyenim ndonjë "tabu" nëse do të mendonim se edhe Homeri i Greqisë së Lashtë paska qenë një emigrant nga Çidhna, ashtu siç kanë emigruar edhe sot djemtë tanë në Greqi, Europë e në të katër kontinentet e botës. Në këtë aspekt edhe arvanitasi Aristidh Kola përbën argument si një "Homer" shqiptar i shek.XX, ashtu siç mund të ndodh në të ardhmen një fenomen i tillë edhe me Abdurrahim Ashikun, që ka emigruar në Greqi, nëse do ta botojë edhe në greqisht krijimtarinë e tij.

Së dyti, janë ilirët, ndërmjet tyre edhe Çidhnakët e asaj kohe, si puna e Homerit, autori i "Iliadës dhe Odisesë", i cili i frymëzuar nga emri i toponimit "Çërçe" krijoi personazhin e hyjneshës Circe që përmendet në këngën XII të poemës "Odisea", po ashtu, edhe te autorët e tragjedive të letërsisë klasike të asaj periudhe antike, p.sh.Eskili, Euripidi, Sofokliu etj. mund të kenë qenë ilirë, nga ata emigrantë të cilët, ashtu si Homeri, duhet të kenë qenë nga ata që e kanë pas njohur nga afër gjuhën alegorike e filozofike të mexhliseve e të kuvendeve të pleqve në odat e Çidhnës e të mbarë Dibrës, e cila është e gjallë dhe aktive edhe aktualisht, në ditët tona, vetëm në Malet e Dibrës. Prandaj, mbështetur në sa sipër, mund të hamedësojmë dhe të gjykojmë se nuk do të bënim ndonjë gabim nëse do të mendonim se jo vetëm krijimtaria letrare homerike paska qenë kulturë ilire, jo greke, por tanimë, mund të mendojmë se edhe pjesa tjetër e krijimtarisë letrare, të asaj periudhe, të cilën, neve, brezit të kohës sonë, historiografia letrare na e ka pas servirur si letërsi antike greke, ose letërsi e lashtë greke, ka shumë mundësi që ajo të mos jetë letërsi greke, por mbështetur në argumentet e lartpërmendura, na jepet e drejta të gjykojmë se ajo krijimtari letraro-artistike e asaj periudhe mund të jetë e kulturës ilire, aq më tepër, përderisa historikisht është i njohur dhe i konfirmuar fakti se Iliria në lashtësi, gjeografikisht ka qenë shtrirë deri përtej Athinës, d.m.th. Athina ka qenë pjesë përbërëse e Ilirisë. Në këtë aspekt për gjurmë lashtësie të periudhës Ilire përmendim këtu dhe një argument autentik, lojën "PAZARTHI"

Në gjithë zonën e Çidhnës, sidomos në fshatrat e zonës fushore të anës lindore të Drinit si **Laçes, Fushë,Bllice, Kastriot** etj, dhe më gjerë në Dibër, fëmijët dhe të rinjtë kanë pas luajtur një lojë sportive popullore që quhej "Pazarthi", e cila luhej në një fushë të hapur, si fushë futbolli me dy porta, të cilat quheshin **"Pat"**, ku lojtarët e secilës palë kur dilnin në fushë të hapur, (që quhej "pazari") synonin të kapnin rob, lojtarët e palës kundërshtare. Por kur lojtari i përndjekur, (ai që kishte dalur më parë në fushë të lojës) ikte me vrap dhe futej në "patin" (portën e vet) dhe **"merrte pat",** atij i ripërtërihej forca dhe pastaj, **nga i përndjekur, ai kthehej në sulmues** dhe përndiqte kundërshtarin për ta kapur rob, pasi pas prekjes me dorë të patit ose kalimit nëpër të, tashmë ishte kthyer në "sulmues". Ky veprim i transformimit të lojtarit nga i sulmuar ose i përndjekur, pasi rikthehej e kalonte nëpër "patin" e vet, ose mjaftonte të prekte njërën shtyllë apo gur (kufirin e Patit), na kujton veprimin e personazhit të letërsisë antike greke, **"Anteut", birit të nënës Tokë,** i cili, kur lodhej nga lufta në qiell kundër perëndive të tjera, ai ulej në Tokë për të rimarrë fuqi të reja dhe sapo të vinte këmbët në Tokë, i ripërtëriheshin forcat, merrte fuqi të reja dhe menjëherë ngrihej në qiell dhe risulmonte kundërshtarët, perënditë e tjera.

Veprimi i "marrjes pat" në lojën popullore sportive "PAZARTHI", ka një ngjashmëri shumë të madhe si në formë edhe në përmbajtje me veprimin e "Anteut", heroit të letërsisë antike greke, të cilit i ripërtëriheshin fuqitë sapo ai të prekte (të binte në kontakt) me nënën Tokë. Prandaj kjo ngjashmëri nuk është aspak e rastit, por ky fakt, veprimi dhe fjala **"marr pat"** përbën një argument tjetër më shumë që na dëshmon se gjurmët e kulturës dhe të qytetërimit të Çidhnës arrijnë deri në periudhën e letërsisë antike të Greqisë së Lashtë, e thënë ndryshe, janë të së njëjtës periudhë. Ndaj, mbështetur në gjithë sa sipër, konkludojmë se popullsia e Çidhnës është autoktone, e ngulur në këtë krahinë prej mijëra vjetësh.

Në këtë aspekt, lidhur me gjurmët e lashtësisë në Çidhën e më gjerë në Dibër, do të përmend këtu edhe këtë fakt:

Gjuha figurative, filozofike e EZOPIT dhe e tragjedive të ESKILIT, EURIPIDIT, SOFOKLIUT etj në Greqinë e lashtë, personazhet e të cilave ishin kryesisht perënditë pagane, prapa të cilëve në mënyrë figurative nënkuptoheshin pushtetarët tokësor, lokalë të asaj kohe, pra ajo gjuhë filozofike e Greqisë së Lashtë, ka qenë dhe është e gjallë dhe aktive edhe sot e kësaj dite, vetëm në të folurën figurative të pleqve filozofë në mexhliset e kuvendet e Odave të Çidhnës e më gjerë mbarë Dibrës. Ndaj, jo më kot, misionari anglez i dërguar në Shqipëri në vitet e Luftës së Dytë Botërore, në mos gabohem, Xhulian Emer-i, pasi qarkulloi rreth një vit nëpër odat e Dibrës, ku u njoh me filozofë popullorë të kalibrit të lartë si Tafë Kola, Dine Hoxha, Idris Zimuri (Shkurta), Selim Noka, Selim Sula etj., kur u largua nga Dibra, ato mexhlise (kuvende), ai i ka quajtur "Universitete filozofike të Dibrës". Në ligjëratë të drejtë, ai është shprehur tekstualisht kështu në momentin e largimit:

"Sot kreva (mbarova) universitetin e tretë këtu, në Dibër, pasi dy universitetet e tjera i kam kryer më parë në Londër. Do të dëshiroja, bile do të isha i lumtur sikur edhe fëmijët e mi të vinin e ta kryenin edhe ata këtë "Universitet". Pa njohjen e këtij "universiteti filozofik" të Dibrës ata do të mbeteshin të mangut."

Në mbështetje të tezës së misionarit anglez, Xh.Emer, për përcaktimin e odave (mexhliseve) të Dibrës si "Universitetii Dibrës", unë do të shtoj këtu edhe një vlerësim e përcaktim tjetër të tillë të ngjashëm për "odën" e Çidhnës nga historiani i mirënjohur, Akademiku Stefanaq Pollo, ish-drejtor i Institutit të Historisë në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, sa vijon:

Prof.Stefanaq Pollo, në korrik të vitit 1982, i shoqëruar edhe nga Prof.Kristo Frashëri dhe Hazis Ndreu, ndërmori një udhëtim eksplorues në Çidhën e Sinë të Dibrës, për të hulumtuar nga afër për lidhjet e Skëndërbeut dhe të fisit të Kastriotëve në këtë zonë. Rrugën nga Tirana e morën nga ana e Rrëshenit dhe Lurës për të shijuar bukuritë e natyrës. Bashkë me Hazis Ndreun kishim planifikuar që kur të arrinin në Çidhën, ata të pushonin disa orë në shtëpinë time, jo vetëm për t'u çlodhur, por edhe për të bërë një bisedë me disa nga pleqtë e fshatit Çidhën. Pas një bashkëbisedimi prej rreth dy-tre orësh me pleqtë Adem Hoxha, Sadin e Shaqir Tola, Hamit Cerri, Osman Basha, Selim Xheçi dhe Destan Cani, Prof.Stefanaqi, i befasuar nga ajo atmosferë akademike e krijuar nga ai bashkëbisedim historik e filozofik, në kuptimin e plotë shkencor të fjalës, në çastet e fundit të bisedës, në momentin kur po ngrihej për t'u larguar, ai bëri këtë deklaratë publike për ndryshimin e bindjeve të tij shkencore për origjinën e Skëndërbeut:

"Sot që u njoha me këta pleq filozofë, tani jam i bindur plotësisht se Skënderbeu është nga kjo anë, nga Sina e Çidhna e Dibrës, pasi deri më sot nuk e kam pas një bindje të tillë."

-Pse, profesor?! - ndërhyri Mustafa Tola, i pranishëm në atë mexhlis.

-"Një personalitet i tillë si Skëndërbeu, i përmasave evropiane e botëror, kurrësesi nuk mund të lindë në një taban bosh, në një vend pa tradita. Tani që një taban të tillë me tradita patriotike, etno-kulturore dhe filozofike e gjeta këtu, në Çidhën, tek këto pleq filozofë tani jam i bindur plotësisht se origjina e Skënderbeut është nga kjo anë, nga Çidhna", - përfundoi Prof.S.Pollo.

Mbështetur në këtë fakt, vetëm në termin **"Këta pleq filozofë"** të shprehur nga Prof.S.Pollo, se kjo filozofi ishte një argument bindës që këtu kemi një vazhdimësi të traditave etno-kulturore që nga lashtësia aq sa mbi bazën e të cilave akademiku Pro.S.Pollo, ndryshoi edhe bindjet e veta shkencore për një tezë të tillë që deri në atë kohë kishte qenë e debatueshme në mendjen e tij, siç ishte ajo e origjinës së Skënderbeut, e cila u zgjidh përfundimisht nga Sesioni Shkencor i organizuar nga Instituti i Historisë i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, në bashkëpunim me historianët e Dibrës më datë 1 Nëntor 1985 në Peshkopi, dhe me inagurimin e "Muzeut të Kastriotëve" në Sinë, me 2 Nëntor 1985.

Nisur nga fakti se Prof.S.Pollo që ato pleqtë bashkëbisedues me të i quajti që të gjithë "filozofë", pa bërë dallim ndërmjet tyre, për ne është argument i mjaftueshëm që "universitetin" e odave të Dibrës, meriton ta quajmë **"universitet filozofik";**

Nisur nga fakti se në odat e Çidhnës e të mbarë Dibrës qoftë për raste dasmash apo vdekjesh, kur të ftuarit janë në shumë oda (konaçe), i zoti i shtëpisë (ceremonisë), për çdo konak ngarkon një person të caktuar me detyrën e kujdestarit që t'i ruajë ekuilibrin e muhabetit në konak, që ndokush nga të pranishmit të mos i prishin dasmën apo mordenin, ky fakt përbën argument të mjaftueshëm për të konkluduar se të folurit alegorik në odat e Dibrës është masive. Prandaj nëse ato pleqtë që drejtojnë muhabetin nëpër oda, mund t'i quajmë "profesorët" e "universitetit të Dibrës", kurse pjesëmarrësit në mexhlise, do t'i quanim auditorin e atij universiteti, atëherë besoj se nuk do të gabonim nëse mbarë popullin e Dibrës do ta quanim **popull filozof**.

Lidhur me gjurmët e lashtësisë, nuk mund të lëmë pa përmendur këtu edhe këtë rast tepër sinjifikativ, nga i cili mund të nxirren shumë konkluzione, si dhe për faktin, i cili na tregon se argumentin shkencor për një çështje të caktuar mund ta gjejmë qoftë edhe nga një fjalë e vetme. Për analogji populli thotë "lepuri i madh rri në shkurre të vogël". Në këtë aspekt tregoj këtë ngjarje të jetuar sa vijon:

Në vitet '70 të shekullit të kaluar, gjatë një konsultimi shkencor, për disa çështje të caktuara gjuhësore dhe historike, në bisedë me Prof.Eqrem Çabej-n në zyrën e tij të punës, në Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë në Tiranë, kur unë i përmenda sa vijon:

"Gjyshja ime, Z.Zh.(K), mbi 80-vjeçare, analfabete, e vdekur në vitin 1968, gjatë bisedave shoqërore me bashkëmoshataret e veta, kur binte rasti që ato të flisnin ndërmjet tyre për bashkëmoshataren e tyre, M.D. (Xhipkën e katundit) (sigurisht në mungesë të saj), ajo e përmendte atë gjithmonë me respekt dhe për cilësitë e saj të larta morale, dhe bukurinë fizike të saj e lavdëronte vazhdimisht me këto fjalë: "Ajo ashtë një grua zonjë, ... **veç arbnesh**" ..., dhe në shpesh herë thoshte edhe: "... **tamam arbneshë**"

Kur përmenda fjalët "veç arbnesh" dhe "tamam arbneshë", Prof.E.Çabej reagoi me gëzim me këtë shprehje, tekstualisht kështu:

"Ah, ç'më kënaqe!"

Në këndvështrimin tim, nga përdorimi aktiv i kësaj fjale "arbneshë" në gjuhën e gjallë, në të folmen e Çidhnës, në gjysmën e dytë të shek.XX dhe nga banorë analfabetë dhe të moshuar, unë mund të konkludoj sa vijon:

1.Çidhna si krahinë ka qenë pjesë përbërëse e Principatës së Arbërit, banorët e Çidhnës janë autoktonë, vazhdues të drejtpërdrejt të Principatës së Arbërit.

2.Nisur nga fakti se fjala "arbën", "arbni", "arbnesh" është përdorur aktivisht në gjuhën e gjallë në të folurët bisedor të popullit deri në gjysmën e dytë të shek.XX, ky fakt është i mjaftueshëm për të konkluduar se fjalët "Shqipëri", "shqiptar", "shqiptare" ësthë shumë e re.

3. Fjala arbër, arbëri, vjen nga arbni, si pasojë e ndikimit të fenomenit të rotacizmit të toskërishtes mbi dialektin e gegnishtes, gjatë fazës për formimin e gjuhës standarde.

* * *

Një parantezë:

Fakti që popullsia e kësaj treve ashtu si gjithë populli shqiptar, është autokton dhe vazhduese e drejtpërdrejtë e ilirëve, flet, veç të tjerash, edhe për patriotizmin e saj të flaktë, që u ka rezistuar me heroizëm rrebesheve të historisë: dyndjeve romake, sllave e osmane. Ndaj ashtu si nga çdo pëllëmbë e truallit shqiptar, edhe nga krahina e Çidhnës kanë dalë në çdo kohë figura të shquara që me shërbimet që i kanë bërë atdheut e kombit kanë lënë gjurmë në histori. Patriotizmi dhe heroizmi i popullit të Çidhnës është masiv, por vendin kryesor të nderit midis tij, pa dyshim, e zë Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, themeluesi i shtetit të parë kombëtar shqiptar, i cili ka bërë epokë në histori. Për figurën e Skënderbeut në literaturën botërore janë shkruajtur mijëra volume, prej të cilëve po shkëpusim vetëm dy citate:

"Sikur perandorët bizantinë të qenë Skënderbenj, Perandoria e Lindjes do të kishte shpëtuar"[13] – ka thënë filozofi dhe shkrimtari i madh francez, Volteri. Ndërsa Follmerayeri [ ] e ka përcaktuar kështu:

"Gjergj Kastrioti është një nga kryeluftëtarët më të mbaruar, më faqebardhë dhe më të mëdhenj të botës."[14]

Që Kastriotët dhe Skënderbeu janë nga Sina e Poshtme e Çidhnës së Dibrës, këtë tashmë e ka vërtetuar historia, gjë e cila, siç e përmendëm edhe më sipër, është kurorëzuar edhe me ngritjen e Muzeut të Kastriotëve në Sinë, në nëntor 1985, ndaj do të ishte e tepërt që t'i rikthehesim kësaj teme.

Megjithatë, në funksion të kësaj çështjeje nuk mund të lëmë pa theksuar këtu vetëm një fakt historik:

Nuk ka qenë aspak e rastit ajo që turqit e studiuan dhe e planifikuan me shumë kujdes qysh më parë vendin se ku do të zhvillohej ndeshja e parë e ushtrisë turke kundër ushtrisë shqiptare të Skënderbeut. Fjala është për betejën e 29 qershorit 1444, që në histori ka hyrë me emrin "Beteja e Torviollit". Është e pabesueshme që turqit të mos e kenë planifikuar qysh më parë vendin e zhvillimit të kësaj beteje. Duke mos qenë në dijeni të Besëlidhjes së Lezhës, me qëllim që të mos hynin në konflikt dhe të mos acaronin kontradiktat me feudalët e tjerë shqiptarë dhe që të mund t'i veçonin ato prej Skënderbeut, kjo betejë, si ndjeshja e parë, duhej zhvilluar në një nga pronat e Skënderbeut, pikërisht në vendlindjen e tij, më shumë edhe që të hakmerreshin ndaj Skënderbeut për të çfarosur çdo gjë që të mundnin. Dhe zhvillimi i kësaj beteje në Fushë-Çidhnën[15], në Dibër të Poshtme,[16] kulmi i së cilës u bë tek "Ferra e Pashës" përbën një argument tjetër më shumë që përforcon origjinën e Skënderbeut dhe vendbanimin dhe trojet e Kastriotëve në Sinë të Çidhnës së Dibrës së Poshtme.

Meqë e solli rasti, lidhur me debatin në se kjo betejë është zhvilluar në Dibër të Poshtme ose jo, ashtu siç e kam theksuar edhe më parë,[17] ne ngulim këmbë dhe përsërisim mendimin tonë se kulmi i betejës ku ushtria turke u shpartallua plotësisht, është zhvilluar në Fushë-Çidhën, pikërisht në vendin e quajtur "Ferra e Pashës", toponim ky, i krijuar që nga ajo kohë, në kujtim të shpartallimit dhe të mbetjes së ushtrisë së vrarë turke të Ali Pashës nëpër ferrat e kësaj fushe. Kronikat e kohës dhe gojëdhënat tregojnë se vetë Ali Pasha, komandanti i ushtrisë turke, shpëtoi duke u fshehur në një ferrë të tillë, ndaj dhe sot e kësaj dite ky vend quhet "Ferra e Pashës". Megjithatë, duke qenë se Fusha e Kastriotit është fqinje dhe vazhdim i Fushë-Çidhnës, nuk përjashtohet mundësia që ndonjë pjesë e kësaj beteje të jetë zhvilluar edhe në Fushë të Kastriotit. Një argument tjetër më shumë në mbështetje të tezës sonë se kjo betejë është zhvilluar në Fushë-Çidhën, tek Ferra e Pashës, në terrenin në formë rombi, ku sot shtrihen fshatrat: Fushë-Alie (alias Fushë-Çidhën), Laçes dhe Blliçe, ndërmjet dy kodrave "Ostush" dhe "Salbatre" të veshura me dushk, ndërmjet të cilave kalon edhe përroi i Blliçes (ose i Gramës), i cili derdhet në Drin në anën lindore të tij; gjysma tjetër e rombit vazhdon edhe në anën perëndimore të Drinit të Zi, në terrenin fushor aty ku derdhet lumi "SETA" e rombi mbyllet tek ura e Setës, pranë Kepit të Xhitetit, aty ku bashkohen faqja malore e Kodrës së Leshe, në anën e majtë të Setës me vargun e kodrave të Sukës së Arrasit, në anën e djathtë të SETËS.

Ndërsa vendi ndërmjet dy kodrave ku, sipas Barletit, Skëndërbeu fshehu pjesën më të madhe të Ushtrisë, duke e futur ushtrinë turke në rrethim ndërmjet dy zjarresh, është pikërisht një Lagje e Laçeses, ku sot banohet nga fiset Margjoni, Kovaçi e Përgjegji, ndërmjet kodrës së Laçesës dhe kodrës së Ostushit.

Lidhur me argumentin që është përdorur në mbështetje të hipotezës që kjo betejë të jetë zhvilluar në Fushë të Kastriotit, se sipas saj ushtria e Skënderbeut bazën e nisjes si dhe strehimin në rast tërheqjeje e ka pas në Kala të Volesës[18], nuk qendron, pasi është jashtë logjikës që Skënderbeu t'i linte hapur ushtrisë turke rrugën për marshim drejt Krujës, rrugë e cila kalonte përmes Fushë-Çidhnës, nëpër Sinë e Qafë-Murrë-Mat-Krujë. Ajo hipotezë është e papranueshme më tepër edhe për faktin që këtë rrugë kalimi e mbronte dhe e mbyllte Kalaja e Çidhnës, e cila, për mendimin tonë, ka qenë në hyrje të Çidhnës, tek Kepi i Xhitetit, pikërisht atje, ku sot është shtëpia e Mersim Zenel Krrashit, kala që ka një pozicion gjeografik të njëjtë me ato të Kalasë së Beratit, përveç asaj që vetë fshati Çidhën e Poshtme është një kala natyrore. Pra prapavija e ushtrisë së Skënderbeut ka qenë vendosur në Çidhën të Poshtme dhe në Sinë.

Edhe masakra e madhe që u bë nga Sulltan Mehmeti II në gusht të vitit 1466 në Çidhën, pikërisht në funksion të hakmarrjes së tij ndaj Skënderbeut dhe çidhnakëve, ndonëse për të ardhur nga Elbasani deri në Çidhën, ushtrisë turke iu desh të kthente disa ditë nga rruga e tërheqjes për në "Stamboll", përbën një argument tjetër më shumë që dëshmon për qëndresën heroike të popullsisë së Çidhnës në shekuj.

ALI HOXHA

Shtëpia Botuese "8 Nëntori", Tiranë

V.O: Referuar në sesionin shkencor të organizuar në Fushë-Çidhën në Nëntor 1987.

13 Gazeta "Bashkimi" nr.15(9668) datë 18 janar 1976, fq.3.
14 Po aty, fq.3
15 A.Hoxha, "Mbi lokalizimin e fushës së Betejës së Torvjollit", në Studime Historike, Nr.3, Tiranë 1979, fq.229-236
16 Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë 1985, fq.90-91, fq.237
17 A.Hoxha, "Mbi lokalizimin e fushës së Betejës së Torvjollit", në Studime Historike, Nr.3, Tiranë 1979, fq.220
18 H.Ndreu, "Studime Historike" Nr.3, viti 1979, fq.242.


Rruga e Arbërit nr. 147

recensë

-Disa mbresa dhe opinione nga leximi i romanit
"Pas takimit me alienët" të shkrimtarit të njohur Arian Kadiu-

Një libër për alienët, nga Arian Kadiu

Nga **Viron KONA**



Arian Kadiu është autorë i 53 librave me karakter shkencorë (mbi 15 libra), letërsi artistike (16 libra), tekste shkollore 17 libra) si dhe autorë i qindra artikujve me karakter studimorë, shkencorë dhe publicistikë, ndërkohë që është pjesëmarrës dhe kontribuues në veprimtari të shumta dhe të larmishme arsimore dhe kulturore brenda dhe jashtë vendit. Ka fituar disa çmimeve letrare në rrafshin kombëtar.

1.

Letërsia për fëmijë më ka tërhequr vazhdimisht, një parapëlqim ky që më vjen nga fëmijëria, kur lexoja me zell dhe kërshëri të veçantë librat fantastikë e shkencorë: "Pesë javë me balon" dhe "Bijtë e kapitenit Grand", të Zhyl Vernit, "Udhëtimi i çuditshëm i Nils Holgersonit nëpër Suedi", të Selma Lagerlof, "Robinson Kruzo" të Daniel Defo dhe shumë e shumë vepra të tjera të letërsisë botërore, por edhe të asaj shqiptare. Leximi i tyre më ka përfshirë në botën magjike të fabulave dhe aventurave të personazheve, saqë mbaj mend që nuk doja ta lëshoja librin nga dora deri në faqen e fundit. Madje, kënaqësia e leximit të këtyre veprave, më shoqëronte edhe më tej teksa përfytyroja vazhdimisht episodet dhe ngjarjet e tyre, që shpesh i bisedonim me shokët dhe miqtë e vegjël në shkollë e në lagje. Mund të them me plotë gojë se kjo ndjesi dhe kërshëri më përfshiu edhe kur lexova kohët e fundit romanin fantastik*"Pas takimit me alienët"* të shkrimtarit të njohur shqiptar, Arian Kadiu.

Përpara se të shfaq disa përshtypje dhe opinione të mia, që më lindën gjatë dhe pas leximit të këtij libri, dëshiroj të sjellë në vëmendjen e lexuesit se Arian Kadiu, ka lindur në Peshkopi, në vitin 1943, është diplomuar në Universitetin e Tiranës, në fakultetin Histori-Filologji, dega gjuhë -letërsi shqipe. Ka fituar titujt: Profesor Doktor (2007), "Mjeshtër i Madh" (2017) dhe "Nder i qytetit të Peshkopisë" (2012). Ka punuar gazetar dhe redaktor në gazetën "Mësuesi", specialist në kabinetin pedagogjik të Peshkopisë, Specialist Kombëtar në Institutin e Studimeve Pedagogjike, kryeredaktor i revistës "Univers', sekretar kolegjiumi i revistës "Mjekësia dhe infermieria bashkëkohore", pedagog i jashtëm në universitet, etj.,ndërkaq, ka dhe disa specializime ndërkombëtare për psikologjinë e moshave të reja.

Arian Kadiu është autorë i 53 librave me karakter shkencorë (mbi 15 libra), letërsi artistike (16 libra), tekste shkollore 17 libra) si dhe autorë i qindra artikujve me karakter studimorë, shkencorë dhe publicistikë, ndërkohë që është pjesëmarrës dhe kontribuues në veprimtari të shumta dhe të larmishme arsimore dhe kulturore brenda dhe jashtë vendit. Ka fituar disa çmimeve letrare në rrafshin kombëtar.

Ndërkaq, duke qenë se në artikull kam objekt një libër artistik të këtij autori, po sjellë në kujtesën e lexuesit edhe një sërë titujsh librash të tij të këtij zhanri si: "Aventurat e pabesueshme të Batos", fitues i çmimit të parë në konkursin shpallur nga shoqata e shkrimtarëve për fëmijë (Novelë-përrallë, 2002), "Pendimi i arushit pa bisht", (Pjesë për kukulla,1975), fitues i çmimit të dytë në konkursin e 30-vjetorit të çlirimit të atdheut, "Vajza e Kuklandit" (Roman), "Një telefonatë në mesnatë" (Roman), "Kur dremiste Sahati i Tiranës (Roman, 2013), "Një ndodhi në det" (Tregime, 1997), "Pse dridhet harku i violinës" (Tregime, 1974), "Pas takimit me alienët" roman i rekomanduar nga MASH për lexime jashtë klase (Roman, 2002), "Trishtimi i blertë" (Novela për adoleshentë, 2003), "Stina e pestë" (Poezi, 2003), "Qyteti prej rëre dhe pallati i vërtetë" (Tregime, 1978), "Takimi i parë" (Novelë e tregime 1972)...

Ashtu siç përmenda më sipër në këtë artikull po ndalem veçanërisht te romani fantastik shkencor "Pas takimit me alienët", botuar në vitin 2004 nga Shtëpia Botuese "Fllad", i cili është i rekomanduar nga MASH për lexime jashtë klase. Libri është botuar dhe ribotuar disa herë, pasi interesim për të nga fëmijët dhe të rinjtë kanë ardhur duke u rritur.

2.

Që në fillim dëshiroj të them se, romani *"Pas takimit me alienët",* për hir të së vërtetës më tërhoqi dhe më mbajti ndezur kureshtjen nga fillimi deri në fund. Faqe pas faqeje ndjeva se u zhyta në një botë të bukur dhe tërheqëse, ku përpara lexuesit shfaqen personazhe origjinalë dhe interesantë, përshkruhen episode dhe ngjarje që ngacmojnë fantazinë dhe imagjinatën, të vënë në mendime dhe të bëjnë të ndjesh dhe të përjetosh thellë bukurinë e një vepre të vërtetë letrare.

Romani, të cilin autori ua kushton djemve të tij Helidorit, Florianit dhe Albit, është ndarë në dy libra: Libri i parë mban titullin "Të pabesueshme dhe të besueshme" dhe Libri i dytë "Zbulimet e reja të Albit".

Që në nisje të Librit të parë, me mjeshtëri të lartë artistike, autori e tërheq lexuesin dhe e "zhyt" magjishëm në atmosferën e librit: *"Albit i doli gjumi. Për çudi nga dritarja vinte një erë e lehtë. Po djali u drodh. Jo nga era e freskët. Ai e kishte mbyllur dritaren me dorën e tij. Madje, edhe i ati, kur i uroi "Natën e mirë!" e kish provuar në ishte mbyllur. Kush e kishte hapur atëherë?! Dikush ishte në…*

Kështu, libri rrëmben kureshtjen e lexuesit, i cili në vazhdim mëson se Albi u tremb derisa i ra të fikët dhe, kur u përmend ai e pa veten përsëri në krevat. Deshi të ngrihej por nuk mundej, ndërkohë që një zë i ngjirur, i mprehtë që sikur dilte nga një magnetofon i vjetër, e bëri të shtrihej, të mos merrte frymë dhe të shqyente sytë…

Kureshtja e lexuesit vjen duke u rritur dhe ai përfshihet nga ankthi pritës: si do të vijonin ngjarjet më pas? Dhe, gjatë leximit, shpejt lexuesi i vogël mëson se përball Albit qëndronte një alien, i cili i shprehu një dëshirë paqësore: të njihej me djaloshin...

Në vazhdim ishte kureshtja që e bëri Albin ta kërkonte vetë alienin, ta takonte dhe të bashkëbisedonte me të. Alieni erdhi. E quanin Entei dhe mes tyre nis një miqësi dhe bisedë e këndshme. Alieni tregoi se planeti nga ai vinte ishte shumë më përpara, shumë më i zhvilluar dhe se shpejtësia me të cilën ata lëviznin në hapësirë ishte sa gjysma e shpejtësisë së dritës. Ata kishin ardhur disa herë në Tokë për të shpëtuar disa alienë, që njerëzit i kishin zënë robër…Ndërkaq, autori me takt dhe mjeshtëri, na tregon se edhe vet personazhi kryesor Albi ka një të fshehtë, ai ka lindur me fletë...

Teksa tregimet dhe aventurat vazhdojnë, ndodhemi përpara një situate të re, përpara Albit shfaqet një tunel dhe, duke qenë me fletë e duke pasur mik një alien, ai dëshiron të futet dhe të zbulojë…Më tej, me një fantazi tërheqëse, shkrimtari e vendos personazhin e tij në situata të magjishme, interesante dhe të pëlqyeshme për fëmijët, por edhe që nxisin kureshtjen e tyre për të mësuar vazhdimin. *"Letra e të padukshmit"* hap një tjetër dritare kureshtje, teksa vijojnë tregimet: *"A mund ta kalosh ylberin?", "Albi i përgjigjet letrës së të padukshmit", "Nga kompjuteri vërsulet një ujk", "Butoni jeshil", "Një krokodil", "Ishulli i panjohur", "Pajtoni i mrekullueshëm", "Ujku tmerron pyllin","Letra tronditëse me lajme shumë të këqija", "Butoni i kuq", "Shqiponja e plagosur","Alieni Entei apo xhuxhi i vogël dalë nga përrallat", "Në bibliotekat më të mëdha të botës", "E fshehta për djalin e padukshëm".*

Shkrimtari gjen rastin të na tregoji se me gjithë botën e vrullshme dhe të përfshirë në aventura, Albi ka edhe merakun të ndihmojë doemos djalin (personazh) që e ka zënë halli se si ai të bëhet i dukshëm, nga i padukshëm që është aktualisht. Me ndihmën e alienit Entei, Albi e gjen ilaçin e duhur dhe ia dërgon recetën djalit të padukshëm me internet. Aty lexuesit e vegjël do të njihen me kënaqësinë e madhe që ndjeu Albi sepse po ndihmonte një fëmijë të zgjidhë hallin e tij të madh, nga i padukshëm të bëhet i dukshëm. Kështu, Albi shfaqet përpara lexuesit si një djalë me zemër të gjerë, me botë të madhe shpirtërore, me merak që të mos shikojë vetëm veten e tij, por të ndihmojë edhe njerëz të tjerët që kanë halle dhe, në këtë veprim-ndihme, ai gjen kënaqësi. Bukur, apo jo?

Por le të vijojmë me kapitujt e tjerë, sesi vazhdon libri, aventurat dhe tregimet e të cilit, bëhen njëri më interesant dhe më i bukur se tjetri. Ja, po vazhdoj me leximin e kapitullit: *"A do të kthehej në vendin e tij?"* Pra, edhe Albi qenka përpara një halli të madh: A do të kthehej dot në vendin e tij, në shtëpinë e tij, te prindërit dhe familja e tij? Dhe, autori, mjeshtër në artin e krijimit, me fantazi dhe imagjinatë, zgjon besimin edhe të personazhit, Albit, por edhe të lexuesit se *"Doemos duhej të gjente një rrugëdalje. Ky udhëtim fantastik e kishte mësuar që s`duhej të dorëzohej asnjëherë…"* Ama deri atëherë ai kishte mësuar si pa kuptuar shumë gjëra, kishte mësuar edhe për ylberin, se si formohej ai; kishte mësuar për ujkun dhe zakonet e tij të egra; për shqiponjën me sy dhe vesh të mprehtë; për delfinët që shpëtojnë varka me njerëz, për...

Po vijojmë më tej, sesa bukur autori gërsheton tregimet dhe aventurat. A nuk ndodh që fëmijët shpesh thonë: "Ah, sikur të arrijë në majë të atij mali dhe do të shija prej atje gjithë botën!" Por, ai nuk e di se kur arrin në majë të atij mali që dëshiron, kuptohet me shumë mundime dhe sakrifica të mëdha si alpinistët, shikon se përpara ka disa maja të tjera, mbase edhe më të larta...

Libri i parë mbyllet me "Epilogun", ku autori gjen rastin t`i shpjegojë lexuesit të vogël se çfarë kuptojmë me fjalën "Epilog"? Me atë rast, ata që nuk e dinë mësojnë se *"Epilogu është pjesa përmbyllëse e një vepre letrare ose fati i mëtejshëm i personazheve pasi ka kaluar një kohë."*

Në vazhdim, shkrimtari e përgatit lexuesin të hap faqen e parë të Librit të dytë, që titullohet *"Zbulimet e reja të Albit"* dhe që vijon me tregimet: *"Ngjarja më e madhe e kohës",* ku lexuesi njihet me të tjera aventura, me të tjerë personazhe të librit…Ja tek shfaqen mjeshtër Kliti, i cili kush e di pse *"Nuk donte të bëhej Kryetar Shteti?"*; vazhdojnë tregimet: *"Kështjella misterioze", "Lëkura e gjarprit", "Ku është arka e madhe?", "Qenushi i vogël "shkatërron" misionin e tyre sekret", "Albi gjen arkën e madhe", "Arkëza e vogël, e fshehta e thesarit", "Peshku"magjik","Cironka e artë","Ngjyrat e globit",* ku fëmijët argëtohen me ngjarje plot bukuri dhe kureshti e që të nxitin të vazhdosh më tej leximin, duke u ndaluar dhe duke menduar herë për njërin tregim dhe herë për tjetrin, ndërkohë që fantazia dhe imagjinata fëmijërore bëjnë hapat e tyre të mëdhenj drejt realizimit të ëndrrave dhe dëshirave për jetën, për shkollën, për lodrat, për aventurat, për dashurinë për familjen, njerëzit, atdheun...Vazhdon Libri i dytë me tregimin: *"Dy shpendë por krejt të veçantë",* ku fëmijët mësojnë se cili është shpendi më i vogël dhe shpendi më i madh, vendbanimet e tyre, karakteristika dhe veçori, zakone...*Pastaj "Alieni xhuxhi i përrallës" lexon" në mendjen e Albit".* Në këtë tregim shfaqet dukshëm dashuria e Albit për njerëzit, ai nuk e pranon kushtin e Xhuxhit të përrallave, që të largohet dhe të mos kthehet më tek njerëzit, kështu që, ai pranon që më mirë t`i hiqeshin fuqitë magjike, sesa të ndahej nga njerëzit. Vazhdon tregimi tjetër *"Albi stërvit qenin",* i cili ishte dhuratë nga xhuxhët e përrallave. Akoma më interesantë janë tregimet*"Përgatitje për aventurën e re", "Me anijen kozmike në Hënë'.* Aventura në Hënë është mjaft tërheqëse dhe të mban ndezur kureshtjen, por edhe u mëson lexuesve të vegjël për mënyrën e fluturimit drejt Hënës, si dhe dukuri e fenomene natyrore dhe fizike, fakte dhe kuriozitete interesante. Veçanërisht tërheq vëmendjen tregimet *"U nisën tre, por u kthyen dy udhëtarë nga Hëna"* dhe *"Fundi i epilogut të dytë".*

3.

Lexon 144 faqe libër dhe qëndron i menduar një copë herë. Libri të ka vënë në mendime, ai ka nxitur fantazinë dhe imagjinatën, ka ngacmuar mendimet, deri atëherë të fjetura, i ka vënë ato në lëvizje, dhe, kësisoj, lexuesi i vogël kërkon të ketë jetën dhe aventurat e tija, të shoqëruar me episode dhe ngjarje interesante. Ashtu si dhe personazhi kryesor i librit Albi, edhe ai ëndërron dhe përfytyron, nxitet dhe dëshiron, teksa librin e mban shtrënguar në duart e tij të vogla. Është kjo mjeshtëria e shkrimtarit Kadiu, i cili ndodhet në çdo shkronjë dhe faqe të librit, me fantazinë dhe krijimtarinë e tij, ndërkohë që e nxit vazhdimisht lexuesin, të vazhdojë të vozitë në detin e jetës, me anijen e tij të ëndrrave e përfytyrimeve, të çajë dallgët...Ja, edhe erërat janë të mbara...!

Përmbledhje poetike
nga Nuri Koleci

Hijet e tërbuara

Përmbledhje poetike me një gjuhë të pasur, plot simbolikë dhe e kapshme për të gjitha shtresat e lexuesve

Autori i përmbledhjes poetike "Hijet e tërbuara" Nuri Koleci, me një kujdes të stërholluar po shpalos ndjesitë që e preokupojnë përditshmërinë e botës së tij intime por edhe të nënqiellit ku jeton dhe vepron. Vetë titulli përvetëson dhe nxit lexuesin që me një frymë ta lexojë përmbledhjen dhe pastaj t'i rikthehet përsëri, të meditojë shpirtërisht dhe të fundoset në botën poetike sipas mënyrës që autori i sheh, shpalos dhe i percepton dukuritë.

"Hijet e tërbuara" të Nuri Kolecit shfaqen jo rastësisht, ato janë logo e vetë autorit, të cilat e preokupojnë, hijet të cilat herë duken e herë pas here sikur ikin, herë kanë maska të errëta e herë të tejdukshme. Herë e ndjekin e herë e braktisin. Edhe kur ikin nuk hetohen, edhe kur e ndjekin janë të qeta, të padukshme, por në shpirtin e poetit vlojnë në kohë dhe shprehin klithmën e pashterrur poetike.

Libri është i përbërë nga tre cikle ku dominojnë poezitë refleksive, sociale dhe erotike. Që të gjitha këto të gërshetuara me një filozofi tipike që flasin shumë në këndin e meditimit. Në këtë tufë poezish që të përvetësojnë hasen edhe poezi atdhetare, ironike dhe dominon porosia që nxit lexuesin të ballafaqohet me përditshmërinë që përcillet deri në mendjen dhe zemrën e lexuesit.

Nuk mungojnë as tematikat që shfaqin plagën e kurbetit. Në këtë përmbledhje poetike trajtohen tema që fuqizojnë moralin njerëzor drejt përditshmërisë.

Vargjet në tërësi janë vargje të lira dhe krejtësisht të shkarkuara nga rima poetike. Gjuha është tejet e pasur, plot me simbolikë dhe e përkapshme për të gjitha shtresat e lexuesve.

Recensent, Mr.sc. Adem Abdullahu,
poet dhe botues



Ajo plaket nën dhé

Ajo e hetonte gjatëkohë
Se duhet kaq herët ta braktisë këtë botë
Dhe shkoi...
Andej në një botë tjetër
Pa asnjë fjalë
Pa amanet
Pa testament
Çdo gjë shkuli nga zemra ime
E vetëm kujtimet e shkreta
Që kurë s'do të jenë të zbehta
Mbetën.
Dhe shkoi...
Të plaket nën dhé
Andej në një botë tjetër...
Që mbetet e mallkuar për ne.

Stina jonë

Është koha e detit
Kujtimet ringjallen
Dallgët në ritëm
Rrahin shkëmbinjt
Vetmia i lut të gjithë zotrat
Vetëm hije e saj të më ndjekë
Edhe prapa diellit

Varkat e dehura të detit
Muzgun të përqafojnë

Është koha e detit
Mungojnë mikja me buzëqeshjen
magjike
Vetëm hija e saj më mbetet besnike.

Në honin e shpirtit

Vargjet trurin fundosin
Në honin e shpirtit
Deri në buzëqeshjen e fundit
Dëshira mbeten peng

Vlon etja për të vrarë largësi
Për të ardhë deri te ty.

Po s' të gjeta

Sot mendova për ty
Mike
Dhe braktisa pritjet
Nomad i lodhur
Mbeta

Nesër po të gjeta
Asgjë s'do të ndodhë
Po s'të gjeta
Do të fal dy-tre vargje
Që ti kurrë s'i lexon.

Qytezës sime

Dibra ime
Flen a vlon
Ku je
Ku shkon
Ndalu
Mos vrit largësi
Mos rri në vetmi!

Dibra ime
Flen a vlon
Ku je
Ku shkon
A të ka mbetur ende bujari
Apo jeton vetëm me histori?

Dibra ime
Flenë a vlon
Ku je ku shkon
Pse hesht kur duhet pse flet
kur s'duhet Dibra ime
Brenga ime e thartuar.

Vetëm sonte

Unë sonte s'jam poet
As hamall, as mbret
(Por) Jam fantom i dashurisë
Vloj si në ditët e rinisë

Unë sonte s'jam poet
Jam njeri i thjeshtë e jo profet
Ngandonjëherë boheminë e imitoj
Në heshtje kujtime grumbulloj

Unë sonte s'jam poet
Nuk kam asnjë biografi
Sonte zëri i mikes më thërret
Për të vrarë largësi.

Te kisha e Moisiut

Pak më lartë shtëpisë sime
Atje mbi cukë
Gurë e ferra
Nën dhé dhe mbi dhé
Qëndrojnë të nemitur
Reliktet e kohës
Në qetësi funebre
Djersë e bukë
Të përziera
Koktej historie
Gërmadha enigmatike
Gjurmë të pashlyera
Bredhin
Pas meje apo
Pas hijes sime
Besnike.

Nënqielli im

Duket sikur flen
Në çerdhe nëpërkash

Edhe pse laviret virgjine
Shëtisin nëpër shesh

E zoti nuk e di
Si i pranon betimet e rrejshme

(Nënqielli im
ende duket sikur flen...)

Dikur

Gjyshja ime
Pranë oxhakut
Përralla më rrëfente
Dhe kujtesej për zjarrin
E dëgjoja
E besoja
Se varfëria
Pjell vetëm përralla
Dhe mendoja
Se vetëm
Me shkopin magjik
Me të cilin vritja gjarpërinjtë
Merr shije varfëria...

Kohë e thinjur

Kohën time e treti
Dhe pres...
Të vijë një engjëll i bardhë
Të bekojë bukën e njerëzve
Të zbusë copëza jete e mbijetese
Të përkëdhelë përjetimet
Të derdh kujtimet
E kohës së thinjur
E të zbusë shpirtat e uritur
Që fshehin njerëzit e ndershëm
Edhe pse
Barra e rëndë e fajit
Lazron lëkurëtrashët
Që s'dinë të skuqen.

Amulli dibrane

Dibra po mërzitet
Para luftës së fituar
Pas luftës së dështuar
Nga politikanët llafazanë
Trusakatë e megallomanë.

Dibra po mërzitet
Në pritje e përcjellje
Në ngrënie e në vjellje
Nga dredhakët plot histeri
Që e kaplojnë me neveri.

Dibra po mërzitet
Nga buzëqeshje të rrejshme
Përshëndetje servile
Nga atdhetaria e përsosur
Me zemër të përdhosur.

Dibra po mërzitet
Mbeti e nakatosur
Jetime e braktisur
Me zemër të copëtuar
Pa pranga e robëruar...

Vdes nga pak

Valixhen e kam gati
Nisem nesër
Sonte yjet do t'i vë në gjumë
Nisem nesër
Kam shpirt nomadi
Shpërngulem
Pa cak
Vdes nga pak.

Hajnia

(Klithje kundër devijimit
të lumit Radikë – 2015)
Merrni çdo gjë
Edhe atë që mbeti
Merrni
Ç't'ju kujtohet
S'u bë kiameti
Merrni
Merrni ujin
Tokën
Botën
Merrni, merrni
Ç'të doni
Po trimërisë sonë
Ç'do t'i bëni?
Ju hajnat e motshëm
Ju hajnat e rinj
Ju hajnat e sotshëm
Merrni
Edhe ato pak gjëra që na kanë mbetur
Se një ditë në fyt kanë për t'u ngecur
Merrni
Merrni
Hajna të vjetër
Hajna të rinj
Kurrë mos u ngopshi
O derra të zinj!

Rruga e Arbërit nr. 147

meditim

Miti *i vendlindjes dhe* **braktisja** *e dhimbshme*


Dr. Selman Mëziu

Një oxhak me gjurmët e nxime të zjarrit dimnor në faqet e gurëve të gdhendur. Duket si një kull që veç vajton e ndjen dhimbjen therëse të kohës. Përqark mure prej guri e balte të shembura barbarisht. Gurët, dheu i shkërmoqur, hithrat, kixhlat, barishte gjithëfarëshe rrinë si të shpërvjelura me një hije trishtimi të përshpatuna përkundruall gjurmëve të mureve me pamje trishtuese. Në ish dhomën e fëmijëve tanima gërmadha tmerrëndjellëse duket trupi bardhërosh i mështekzës, me kurorën lozonjare që e ledhaton era. Dëgjohet fështërima e gjetheve formëzemrash me një tingëllim vajtues e trazues plagësh të gangrenizuara.

Nuk u rrëzua nga gjylet e topave të turkut kjo shtëpizë. Nuk u dogj nga zjarri përvëlues i njerëzve të egërsuar të brigjeve të dnjestrit. Nuk e shkatërroi forca e tërmetit shtatë ballësh, nga lëvizjet e tremuna të shtresave gjeologjike të tokës. Jo, fatmirësisht! Por, përkundrazi një forcë e brendshme shpërtheu marrëzisht. Ajo shkriu si me llavë vullkanike, trurin e njerëzve, ju varrosi zgjuarsinë, ju trullosi ndërgjegjen si dhe ju preu limfën jetëdhense, këtyre malësorëve kreshnik e kryelartë dhe tmerri vazhdoi, duke terrorizuar, kafshët, zogjtë, pyjet, shteruar ujëra përrenjsh, lumenjsh, liqenesh dhe....

Kasolleve filluan t'iu kalben dërrasat, e të mbijnë mbi ato kapelet e këpurdhave, shtresat e myshqeve duke u bamun streh krimbash, mizash, grenzash, fluturash, larvash... Tjegullat u thyen, humbën ngjyrën e kuqërremtë ndërsa qeprat, trenët, demët nuk e mbajtën ma peshën e vet. Ato filluan të zhurmojnë idhnueshëm marshin funebër të vdekjes. Të ulurijnë në humnerat e pafundme të zhdukjes duke formuar grumbuj të paform tmerrëndjellëse lendësh të pakuptimta. Skelet bishash të shfarosuna nga forcat e shumta të natyrës së egërsueme duken këto qindra shtëpi e kasolle, ish streh jete njerëzish. Po ku janë vallë? I shfarosi malarja, turbekulozi, kolera, zia e bukes apo...?

Ato njerëz dikur krenar e kryenalt tërhoqën kambët zvarrë me shpirtin të vrarë egërsisht me zemërat plagosun përgjakshëm, ikën, ikën, diku larg. Macet e qentë mbetën





Mështekna në shtëpinë e shembur. Foto: Abedin Noka

të vetmit besnik trojesh, votrash zjarmi, sofrash buke, hambar misri, magje mielli. Ato hidhnin një hap të lothshëm të vrarë, të vaget, dhe kthenin kokën, herë pas here duke vë- shtruar prapa. Nga shtëpia me dritare, oxhaqe e dyert e hyrjes me kyçin e mbyllur. Nga përroi ku gurgullon uji i kthjellët me drurët e shkurret ku cicerojnë zogjtë. Nga shpatet e maleve me pyje lisi, mështekënash, ahu, lajthie thanash e arrash. Nga lëndinat e gjelbërta me lulet e shumta erëkandshme që iu ngjajnë sixhadeve të thuruna në razbuj nga nanat, duar arta e shpirt artistesh. Nga qielli ku bluja e thellë humbëte diku, duke marrë ngjyrën e murrme të reve që do të sillnin shiun bereqetë shumtë. Por ato e kaluan mullirin me lugun e drujt, urën prej dërrasash e pastaj qafën e malit, ku u shpalos një botë krejtësisht tjetër. Edhe pse ishte kamxhik mjerimi e kullonte kupa, kupa helmi, cfilitje, vuajtje duke fjetur asfalteve të qyteteve lluksoze ato nuk mundeshin me u kthye mbrapsht.

Të strukur të ndrydhur, të vuajtun nga ece jaket për të kërkuar ndonjë qoshkë fjeteje apo çfarëdo lloje pune. Sa për të rrojtur gjallë. Edhe me pak para të paguara, edhe pse me shumë punë të lothshme deri në raskapitje e urie ligështuese. Të cfilitur nga punërat e randa e shfrytëzuese gjer në palcë. Ato, dikur malësor kreshnik do vazhdonin kështu rrokullimën e jetës. Pa natyrën e bukur, bujare të shëndetshme, qetësuese. Pa vëllain, motrën, nanën, edhe ato diku të syrgjinosun. Një jetë e pakuptimë, krejtësisht artificiale. E megjithatë, duhesh jetuar. U ndërrue gjuha, u lidhën miqësi të reja, lindën fëmija. Një transformim kryekëput psikologjik, marrëdhëniesh, sjelljesh, bashkëpunimi e njerëzillëku.

Por, mendja, hera herës fluturonte duke kundruar vendlindjen. Aty ku bora iu vinte plisin e bardhë maleve. Atje ku luginat e shpatet vallëzonin nën të ftohtin e acart, shtërngatat e shirave. Atje ku dëgjohesh qyqja e këndonte bilbili ëmbëlsisht, ku ahet ngriheshin si kollona akropolesh. Atje ku ndonjëherë kandili i moçëm prej bakri llamburiste si shigjet me pakëz dritë. Atje ku mësuesi iu mëkonte shpirtin e kryeneqësonte krenarinë me emërat e vendlindjes me historitë e bajlozave, ciklopëve e legjendave me shtojzovalleve. Atje ku qumështi e mjalti binin erë lulebliri e shegji, gështenje dhe kamomili apo aroma drethëzave ledhatonte hundët e pastra nga ajri i kandshëm i luginave, mbuluar nga e gjelbërta e mështekëzave elgante.

Endesh në fshehtësi jeta. Kuptimi i secilës ishte rrokullisur përkundruell mëngjeseve të zhumshme të sertënueme e të egra. Vështrimi bridhe në kulla te nalta prej xhami dhe hekuri e miliona makinash që iu ngjanin mizave përdhese, mijëra fije telash, minaresh, antenash, lypsarësh me duart e mpira thatanike që kërkonin lëmosh. E mallnimi ju ngujon shpirtërat, iu trazon lotët e kripura të hidhërimit e dashurisë së jetës rinore të shkatuara nga ngacmimet e realitetit të ri. Duke iu sjellur në çdo qelizë trupore një torture si ato që ndjenin skllevërit nga vula me hekur të nxehtë në krahët apo shpinërat e ashpërtuara. Që nuk lanë asnjë trashgimtar se ligjet e shtetit ishin gatuar më shtazarakët se të gjitha kohërat e jetës njerëzore mbi këtë dhe. E vërteta e hidhur rrinë djallëzisht e strukur nën lëkurën e ligjeve të padukshme por, vepruese e me tensione dhimbje të lotueshme edhe në kohërat e sotme.

Kyqi po ndryshket, therrimërat e tijë, uji i formuar nga shirat do t'ia përcjell me plotë dëshire qimeve thithëse të mështeknës, apo qërshisë, manit, bredhit, pishës që tanima hijeshojnë këto gërmadha të vajtueshme. Për t'i gëzuar e shijuar sadopak gradishtarët që kanë mundur t'iu rezistojnë tallazeve të kohërave makabre në trojet e tyre. E kështu malësori i shekullit të njëzetë e njëjtë, varros e zhvarros vetëveten, ndërsa natyra ka vazhduar misionin e saj, ka kryer detyrën e saj, ka ndjekur ligjësitë e saja të hekurta, por, kurrë si këto kyqe që ndryshken, grryhen, shpërbëhen, transformohen. Dhe asnjëherë si malësorët kryelartë që jetonin kundruell Kallabakut, Korabit, Tomorrit, Dejës, Dhëmbelit, Nërmeçkës, Gramozit, Jerzecës që historia i zhuriti, shkërmoqi si shkëmebenjt e këtyre maleve me shpate të thepisura. Atëherë...

Bëj pajtimin tënd me

PayPal

përmes emailit

<rrugaearberit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton:

Në Shqipëri: 600 lekë.

Në Europë: 10 Euro.

Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA

është vetëm në versionin PDF.

Ne nuk jemi gazetë e pavarur, ne jemi gazetë e lirë dhe pavarësia jonë garantohet vetëm nga mbështetja e lexuesve...

post-mortum

Hajdaraga i cili ndërroi jetë në moshën 69-vjeçare, i përket një familje të ardhur nga Dibra e Madhe, që u shpërngul në kryeqytetin shqiptar pikërisht në kohën e zhvendosjen e madhe të dibranëve drejt Tiranës në fillim të shekullit të kaluar.

Ndahet nga jeta intelektuali dibran **Jashar Dema**

Më 18 korrik 2018 ndahet nga jeta inxhinjeri Jashar Dema, një nga intelektualët e shquar dibran në fushën e minierave. Lindi në Homesh të Grykës së Vogël më 12 dhjetor të vitit 1943 në një familje me tradita të herëshme patriotike. Jashar Dema (i vjetër) ka marrë pjesë në Kuvendin e Dibrës të 7 shkurtit 1899. Babai i tij Osmani vdiq më 1944 në moshë të re duke lënë prapa 4 fëmijë të vegjël, Menduin, Ilmijen, Sotiren dhe Jasharin e vogël në moshën 1 vjeçare. Nëna e tyre Dava megjithëse me shëndet të dobët, në luftë me vështirësitë e kohës i riti me mundime 4 fëmijët e saj të vegjël, duke i angazhuar jo vetëm me punë bujqësie për të ndihmuar familjen në fshat, por edhe duke i nxitur që të mësojnë në shkollë.

Në vendlindjen e tij Homesh, ku është hapur shkolla e parë shqipe në zonën e Grykës së Vogël, Jashari mbaroi shkollën fillore në vitin 1954 dhe atë 7-vjeçare në Shupenzë me rezultate të shkëlqyera në vitin 1957. Shkollën e mesme e kreu në Degën Minerale të Politeknikumit "7 Nëntori" në Tiranë, në vitet 1957-1961, ku mbaroi me rezultate shumë të mira degën e minierave dhe u diplomua teknik i mesëm minierash. Gjatë viteve të shkollës së mesme ai u shqua si një nxënës i sjellshëm e shembullor, i urtë, dhe i dashur me shokët.

Pas mbarimit të shkollës së mesme filloi menjëherë punën, teknik miniere në Minierën e kromit Bulqizë në vitin 1961, ku shpalosi çdo ditë aftësitë e tij në kryerjen e detyrave deri në vitin 1965.

Në vitet 1965-1970 kreu studimet e larta në Fakultetin e Gjeologji-Minierave të Universitetit Shtetëror të Tiranës. Edhe në shkollën e llartë u shqua si student i përkushtuar për të arritur rezultate shumë të mira. Gjithashtu ai kishte marrëdhënie shumë të afërta me shokët studentë dhe me pedagogët që e vlerësonin si një ndër specialistët e rinj që do të jepte kontribut të rëndësishëm në zbatimin e teknologjive të reja në nxjerrjen e mineraleve nga nëntoka. Gjatë periudhës së studimeve të larta Jashari është dallohej dhe në aktivitetet e ndryshme shkencore që organizoheshin në shkallë fakulteti, duke u zgjedhur edhe kryetar i Shoqatës Shkencore të studentëve të fakultetit.

Sapo mbaroi shkollën e lartë ku u diplomua inxhinier minierash, fillon punën në vitin 1970 në Minierën e Kromit në Bulqizë, që ishte miniera më e madhe e kromit në Shqipëri. Ekperiencën e fituar që në kohën kur ka punuar teknik në këtë minierë e vazhdoi tani si inxhinjer miniere, duke punuuar me përkushtim në realizimin e detyrave dhe në zbatimin e teknologjisë së përparuar në minierë. Jashari së bashku me Bujar Patën e Hamza Gurrën janë inxhinjerët e parë dibran që kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm në rritjen e modernizimin e Minierës së kromit Bulqizë.

Mbështetur në rezultatet e arritura në minierën e Bulqizës në janar të vitit 1971 emërohet Inxhinjer në zonën e II-të të Minierës së Batrës. Mbështetur në aftësitë drejtuese të këtij inxhinjeri tashmë me eksperiencë, në tetor të vitit 1972 emerohet K/Inxhinjer i Minierës se Batrës ku punon deri në vitin 1980. Gjatë kësaj periudhe Miniera e Batrës pësoi një rritje të madhe të prodhimit deri në 307 %, nga 135 000 ton më 1971 në 515 000 ton më 1981. Sigurisht në këto arritje kanë kontribut i gjithë personeli inxhinjero-teknik i kësaj miniere me në krye kryeinxhinjerin Jashar Dema.



Jashari u përcoll me nderime për në banesën e fundit në varrezat e Sharrës nga një numur i madh familjarësh, miqsh, të afërmish e shokë të punës e jetës nga Homeshi, Bulqiza, Krasta e Tirana. Me ndarjen e parakohëshme nga jeta të Jasharit, familja e të afërmit humbën njeriun e tyre më të shtrenjtë e të dashur, LID humbi një nga intelektualët e shquar të Dibrës në fushën e minierave, ndërsa shokët e shkollës e të punës, njerin nga shokët më të mirë të tyre.

Në vitin 1981 kalon me punë përsëri në minierën e Bulqizës, ku punon Inxhinjer, K/inxhinjer, Shef zone dhe Drejtor në Sektorin e Zonës "D", deri në vitin 1994. Edhe këtu Jashari u dallua në realizimin e detyrave të këtyre sektorëve të minierës.

Në gusht të vitit 1975 martohet me gjeologen dibrane Naxhije Lleshi me të cilën pati një jetë të lumtur bashkëshortore, u stabilizuan familjarisht në qytetin e Bulqizës, ku së bashku rritën dhe edukuan tre fëmijë të mbrekullueshëm, Besmiri (i diplomuar jurist) dhe dy vajza, Esmeralda e Valdrina.

Në vitin 1995 largohet me banim ne Tiranë dhe nga viti 1997 deri kur doli në pension më 2001 punoi specialist miniere pranë Alb-kromit në Tiranë. Kudo ku ka punuar ai është shquar si një nga specialistët më të mirë në fushën e minierave të kromit, duke punuar me përkushtim, devotshmëri e profesionalizëm.

Jashari u përcoll me nderime për në banesën e fundit në varrezat e Sharrës nga një numur i madh familjarësh, miqsh, të afërmish e shokë të punës e jetës nga Homeshi, Bulqiza, Krasta e Tirana. Me ndarjen e parakohëshme nga jeta të Jasharit, familja e të afërmit humbën njeriun e tyre më të shtrenjtë e të dashur, LID humbi një nga intelektualët e shquar të Dibrës në fushën e minierave, ndërsa shokët e shkollës e të punës, njerin nga shokët më të mirë të tyre.

Bashkim Lleshi
Demir Osmani

Tiranë, korrik 2018



Luan Hajdaraga, qeveritari i vetëm nga trojet etnike

Luan Hajdaraga, i cili u nda nga jeta pas një sëmundje të shpejtë, është qeveritari i vetëm shqiptar pas vitit 1990 që vjen nga trojet etnike dhe jo nga Shqipëria londineze e 1913-ës. Edhe pse i lindur në Tiranë, Hajdaraga i cili ndërroi jetë në moshën 69-vjeçare, i përket një familje të ardhur nga Dibra e Madhe apo Dibra-Shehër (qytet), siç i thonë, që u shpërngul në kryeqytetin shqiptar pikërisht në kohën e zhvendosjen e madhe të dibranëve drejt Tiranës në fillim të shekullit të kaluar.

Familjarët e afërt të të ndjerit Luan Hajdaraga jetojnë në Dibër dhe janë familje me mjaft influencë. Madje Gazmend Hajdaraga, kushëriri i parë i ish-ministrit ka qenë deputet shqiptar në parlamentin e Maqedonisë.

Psikolog me profesion, Luan Hajdaraga i përket grupit të intelektualëve që është marrë gjatë me arsimin shqiptar dhe metodat e mëdhimdhënies. Ka qenë para vitit 1990 drejtor i Institutit të Mësuesisë dhe në ekran u njoh në një emision të viteve '80 të titulluar: "Mësues, Prindër, Nxënës".

Pjesëtar i plejadës së mjeshtrave të pedagogjisë, Hajdaraga ju fut politikës menjëherë në vitin 1990, së bashku me disa profesorë të tjerë në grupin që mori në drejtim Partinë Socialiste. Është zgjedhur deputet në vitin 1992 nga lista proporcionale dhe ka qenë një nga 4 regjentët e drejtimit të PS-së kur Fatos Nano ishte në burg.

Një rezonante ka pasur ai në jetën e tij si politikan- fjalori krejt qytetar pa eksese dhe pa një qëndrim të polarizuar. Madje në kohën kur Nano ishte në burg, mjaft socialistë e akuzonin si të "butë me Berishën", madje edhe të lidhur me të vetëm se nuk shante kundërshtarët.

Kur PS vjen në pushtet në vitin 1997, Luan Hajdaraga zgjidhet deputet, por nuk mori pjesë në qeverinë e parë të Fatos Nanos. Drejton komisionin e Sigurisë Kombëtare, në kulmin e konfliktit PS-PD, por në auditorin e ri nuk pati asnjëherë të tillë.

Madje Hajdaraga mbahet mend në dy ngjarje që ka qenë mjaft i rëndësishëm përsa i përket kolegëve të tij të opozitës. Kur plagoset Azem Hajdari nga Gafurr Mazreku, Luan Hajdaraga ishte ndër të parët që e mori trupin e deputetit të PD-së për ta dërguar në spital.

Ndërkohë, kur Pjetër Arbnori pëson një goditje gjatë grevës së urisë në Kuvend, i ndjeri Hajdaraga nuk priti asnjë sekondë dhe e dërgoi ish-kreun e Kuvendit me urgjencë në spital. Në vitin 1999 emërohet ministër i Mbrojtjes nga Pandeli Majko, dhe më pas qëndron në këtë detyrë edhe me Ilir Metën-kryeministër.

Gjatë luftës së Kosovës, Hajdaraga ishte ministri që menaxhoi situatën në kufi me Serbinë, por nuk u bë asnjëherë protagonist. Dy vjet më pas, Shekulli publikoi një investigim ku Hajdaraga përflitej për abuzime me tenderat e ushtrisë, ku cilësohej si produkt kryesor shpërdorimi i orizit.

Këto akuza i mori në dorë Sali Berisha, i cili e supernominoi "Orizaga". Por ndaj Hajdaragës nuk u ngrit asnjëherë akuzë publike prej Prokurorisë. Në qeverinë e Fatos Nanos, pas vitit 2002 emërohet zv.ministër i Jashtëm dhe për një periudhë të shkurtër drejtoi diplomacinë shqiptare në mungesë të ministrit.

Edhe pse Ilir Metën e kishte mik të afërt, madje e mbrojti fort në KPD-në e famshme, Hajdaraga nuk ju bashkua LSI-së kur ndodhi shizma e madhe e së majtës. Pas ardhjes së Edi Ramës, ky i fundit nuk e afroi asnjëherë në kupolën socialiste, përveç një momenti në të ashtuquajturin Këshilli i të Urtëve.

Dalëngadalë, Luan Hajdaraga, i cili që prej vitit 2000 është edhe shtetas amerikan dhe familja i jeton atje, u distancua nga politika duke u marrë me leksione akademike, ku ishte shumë aktiv në Maqedoni. Madje goditja e parë në tru i erdhi gjatë lëvizjes me makinë për në Maqedoni, disa muaj më parë. Hajdaraga i përket llojit të politikanëve mjaft të zgjuar, e me bagazh të lartë intelektual. Zotëronte titullin Profesor-Doktor, kur ata që e mbanin këtë gradë numëroheshin me gishtat e dorës. Ai dinte shumë për të gjithë historinë dhe intrigat e së majtës shqiptare në vite, e megjithatë asnjëherë nuk i bëri publike.

Ndoshta në kushtet reale të Shqipërisë, intelektualët i ndrydhin dhe i lënë në "qoshet mikroborgjeze" të kujdessjes për familjen dhe jetën e tyre, pasi e njohin mirë rrezikun në politikë. Ndaj, siç duket, prej disa vitesh vrullin në politikë e kanë marrë ata që quhen "të fortët", të cilët zgjidhin më shpejt dhe më "lehtë" problemet që dalin përpara.

Hajdaraga, një dibran i diplomuar në Rumani, nuk e mohoi asnjëherë vendlindjen por asnjëherë nuk shkoi të kandidonte në "Dibrën e re", pasi duket e dinte që ata që e njohin janë jashtë kufinjve, lidhjet me të cilët i ka mbajtur gjithmonë edhe gjatë regjimit komunist... /tesheshi.com/



www.rrugaearberit.com

Na ndiqni *online*, falë ndihmës së z. Agim Deva, të cilin e falenderojmë për ndihmën dhe përkushtimin.

Informacioni për faqen online: **info@rrugaearberit.com**

Informacioni për versionin e printuar: **rrugaearberit@gmail.com**

Përdor KONTAKT PAGE për pyetje dhe sygjerime.

Shtyp butonin **"NDIHMO EDHE TI"** që gjendet në faqen e parë në versionin online për tu abonuar dhe kontribuar në botimin e gazetës, ose kontakto me redaksinë. Çdo kontribut bëhet publik.

Çdo lloje kontributi shkon në masën 100% në llogarinë e gazetës në Tiranë/ Shqiperi në mënyrë të sigurtë përmes PayPal.

Ky ëebsite është një kontribut në shërbim të botimit të gazetës "Rruga e Arbërit", lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër, që do lidhë Tiranën me pjesën tjetër të Ballkanit në Lindje të Shqipërisë, si dhe zhvillimin e Dibrës dhe krahinave përreth.



Tortë me kos



PËRBËRËSIT PËR 8 PERSONA: Biskota 150 gr.; gjalp 100 gr.; kos 700 gr.; pana e freskët 300 ml.; qumësht 100 ml.; sheqer 100 gr.; kolë pehku (xhelatin) 12 gr.

VËSHTIRËSIA: e thjeshtë.

KOHËZGJATJA: 30 minuta.

PËRGATITJA: Fillimisht përgatisim bazën e tortës duke përzier mirë biskotat me gjalpin e butë në mulineks. Hedhim përbërjen e përftuar në një tavë me kapse, ku kemi shtuar leter furri dhe e shtrijmë mirë në të gjithë tavën. E pjekim në furrë të ngrohtë në 1700 për 5 minuta. E lëmë të ftohet. Në një enë me ujë të ngrohtë vendosim kolën e peshkut për 10-15 minuta, derisa të zbutet. Ngrohim qumështin në një tenxhere të vogël, në të cilën hedhim kolën e peshkut dhe e trazojmë ngadalë deri sa të shkrijë. Në një enë tjetër rrahim panën me sheqerin deri sa të krijohet një masë shkumoze. Shtojmë kosin dhe e trazojmë duke lëvizë lugën nga poshtë lartë që përbërja të marrë ajër. Kur qumështi arrin temperaturën e ambientit e shtojmë tek masa e mësipërme dhe e trazojmë mirë. Këtë masë e shtrojmë tek tava me bazën e tortës. Tavën e fusim në frigorifer për gati 3 orë.

info@vivandachef.al

BËJ NJË ABONIM ONLINE OSE NË PRINT...

Kushton vetëm 600 lekë në vit... / email: rrugaearberit@gmail.com


LIBRA

Të gjithë këto tituj te libraria M&B në Tiranë i gjeni me 10% zbritje nga 1 qershori deri më 30 gusht 2018


...dhe mbi 100 tituj të tjerë të autorëve dibranë...




1500 lekë



1500 lekë



700 lekë



800 lekë

Të gjitha këto botime i gjeni pranë rrjetit të librarive **Adrion** në Tiranë, **librarisë M&B** në Tiranë (pranë kryqëzimit te Selvia në Rrugën e Dibrës ose në librari **"Fleta XXI"** në Peshkopi.

Email: **mbbotime@gmail.com** Tel: **+355 69 20 68 603** (Viber) **+355 68 65 08 441** (Whats App):

cyan magenta yelloë black